# MIRË SE VINI NË LINZ

Oferta, informacione dhe këshilla për qytetarët e rinj të Linzit




Zyra për integrim

Linz verändert

**Ne falemenderojme të gjithë partnerët për sponsorimin, përkrahjen e tyre dhe bashkepunimin e mirë, në krijimin e broshurës “Mirës se vini në Linz”!**

GWG
LEBEN IN LINZ

START
Stipendien für engagierte Schülerinnen und Schüler mit Migrationshintergrund
www.start-stipendium.at



AK Oberösterreich

LIWEST
Ein Kabel. Alle Medien.

LAND OBERÖSTERREICH

Raiffeisen Landesbank Oberösterreich

NH. NEUE HEIMAT

LINZ AG

LAWOG
Gemeinnützige Landeswohnungsgenossenschaft für Oberösterreich

Ist Integrationsstelle Oberösterreich

bfi
Berufsförderungsinstitut OÖ

AMS
Arbeitsmarktservice Linz

FAB

OÖ GKK
FORUM GESUNDHEIT

fh OBERÖSTERREICH
Studium mit Zukunft

PGA

BRUCKNER HAUS

blue danube airport linz





**Të dashur qytetare dhe qytetar të Linzit!**

Integrimi fillon me informacion. Duke e përcjellur këtë parim Zyra për integrim e qytetit të Linzit, për herë të parë në vitin 2011 e publikoi në shum gjuhë Broshurën „Mirë se vini në Linz", e cila i përfshin të gjitha informatat e rëndësishme për një start të suksesshëm në shtëpinë e re. Pas dy vjetësh , dhe shum ndryshimeve përmbajtësore në temat e përpunuara në të, është koha që ky Udhëzues informativ të aktualizohet dhe ribotohet.

Azhurnimi u shfrytëzua, që shumllojshmëria e informatave të ofruara edhe më tej të zgjërohet. Kështu, Broshura „ I shëndosh në Linz", gjithashtu e krijuar nga Zyra për integrim, u përfshi në këtë botim. Në këtë formë, për herë të parë Qytetaret dhe Qytetarët e rinj të linzit, mund ti marrin informatat e rëndësishme dhe kompakte nga një burim.

Puna në informim, është njëri nga aktivitetet gjithëpërfshirrëse për një bashkëpunim më të mirë të kulturave të ndryshme në Linz. Paketa e masave për integrim (Das „Maßnahmenpaket Integration") nga viti 2010 dhe Programi i ri social i Linzit („Neue Linzer Sozialprogramm") nga viti 2011, jan dy bazamente përmbajtësore mbi të cilat mbështeten tre shtyllat e Politikës integruese të qytetit: Dikasteri i Integrimit, Zyra për integrim dhe Këshilli për migrim.

Njejt si në botimin e parë, edhe ribotimi aktual i „ Mirë se vini në Linz" është një shenjë për Linzin si një qytet i hapur, i cili imigrimin e kupton si sfidë, por para së gjithash si shansë për një ardhmëri të përbashkët.

Ne Ju dëshirojmë një fillim të suksesshëm në jetën tuaj në qytetin e Linzit!



**Stefan Giegler**
Këshilltar për Çështje sociale dhe Integrim



**Klaus Luger**
Kryetar



Shoqëria e Linzit, e cila bëhet gjithnjë e më shumllojshme, e sjell Magistratin, si autoritet dhe ofrues të shërbimeve, para sfidave të reja. Me një menaxhim të diversitetit, angazhohemi që Qytareve/ëve të rinj të linzit tu ofrojm, nga njera anë shërbim më të shpejt dhe nga ana tjetër për përdorim më efikas të resurseve. Kjo është strategjia jonë në shërbimin e klientëve të imigruar.

Magistrati ofron një varg masash për plotsimin e nevojave të migranteve dhe migrantëve. Kjo fillon që nga nënpunësit  që flasin gjuhë të huaja, dhe shtrihet deri te materiali special, siç është Broshura „Mirë se vini në Linz“.

Udhëzuesi, për dy vjet, pas botimit të parë, u bë si mjet i pashmangshëm ndihmës, në shfrytzimin dhe afrimin e shërbimeve të qytetit ndaj qytetarëve të ri të linzit. Shum Kryeqytete të landeve tjera e kan marr idenë tonë për një Informim të zgjëruar për mirëpritje, gjë që e vërteton suksesin e këşaj rruge të zgjedhur.

Pjesëmarrja e migranteve dhe migrantëve në jetën shoqërore, sociale, kulturore në Linz, paraqet edhe në të ardhmen një detyrë qendrore të politikës komunale të Këshillit të qytetit dhe të Zyrës për integrim.



**Dr. Ernst Inquart**
Drejtori i presidiumit





Broshura „Mirë se vini në Linz“ është një histori suksesi. Është e projektuar si një udhëzues informativ për Kryeqytetin e landit, që u shërben, para së gjithash njerëzve me prejardhje migrante. Që nga paraqitja e publikimit në vitin 2011, popullariteti i saj është rritur vazhdimisht, edhe ate jo vetëm nga Grupet e mëdha migrante në Linz. Kërkesa e madhe për versionin gjerman të saj, tregon se edhe Austriaket/ët si qytetarë të rinj të Linzit, e marrin me dëshirë këte broshurë kompakte dhe gjithëpërfshirëse.

Për shfrytëzimin e mediumeve në drejtim online, që nga dalja e botimit të parë, Zyra për integrim, përveç formën „analoge“ në letër e ofron edhe mundësin për shkarrkim (Download). Numri i hapjes së faqes në internet, mbrenda dy viteve është rritur rregullisht, kështu që sot, mesatarisht 1.500 herë në muaj hapet faqja e Broshurës „Mirë se vini në Linz“.

Udhëzuesi informativ përmban dymbëdhjet kapituj, të cilët mundësojn një hyrje që kuptohet leht, në këto tema: Informata të përgjithshme për Linzin, Puna dhe Profesioni, Banimi, Shkollimi, Çështjet sociale, Shëndeti, Femrat, Kultura, Sporti dhe koha e lirë, Mobiliteti, Integrimi dhe informata për çështjet ligjore për të jashtëm. Për informata të mëtejme për të gjitha temat i kemi përmendur Këshillimoret më të rëndësishme, si dhe adresat e internetit.

Ne shpresojm se me këte, ju kemi dhënë në dorë një mundësi që ju ofron përgjigjje në pyetjet e juaja më të rëndësishme.

Mirë se vini në Linz!

**Mag. Belmir Zec**
Komisioneri për Integrim

**Arzu Büyükkal**
Krytarja e Këshillit për migrim

Broshura për informim “Mirë se vini në Linz” i përmban, të gjitha informatat e rëndësishme për qytetarët/et e rinj që kanë imigruar në Linz–parasegjithash për ata që kanë prejardhje migrante. Përmbajtja e saj, duhet të ndihmoj imigrantëve për një fillim të leht në vendbanimin e ri dhe ta përkrah integrimin e tyre..

Broshurandahet në dymbëdhjet kapituj dhe nga viti 2014 do të jetë edhe në gjuhët; Anglisht, Boshnjake – Kroate – Serbe (BKS), Gjermanisht, Frengjist, Rumanisht, Rusisht, Shqip dhe Turqisht.

Nëse keni pyetje drejtoheni, ju lutemi në:

**Integrationsbüro der Stadt Linz (Zyra për integrim e qytetit të Linzit)**
Hauptplatz 1-5, 2. Stock, 4041 Linz
Tel.: 0732 / 7070-1150
integration@linz.at
http://integration.linz.at
Ne mundohemi që këtë produkt vazhdimisht ta përmirsojm. Mendimi Juaj, si dhe propozimet e Juaja për përmirsimin e tij, jan të mirëseardhura!

Impressum: Willkommen in Linz –
Info-Guide für neue Linzerinnen und Linzer
Botimi i dytë:2013
Botuesi: Magistrat der Landeshauptstadt Linz, Integrationsbüro
Hauptplatz 1–5, 4041 Linz
Foto në titull: Zyra për komunikim e qytetit, Michael Dworschak
Pamja: Zyra për komunikim e qytetit, Edith Durstberger
Gjendja: Tetor 2013

Zyra për integrim nuk mund të marr përgjegjësi për përmbajtjet dhe përmbajtjet e Website - ve.Ne mundohemi për kualitet, aktualitet, dhe për saktësi të informatave. Gabimet dhe lëshimet, megjithate nuk mund të përjashtohen; Ndryshimet dhe gabimet e shtypit përjashtohen; Reagimet do të pranohen me kënaqsi.
Linket nëfaqen e internetit janë zgjedhur me kujdes. Në përmbajtjen e tyre, Zyra për integrim nuk ka ndikim, prandaj nuk mund të marr përgjegjësi.
Për shkaqe gjuhësore emërtimet, ndonjëher përdoren vetëm në një formë. Por kjo, nuk ka për qëllim diskriminimin.

# PËRMBAJTJA


## 1 Linzi prezentohet 11

Shërbimi i qytetarëve dhe administrata 11
Bashkiae Linzit 13
Politika 13
Historia e qytetit të linzit 16
Vendet që vlejn të shihen 17
Linzi- Qyteti i Paqes 17

## 2 Puna dhe Profesioni në Linz 19

Qasja në tregun e punës 19
Informata në lidhje me vendin e punës 20
Krijimi i marrëdhënjes së punës 22
Ndërprerja e marrëdhënjes së punës 23
Shërbimet dhe qendrat për këshilla 25

## 3 Banimi në Linz 27

Informatat e rëndësishme për kërkimin e banesës 27
Marja me Qira dhe Pranimi i banesës 29
Rreziku nga humbja e banesës / Dëbimi 30
Lajmrimi i Vendbanimit 31
Informata të veçanta për qiramarrësit 32
Shërbim special për migrantët 34
Shoqeritë imobiliare në Linz 35

## 4 Shkollimi në Linz 39

Sistemi Austriak i arsimit 39
Shkollat e obligueshme në Linz 40
Arsimi pas shkollimit obligativ 43
Mënyra e dytë për diplomim 45
Arsimi pas maturës 47
Nostrifikimi – Pranimi i diplomave dhe shkollimit jashtë vendit 50
Arsimi i të rriturve 50
Gjuha – Çelsi i suksesit 55
Faqe të dobishme në internet për temën shkollimi/arsimi/gjuha 58

# PËRMBAJTJA


## 5 Linzi si qytet social 61

Përkujdesja për fëmijët 61
Familja 64
Fëmijët dhe të rinjtë 70
Linzi për të moshuarit (Seniorët) 72
Përkrahje dhe mbështetje 74
Lindja, Martesa, Vdekja 76

## 6 I shëndoshë në Linz 81

Sigurimi social 81
Vizita te mjeku 83
Informata rreth spitalit 87
Këshillim dhe shoqërim gjatë krizave psiqike 90
Shërimi 92
Ruajtja e shëndetit 94
Çështjet e grave 97
Personat me procedurë për azil politik 100
Rastet emergjente 101

## 7 Gratë në Linz 103

Institucione të rëndësishme në Linz për shërbimin e femrave 103
Këshillimoret e Migrantëve 103
Lëmia e punës dhe kualifikimit 104
Shërbimet për mbrojtje nga dhuna 104
Kurset e vetëmbrojtjes 106
Këshillimoret për femrat në prostitucion 106
Institucionet për nëna - fëmij 107
Shëndetësia 107

## 8 Kultura në Linz 109

Linzi është (krye-) qytet i kulturës 109
Muzeumet / Shtëpitë për ekspozita 110
Vallëzim dhe Teatër 113
Muzika 114
Festivalet / Shfaqjet 116
Bibliotekat / Arkivet / Letërsia / Ofrimi i njohurive 119

Kultura e fëmijve / të rinjve 121
Art lirë- dhe skena kulturore 122
Migracioni dhe Kultura 123
Vendorganizimete tjera në Linz 124

9 **Sporti dhe koha e lirë në Linz** 127
LIVA – Partner i rëndësishëm për sport 127
Oferta për fëmijt dhe të rinjt 129
Pishinat, liqenet për tu larë, sporti mbi akull 129
Propozime për shfrytëzimin e kohës së lirë 130

10 **Qarkullimi në Linz** 133
Transporti publik 133
Quarkullimi me biçiklet në Linz 134
Informacione të përgjithshme për automjetin 134
Zonat e takimeve 137
Këshillimi për qarkullim në Linz 137

11 **Integrimi në Linz** 139
Puna e integrimit në qytetitin e linzit 139
Dy fundamentet e politikës integruese në Linz 139
Tre shtyllat e politikës së integrimit në Linz 142
Shoqatat e migrantëve në Linz 143

12 **Informatat për të huajt** 144
Imigrimi në Linz 144
Në përgjithësi për lejeqëndrimin e shtetasve të vendeve të treta 144
Llojet e lejeqëndrimit 145
Kohëzgjatja e lejeve të qëndrimit 146
Parakushtet e përgjithshme për dhënjen e lejeqëndrimit 147
Vazhdimi i lejeqëndrimit 148
Bashkimi i familjes 149
Nënshtetsia 149
Arratisje / Asyl 150
Organizatat tjera për këshilla dhe përkujdesje të migrantëve dhe/ose të refugjatëve
në çështjet e ligjit për të huaj ose çështjeve sociale 151
Konsullatat / Ambasadat 152

# LINZI PREZENTOHET



# 1 LINZI PREZENTOHET

Linzi është kryeqyteti i Austrisë së Epërme. Qyteti është vend I hapur, modern, dinamik dhe tërheqës, për të jetuar. Vendimtar për këte janëparasëgjithash këta faktor: Linzi është njeri ndër vendet më të suksesshme të ëndërrës ekonomike të Austrisë. Mbi 200.000 njerez janëte punesuar, ndersa qyteti aktualish ka 193.000 banor.

Edhe në aspektin e shfrytzimit të kohes së lirë, qyteti ofron shumë. Në këtë drejtim përveç ofertës së larmishme sportive, kultura luan një rol shumë të rëndësishëm këtë e vërtetoi Linzi bindshëm si Kryeqytet i Europës në Kulturë, në vitin 2009.
Sidomos duhet të theksohet fuqia sociale, e cila nuk mbetet aspak pas asaj ekonomike. Kështu, Linzi me ofertën e tij unike për përkujdesje dhe shërbime për të gjitha grupet e moshave dhe shtresave të popullit me të drejt vlen si qytetshembull në aspektin social. Një plus tjetër i Linzit është se popujt tjer trajtohen hapur dhe me respekt.

## Shërbimi i qytetarëve dhe administrata

### Shërbimi i qytetarëve – Pika e parë e kontaktit për kërkesën tuaj

Pika e parë dhe më e rëndesishme për të gjitha kërkesat tuaja në Magistrat është qendra për shërbimin e qytetarëve (Bürgerservice Center) në ndërtesën e re të Bashkisë (Neues Rathaus). Këtu keni mundësi tëkryeni shumë punë administrative dhe ti shfrytezoni drejtperdrejti shumë shërbime. Çështjet të cilat nuk mund të përpunohen, këtu i dorëzohen shërbimeve përkatëse profesionale.

- **Qendra për shërbimin e qytetarëve (Bürgerservice Center)**
  E hënë – E premte: ora 7 – 18
  Neues Rathaus, Hauptstraße 1-5, 4041 Linz/Urfahr
  Tel.: 0732-7070, Fax.: 0732-7070-54 2110
  info@mag.linz.at
  www.linz.at/service

Vendi multifunkcional për shërbim, këshillim dhe informim është i hapur 55 orë në javë. Ofrohen rreth 20 shërbime përkatëse. Ja shërbimet më të rëndësishme:

- **Aktivpass**
- **Lajmrimi, ç´lajmrimi dhe riregjistrimi i vendbanimit**
- **Vërtetimi i vendbanimit (Meldebestätigung)**
- **Informatat për vendlajmrimin (Meldeauskunft)**
- **Kartat për vendparkim të banorve (Bewohnerparkkarte)**

Oferta e përgjithshme gjendet në internet nën adresën: **www.linz.at/service**. Në qendrën për shërbimin e qytetarve munden të bëhen edhe sugjerime, dëshira dhe ankesa nga qytetarët.

- **Kërkesat për pasaport dhe leje personale**

  Qendra për pasaport
  Hauptstraße 1-5, Neues Rathaus, 1. Stock (Mbi Bürgerservice Center), 4041 Linz
  Tel.: 0732-7070
  info@mag.linz.at

Orari: E hënë dhe e enjte ora 7:00-12:30dheora 13:30-18.00,
E martë dhe e mërkurë ora 7:00-13:30,
E premte ora 7:00-14:00
Pa orar: e hënë dhe e enjteora 7:00–11:00 ngaora 13:30–16:00
E martë, e mërkurë dhe e premte nga ora 7:00-12:00

## Shërbimi i qytetarëve në zonate e qytetit

Shërbime të ndryshme të qytetarëve mundet që të bëhen lehtë dhe afër në pjesët e qytetit. Edhe ate në **bibliotekat e qytetit**, të cilatjanë jan si të thuash degë të qendrës për shërbimet e qytetarëve:

**Biblioteka e qytetit në Wissensturm**
Kärntnerstraße 26, Tel.: 0732-7070-4371

**Biblioteka në spitalin e pergjithshëm të qytetit (AKh)**
Krankenhausstraße 9, Tel.: 0732-7806-1226

**Biblioteka e qytetit në Auwiesen**
Wüstenrotplatz 3, Tel.: 0732-30 24 08

**Biblioteka e qytetit në Dornach/Auhof**
Sombartstraße 1-5, Tel.: 0732-2560-661

**Biblioteka e qytetit në Ebelsberg**
Kremsmünstererstraße 1-3, Tel.: 0732-30 89 92

**Biblioteka e qytetit në Einsteinstraße**
Einsteinstraße 5 (Einkaufszentrum Muldenstraße), Tel.. 0732-33 02 15

**Biblioteka e qytetit në Keferfeld/Oed**
Landwiedstraße 65, Tel.: 0732-67 69 34

**Biblioteka e qytetit në Neue Heimat**
Lilienthalstraße 5, Tel.: 0732-38 28 44

**Biblioteka e qytetit në Pichling**
Lunaplatz 4, Tel.: 0732-32 11 73

**Biblioteka e qytetit në Urfahr**
Neues Rathaus, Hauptstraße 1-5, Tel.: 0732-7070-2953

(Orari i punës është në internet në adresën: **www.linz.at/bildung/stadtbibliothek_oeffnungszeiten.asp,** si dhe mund të telefononi në numrin e Magistratit 0732 / 7070 si dhe në numrat e telefonit që jan të shënuara më lartë.
Shërbimet e qytetarëve në pjesët e qytetit kryesisht jan siç vijon:

- **Aktivpass**
- **Lajmrimi, ç´lajmrimi dhe riregjistrimi i vendbanimit**
- **Vërtetimi i vendbanimit (Meldebestätigung)**
- **Informatat për vendlajmrimin (Meldeauskunft)**
- **Kartat për vendparkim të banorve (Bewohnerparkkarte)**

## Shërbimi permes telefonit

**E hënë – E premte: ora 7 – 18**
Shërbim më i shpejtëekziston edhe përmes **numrave të telefonit në Magistrat** Këtu ofrohen informata profesionale - si p.sh.: Nëse keni pyetje përsa i përket Aktivpassit. Aty ku nuk jan të mundshme informatat e menjëhershme ato ofrohen përmes thirrjes telefonike të më vonshme nga punëtorët e Bashkiat. Problem të ndryshme mund të sqrohen me ane te telefonit. Në shërbimet direkte ndër të tjera janë edhe lajmërimi i VHS – kurseve, rregullimi i dokumenteve, kopjimi dhe kartat e vendparkimit si dhe rezervimi i orareve për martesë.

## 24-Orë-Shërbim në www.linz.at

24 orë është e hapur faqja e internetit të Magistratit. Në adresën **www.linz.at/service** është e mundshme të meren informatat për sherbime të caktuara zyrtare. Një rënditje sipas lëmive të ndryshme jetësore e lehtësojn kërkimin. Këtu gjenden edhe formular (Online) të shumtë, me ndihmën e tyre mund të kryhen shumë punë administrative përmes internetit. Bartja e të dhënave të këtyre shërbimeve online bëhet përmes linjave të sigurta (SSL-Të mbyllura). Kështu mbrojtja e të dhënave personale, është e sigurt.

# Magistrati i Linzit

Me një ofertë të zgjëruar shërbimesh Administrata e qytetit të Linzit garanton kualitet jetësor në lëmit e ndryshme. Qëllimi i 24 Departamenteve dhe dy Ndërmarjeve është që punët ti zgjedhim shpejt dhe profesionel. Kërkesat dhe nevojat e qytetarëve kan prioritet.

Orari iBashkise:
E hënë, e enjte: 7-12.30 dhe 13.30-18
E martë, e mërkurë: 7-13.30
E premte: 7-14

# Politika

## Kryetari i Linzit

Kryetari i Linzit është Klaus Luger (SPÖ).
Kryetari kryeson edhe Këshillin e qytetit edhe Senatin e qytetit. Ai duhet të përkujdeset, që vendimet në bashkëpunim me të tjerët të zbatohen. Sikur anëtarve tjer të Senatit të qytetit edhe atij i është nda një lëmi pune. Edhe në Administratën e qytetit kryetari ka një funksion qendror. Ai e prezenton qytetin jashtë, është kryesues i Magistratit dhe për udhheqjen e tij është përgjegjës.

## Këshilli i qytetit të Linzit

Këshilli i qytetit të Linzit zgjidhet në kohëzgjatje prej 6 vjetësh, nga nënshtetasit Austriak dhe nga nënshtetasit e shteteve të Bashkimit Evropian që i kanëmbushur16 vjet të cilët vendbanimim e kanë në Linz. Këshilli përbëhet nga 61 anëtar – këshilltar(et) – dhe është organi më i lartë. Këshillit të qytetit i japin përgjegjsi të gjitha organet e tjera të qytetit. Mbledhjet të cilat me rregull mbahen çdo muaj në sallën e këshillit në Bashkinë e Vjetër, janë publike.

Përbërja aktuale e Këshillit të qytetit të Linzit është rezultat i zgjedhjeve të 27 shtatorit 2009, me këte përbërje mandatesh:




Informacione më detaje të politikës së qytetit gjenden në internet nën adresën **www.linz.at/politik_verwaltung**.

## Frakcionet në Këshillin e qytetit të Linzit:

- **SPÖ – Partia Socialdemokrate e Austrisë**
  Bezirksorganisation Linz-Stadt, Landstraße 36, 4020 Linz
  Tel.: 0732/77 26 20
  office@linzpartei.at, www.linzpartei.at

- **ÖVP – Partia Popullore e Austrisë**
  ÖVP Linz Stadt, Obere Donaulände 7, 4010 Linz
  Tel.: 0732/76 20 500
  office@oevp-linz.at, www.oevp-linz.at

- **FPÖ – Partia Austriake e Lirisë**
  Bezirksgruppe Linz, Blütenstraße 21/1, 4040 Linz
  Tel.: 0732-73 64 26-26
  bezirk-linz@fpoe.at, www.fpoe-linz.at

- **Të Gjelbërtit**
  Altstadt 22a, 4020 Linz
  Tel.: 0732-73 94 44-0
  linz@gruene.at, www.linz.gruene.at

- **KPÖ – Partia Komuniste**
  Landesorganisation Oberösterreich, Melicharstraße 8, 4020 Linz
  Tel.: 0732-65 21 56
  ooe@kpoe.at, http://ooe.kpoe.at/

- **BZÖ – Unioni për Ardhmërin e Austrisë**
  Kjo parti kishte deri më 13Dhjetor2011nje këshilltar. Prej atëherë këshilltari Reinhard Reimann është këshilltar jopartiak, MBA është edhe më tutje anëtar i Këshillit të qytetit të Linzit
  Promenade 29, 4020 Linz
  reiman@reiman.at

## Senati i qytetit të Linzit

Perveç Kryetarit të qytetit i cili kryeson Senatin e qytetit – Nënkryetarët dhe Këshilltarët zgjidhen nga Këshilli i qytetit përmes frakcioneve. Përfshirja e partive politike në Senatin e qytetit (aktualisht: SPÖ 4, ÖVP 2, Grüne 1 dhe FPÖ 1 mandat), rregullohet sipas numrit të mandateve që kan fituar partit politike në Këshillin e qytetit. Senati i qytetit takohet sipas rregullit çdo 2 javë me dyer të mbyllura. Vendimet e veta i merr me shumicë votash të anëtarve të Senatit. Këto janënë në rend të parë pregatitjet e të gjtha çeshtjeve për të cilat nevoitet vendimi i Këshillit të qytetit, si dhe prezentimi i Buxhetit të qytetit Këshilltarëve të qytetit.

Prej Shtatorit 2013 Senati i qytetit të Linzit përbëhet nga këto anëtar:

- **Kryetari i qytetit Klaus Luger (SPÖ)**
- **Nënkryetari Christian Forsterleitner (SPÖ)**
- **Nënkryetari Mag. Bernhard Baier (ÖVP)**
- **Nënkryetarja Karin Hörzing (SPÖ)**
- **Këshilltari Stefan Giegler (SPÖ)**
- **Këshilltarja Mag.ª Eva Schobesberger (Die Grünen)**
- **Këshilltarja Kommerzialrätin Susanne Wegscheider (ÖVP)**
- **Këshilltari Detlef Wimmer (FPÖ)**

Anëtarve të Senatit të Qytetit u janë ndarë detyra në fusha të ndryshme. Aty ata kanë mundësi në çështje të ndryshme, të cilët gjenden në përcaktimin e detyrave, të vendosin vetë dhe të pavarur.

# Historia e qytetit të Linzit

Emri Linz udhëhiqet nga emri Romak Lentia, i cili e ka prejardhjennga Keltishtja “lentos = elastik, prirje”. Linzi pra është vendbanim në lakesën e lumit, që përputhet me shtrirjen e Lumit Danub.

**20** Që në pjesën e parë të shekullit të parë formohet vendbanimi i parë Romak në Römerberg. Pastaj krijohet keshtjella Romake Lentia në pjesën e sotme Spittelwiese.

**799** Për herë të parë përmendet emri Linz në një dokument të Martinskirche.

**1490** Linzi paraqitet për herë të parë si kryeqyteti i Austrisë së Epërme. Dhe prej ketij viti Linzi ka një Kryetar.

**1520** Në Linz, Protestantizmi fiton gjithnjë e më shumë përkrahës

**1612** Fillon veprimi i Astronomit dhe Matematicientit Johannes Kepler në Linz, i cili disa vjet ka punuar si arsimtar në shkollën e gjeografisë. Këtu krijohen disa ngapunimet më të rëndësishme të tij.

**1645** Nën shtypje të madhe perfundon rikatolicizmi i qytetarëve. Shumë udhëheqës fetarë vendosen në qytet.

**1873** Fillon formimi i bashkive nga vendet përreth. Deri me 1940 zgjërohet Linzi në nivelin e sotshëm.

**1919** Fitorja e Socialdemokratëve në zgjedhjet e para për Këshillin e qytetit pas të drejtës për zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, direkte dhe të fshehta ndërmjet meshkujve dhe femrave. Josef Dametz bëhet kryetari i parë Socialdemokrat.

**1929** Ndërtohet pishina e mbuluar në parkun e qytetit (Parkbad) në Austrinë e Epërme.

**1934** Në Linz shpërthen lufta qytetare ndërmjet unionit të mbrojtjesë Socialdemokrate – Republikane dhe forcave ekzekutive, ushtrisë dhe atdhembrojtësve (Heimwehren).

**1938** “Bashkangjitja” e Austrisë në Reichun Nacionalsocialist të Gjermanisë behet në Linz. Mijratë internuar si dhe punëtore dhe punëtor me dhunë nga 16 vende detyrohen me dhunë të punojnë në ndërmarrjet industriale si dhe në pune të tjera.

**1944** Fillon sulmi ajror i forcave aleate mbi Linzin, nga i cili deri në fund të luftës vriten 1679 njerëz.

**1945** Çlirimi i qytetit të Linzit nga udhëheqja nacionalsocialiste nga trupat Amerikane. Vetëm në NS – llogoret e Mauthausenit dhe Hartheim afër Linzit vriten mbi 100.000 njerëz. Linzi mbetet 10 vjet qytet i ndarë. Danubi ishte kufiri ndërmjet territorit të okupuar Rus në Urfahr dhe territorit të okupuar Amerikan. Socialdemokrati Ernst Koref mbetet deri më 1962 si kryetari i parë i pasluftës në kryesinë e administratës së qytetit.

**1947** Fillojn investimet kulturore të qytetit të Linz-it me formimin e Shkollës së lart poullore (Volkschochschule) dhe Shkollës së artit ( Sot Universiteti i artit)

**1953** Hapja e LD-Stahlwerk (Metalurgjiku) në VOEST. Voest -Alpine mbetet edhe në ditët e sotme ndërmarrja më e rëndësishme në qytetin industrial të Linzit.

**1955** Ribashkimi i dy pjesëve të qytetit, i Linz-it dhe Urfahr-it me terhëqjen e Trupave okupuese.

**1962** Linzi bëhet qytet universitar me formimin e Universitetit Johannes Kepler.

**1974** Hapja e Brucknerhaus si sallë internacionale e koncerteve.

**1984** Në afersin e limanit të qytetit adoptohet Posthof-i si Qendër kulturore alternative, i cili në vitin 1990 me ndërtimin e Posthof II, zgjërohet dukshëm.

**1990** Këshilli i qytetit të Linzit aprovoi Programin social, i cili vendosi bazën për zgjërimin e Objekteve për përkujdesje të fëmijve dhe të moshuarve.

**1991** 1Me iniciativen e qytetit të Linzit arihet ndërtimi i banesave të reja përmes një programi të veçant me udhheqjen e Austrisë së Epërme (Land Oberösterreich). Në kuadër të këtij Programi do të realizohen 21 Projekte banimi, ndër ata edhe Objektet e banimit në Auwiesen dhe Ennsfeld.

**1994** Hapet Design Center në Europaplatz, si qendër multifunksionale për Ekspozita dhe qendër Kongresesh.

**1997** Franz Dobusch, për herë të parë zgjidhet Kryetar i Linzit me votim të Drejtpërdrejt nga qytetarët.

**2003** Galeria e re e qytetit përmes Muzeut të artit Lentos fiton një objekt reprezentativ dhe funksional pran Danubit. Ky dhe investime tjera të medha në infrastrukturën kulturore ndikojn bindshëm në imazhin e Linzit si qytet kulture.

**2009** Linzi së bashku me kryeqytetin e Lituanisë, Vilnius, shpallet "Kryeqytet Europian i Kulturës". 220 Projekte me mbi 7.700 Shfaqje me 5.000 krijues kulturor nga 66 vende, i entuaziazmuan njerëzit gjat tërë vitit. Gjatë vitit si kryeqytet i kulturës hapet edhe Ars Electronica Center, trakti jugor i keshjelles muze (Schlossmuzeum) si dhe Ateljeu Salzamt.

**2010** Në Pichling hapet qendra e nëntë e të moshuarve. 64 personave që kanë nevojë për përkujdesje vendbanim. Në të njejtin vend janë edhe 25 banesa me përkujdesje.

**2011** Këshilli i qytetit vendos për programin social të Linzit„Soziale Sicherheit und Gerechtigkeit (Siguria dhe drejtësia sociale)" dhe me të vendoset zhvillimi i mëtejshëm i Linzit si qytet shembullor social në shekullin 21.

**2012** Në Prill u hap, zyrtarisht Termocentrali nga djegia e mbeturinave.Prej të cilit furnizohen 30.000 familje me rrymë elektrike dhe 20.000 familje me ngrohje.

**2013** Teatri i ri muzikor Linzit i hapi dyert. Me planin për zhvillim kulturor (KEP) u krijua një dokument strategjik kulturor për 10 deri 15vjetët e ardhshëm.

## Vendet historike dhe kulturore

Nën adresën **www.linz.at/tourist/stadtrundgang.asp** arrijm ti shofim vendet e vlefshme në qytetin e vjetër të Linzit: Altes Rathaus (Bashkia e vjetër), Dreifaltigkeitssäule (Shtylla e trefisht), Minoritenkirche, Landhaus, Mozarthaus, Kremsmünstererhaus, Linzer Schloss, Martinskirche, Landestheater, Bischofshof, Neuer Dom, Karmelitenkirche, Ursulinenkirche, Seminarkirche, Nordico, Alter Dom, Stadtpfarrkirche, Stifterhaus und Keplerhaus.
Vende dhe objekte të tjera që vlejn të shihen në Linz gjenden gjithashtu në këtëadresë interneti.

## Linzi Qyteti i Paqes

Me vendimin unanim të Këshillit të Qytetit në vitin 1986, Kryeqyteti i Landit të Austrisë së Epërme u shpall "Linzi, Qytet i Paqes". Qëllimi: Përgjegjësia komunale për kodifikimin dhe përkrahjen e masave për nxitjen e paqes. Me deklarimin "Qytet i Paqes" në Tetor 1986, Qyteti i Linzit morri obligim që " Vullnetin për paqe dhe angazhimin për paqe të qytearëve, ta pranoj dhe ta bëjë principin themelor, të veprimit politik komunal në të ardhmen".

Informatatat e hollësishme Linzi Qytet i paqës(Friedensstadt Linz) mund ti gjeni online në: **www.linz.at/kultur/friedensstadtlinz.asp**

# PUNA DHE PROFESIONI NË LINZ



# 2 PUNA DHE PROFESIONI NË LINZ

Për të punuar në Austri duhet patjetër të plotësohen parakushtet e ndryshme ligjore. Këto duhet të sqarohen sakt, për tu punësuar në menyrë legale.

## Qasja në tregun e punës

Të huajt për tu punësuar në parim ju duhet leje e punës sipas ligjit mbi punësimin e të huajve

### Të përjashtuar nga kjo janë:

– Nënshtetasit e vendeve, të cilët para 1 Mai 2004 kanë hyrë në zonën ekonomike Evropiane, dhe anëtarët e tyre të familjes.
– Nënshtetasit e Zvicres, Qipros (pjesa Greke), Malta si dhe anëtarët e tyre të familjes.
– Anëtarët e familjes të nënshtetasve Austriak.
  Si anëtar të familjes llogariten: Bashkshortët dhe fëmijët (duke përfshirë fëmijët e bashkshortit, të adaptuar si dhe nipat/mbesat) deri në mbarimin e moshes 18 vjecare, nëse janë ligjerisht të vendosur në Austri. Sipas kushteve të caktuara munden edhe femijët më tërritur, prindërit, prindërit e bashkshortes/it dhe gjyshërit e personave të lartë përmundur, të jenë të liruar nga leja për punësim.
– Ata që e kanë të drejtën e azilit dhe të mbrojtjes plotësuese
– Ata që e kanë të drejtën e azilit dhe të mbrojtjes plotësuese
– Të huajt në shërbimet diplomatike ose konsulare si dhe nënpunësit e tyre të huaj.
– Mësimdhënësit dhe hulumtuesit si dhe bashkshortët dhe femijt e tyre.

Enti i punësimit, sipas dëshirës jep vërtetim (paguhet taksë), qëedhepa leje punekeni të mundesitë punoni.

### Vendimtare, para së gjithash është se nga cili vend vini, pra çfarë nënshtetsie keni:

| Vendi | Leja |
|---|---|
| Ju jeni: Austriak/e, qytetar i një shteti të BE – se/ZEE – së (shtetet “e vjetra” te BE/ZEE) ose Zvicra | Ju keni liri qëndrimi dhe të drejt punësimi. Ju mundeni pa ndonjë leje qëndrimi ose punësimi gjithkund në Austri të punoni. |
| Ju jeni: Nënshtetas i një shteti “te ri” te BE – se, e këto janë; Kroacia, (për Rumaninë dhe Bullgarinëvlen deri më 31 Dhjetor 2013) | Juve ju duhet një leje pune |
| Ju jeni: Nënshtetas i shteteve të treta (keto janë të gjith nënshtetasit tjerë) | uve ju duhet lejeqëndrimi dhe leje pune |
| Ju jeni: Nënshtetas i Turqisë | Në bazë të një marrëveshje në mes te BE – së dhe Turqisë për ju vlejn rregullat e posaçme |

## Çfarë mundësi punësimi keni në Austri ?

Ekzistojnë disa lloje lejesh qëndrimi me të cilat pa leje të posaçme për punë keni të drejt pune në Austri: **„Daueraufenthalt – EG“, „Niederlassungsbewilligung – unbeschränkt“** ose „Niederlassungsnachweis“, Rot-Weiß-Rot + ....
Me këto keni të drejt të punësoheni. Perjashtimet tjera nga ligji i punësimit për të huaj gjenden në adresën **www.linz.at** » Bürgerservice » Service A – Z » Zuwanderung » Arbeitsberechtigung.

Nëse nuk i keni njërën nga këto leje ju duhet njëra nga lejet e mëposhtme për të cilat duhet ta bëni kërkesën **në Zyrën e Punës** (Arbeitsmarktservice)

- **Leje pune 1 vjeçare (Beschäftigungsbewilligung)**
- **Leje pune 2 vejçare (Arbeitserlaubnis)**
- **Leje pune 5 vejçare (Befreiungsschein)**
- **Rekomandimi**

Meqenëse në lidhje me Ligjin për qëndrim si dhe Ligjin për punësimin e të huajve, ka rregullisht ndryshime, ju propozojm që para se të pranoni një punë të caktuar, të informoheni në Zyrën e Punës (AMS), se a duhet dhe çfar leje duhet.

➲ **Arbeitsmarktservice Linz (AMS)**
Bulgariplatz 17-19, 4021 Linz
Tel.: 0732/6903
ams.linz@ams.at
www.ams.at/ooe

# Informata në lidhje me vendin e punës

## Punëkërkuesit

Përfundimi i shkollimit për një profesion të caktuar, të cilin dëshironi ta beni në Austri, ka rëndësi të madhe. Pasi vetëm me një shkollim gjithpërfshirës (mesimi në punë, shkollimi ose studimi) është e mundur që të gjeni një vend të mirë të punës. Nëse dikush në vendlindje ka mësuar një profesion, ose ka filluar me mësimin e profesionit të caktuar, duhet të informohet nën cilat kushte pranohet profesioni i tij në Austri.

## Çka duhet të mendoni para se ta zgjidhni profesionin tuaj?

– Interesimi(për çka jam i interesuar, prirrjet, dëshirattuajaetj.
  Pritjet nga profesionale (çka më motivon, cilët punë, cilat vende punë më interesojnë etj.)
– Ku janë përparësit e mia
– Llojet e profesioneve (njohja me llojet e ndryshme te profesioneve etj.)

- Vendosja e qëllimit
- Gjetja e alternativave (mendimi për profesione tjera)
- Marrja parasysh e konsekuencës (njohja e përparësive dhe dobësive)
- Vendimi (vendosja për një profesion që d.m.th.: për shkollim ose studim)
- Zbatimi (kërkoj një vend mësimi, lajmërohem në shkollë të mesme)
  Më tej ekziston mundësia që të merrni pjesë në ditët për ushtrimin praktik të profesionit.

## Ditët e ushtrimit praktik të profesionit (Schnuppern)

Ditët e ushtrimit praktik të profesionit ju mundësojn juve të keni një pamje në përditshmërinë profesionale dhe ju ndihmon që profesionin tuaj të preferuar ta njihni.
Ditët e ushtrimit praktik të profesionit janë pjesë e rëndësishme për orientimin tuaj profesional në shkollë. Duke e parë, pyetur, provuar punë të thjeshta dhe të parrezikshme, nxënësit e kanë mundësin ta njohin profesionin dhe përditshmërinë e ushtrimit të tij në ndermarrje, dhe kështu ti krahasojn paramendimet e tyre dhe realitetin në lidhje me profesionin. Adresat e firmave ose firmave qe marrin nxënës në profesion, mund ti gjeni në këshillimoren e Wirtschaftskammer OÖ. (Oda ekonomike)

Burim i rëndësishëm për gjetjen e punës janë edhe gazetat e përditshme, njoftimet nga rrethi i miqve, të njohurve si dhe informatat në AMS.

➲ **Berufsinformationszentrum des Arbeitsmarktservice Linz (AMS)**
Bulgariplatz 17-19, 4021 Linz
Tel.: 0732-6903
ams.linz@ams.at
www.ams.at/ooe

Krahas ndërmjetësimit të vendeve të lira të punës, AMS ofron edhe një shërbim gjithpërfshirës për ata që kërkojn punë, siç është: Ndihmën në orientimin profesional jep informata për trendin e profesioneve, shansat e punësimit etj. Ajo ndihmonnë konkurrim për punë, shkrimi i CV-se personale, biseda për punësim, ndihmesë për rikthimin në profesion dhe mundësit e shkollimit të mëtejshëm.

Detajet i gjeni në www.ams.at/sfa
Kush dëshiron që të hap firmën e vet duhet të informohet në Odën ekonomike (Wirtschaftskammer). Ajo ofron përkrahje për hapjen e firmës dhe këshillim për sipërmarrësit:

➲ **Wirtschaftskammer Oberösterreich**
Hessenplatz 3, 4020 Linz
Tel.: 05-90 909
service@wkooe.at
www.wko.at » Oberösterreich

## Mardhenia si punemarres

Nëse dikush obligohet që të kryej një shërbim ose punë për dikend atëher krijohet kontrata e punës. Kjo i rregullon të drejtat dhe obligimet në mes të punëdhënsit dhe të punëmarrësit, nëse kjo nuk është obligim i detyrueshëm me ligj ose kontratë kolektive. Detyrimi kryesor i punëdhënsit është të bëj pagesën për punën ose shërbimin që e kryen punëmarrsi.
Kontrata e punës mund të bëhet me shkrim, me gojë ose ndonjë "veprim pozitiv" si p.sh.: dikush bën një shërbim ose punë dhe pala tjetër e akcepton këtë.
Meqenësee drejta e punës parimisht gjen aplikim në kontratën e punës, për gjykimin e fakteve, për këtë shkak njihen nga praktika disa lloje të kontratave të punës,

- **Kontrata për shërbime të lira (freier Dienstvertrag)**
- **Kontrata e punës**
- **Kontrata me autorizim**
- **Kontrata e korporatës (Gesellschaftsvertrag)**

Sqarimet e mëtutjeshme për llojet e kontratave do ti gjeni në adresën:
**www.arbeiterkammer.com** » Arbeit & Recht » Arbeitsverträge

**Kontrata kolektive** i rregullon kërkesat të cilat nuk janë të parapame me ligj. Këto janë ndërr të tjera pagesa për pushim (Urlaubsgeld) dhe pagesa për krishtlindje (Weihnachtsgeld)*, si dhe rritjet vjetore të pagave. Marrëveshja arrihet përmes sindikatave të një dege dhe të punëdhënësve të asaj dege. Në këtë menyrë brenda vitit lidhen mbi 450 kontrata kolektive. Kontrata kolektive krijon standarde minimale për pagesë si dhe kushte pune të njejta për punëmarrësit brenda një dege. Ai duhet në çdo firmë të merret në shqyrtim. Se cila kontrat kolektive do të merret parasysh për punën ose shërbimin e caktuar mund ta shofim në kontratën e punës.
*Pagesa për pushim – dhe shtesa për pushim, ndihma për pushim ose siç thirret rroga e 14 – dhe pagesa per krishtlindje, janë pagesa të veçanta.

### Paga/Rrog

Në Austri është e rregulluar me kontratë kolektive, rroga minimale për punëmarrsit, ndonjëher edhe me tarifa minimale të pagesës. Nëse kjo nuk është e rregulluar as me kontratë kolektive dhe as me tarif minimale të pagesës atëherë për këtë profesion bëhet një pagë e zakonshme dhe e përshtatshme. Në realitet kjo në praktik, është vështirë të përcaktohet. Për këtë shkak është me rëndësi që të bëhet marrëveshje me shkrim me punëdhënsin. Gjithashtu pagesa e pushimit dhe e krishtlindjeve duhet të jetë e paraparë në kontratë që të bëhet pagesa e saj.
Informata detaje për kontratat e punës dhe pagesën gjenden në:
**www.arbeiterkammer.at/arbeitsrecht/arbeitsvertraege.htm**

### Sigurimi social

Çdo njeri që në Austri është i punësuar ose ka firmen e tij, automatikisht ka një sigurim social (sigurim idetyrueshem). Këtu përfshihet sigurimi shëndetsor, i aksidentit dhe pensional. Te punëmarrësit pagesa për sigurim social bëhet automatikisht çdo muaj nga rroga (shuma e pagesës varet nga shumae rrogës).

# Ndërprerja e marrëdhënies së punës

Ekzistojn disa mundësi për ndërprerjen e marredhënjes së punës. Zakonisht kontrata e punës ndërpritet me anulim të kontratës (Kündigung). Kjo mund të bëhet nga punëdhënsi ose punëmarrësi.

**Marrëdhënja e punës mund të ndërpritet me:**

- Shkëputje gjatë punës provuese;
- Kalimi i afatit të kontratës (te kontratat e afatizuara);
- Shkëputje e kontratës me marrëveshje (Auflösungsvertrag);
- Anulimi i marrëveshjes (Kündigung)
- Lëshimi nga puna i punëmarrësit prej punëdhënsit (ndërprerja e njëanshme)
- Lëshimi i punës nga punëmarrësi (ndërprerja e njëanshme)
- Vdekja e punëmarrësit

Shkaqet tjera dhe detajet i gjeni në adresën:
**www.arbeiterkammer.at/beratung/arbeitundrecht/beendigung**

## Letrat e punës

Me ndërprerjen e marrëdhënjes së punës punëmarrësit kanë të drejt në letrat e punës.

**Konkretisht këto janë:**

- Llogaria përfundimtare
- Çertifikatën e punësimit (Arbeitsbescheinigung)
- Vërtetimi mbi çlajmrimin nga Krankenkasse
- Vërtetimin e punës dhe pagesës
- Fletëpagesa e rrogës (Lohnzettel)
- Dëftesa e punës

Informacione më të sakta ne lidhje me këtë në adresën **www.help.gv.at** » Arbeit » Beendigung Arbeitsverhältnis » Arbeitspapiere

## Rregullimi i kompensimit për largim nga puna (Abfertigungsregelung)

Nën kushte të caktuara, pas ndërprerjes së marrdhënjes së punës, i takon punëmarrësit kompensimi për largim nga puna. Kemi dy rregulla për kompensim. Ajo e vjetër dhe e re. E drejtae vjetër e kompensimit, vlen për punëmarrësit që janë punësuar para 1 Janarit 2003. Pas ndërprerjes së marrëdhënjes së punës juve ju takon një pagesë. Te e drejta e re e kompensimit, kompensimi paguhet në të ashtuquajturën Betriebliche Vorsorgekasse.
Rregullorja e re vlen për punëmarrësit që e kanë filluar marrëdhënien e punës pas 1 Janarit 2003. Punëdhënësi nga muaji i 2 i punësimit duhet të paguaj 1,53 përqind nga rroga brutoe punëmarrësit (gjithashtu nga pagesa e pushimeve dhe krishtlindjet) bashkë me sigurimin social në Sigurimet Shoqerore (Krankenkasse). Sigurimet Shoqerore e kontrollojnë pagesën dhe e dërgojnënë Institutin Finaciar të Pensioneve (Abfertigungskasse).

Lartësia e kompensimit varet kryesisht nga shuma e kamatave të mëparshme të investuara. Me ligj është e garantuar shuma e mjeteve të paguara. Nëse e ndërpresim vet marrëdhënjen e punës, lëshimi nga puna me fajin tonë, lëshimi i punës parakohe si dhe para se të mbushen tre vjet pune, kompensimi nuk paguhet por mbetet në Institutin Finaciar të Pensioneve (Abfertigungskasse). E drejta në kompensim sipas rregullit të ri ekziston çdoherë gjatë mbarimit të marrëdhënjes së punës, nëse puna ka zgjatë më tepër se tre vjet, largimi nga punëdhënsi, largimi nga puna pa faj, lëshimi i drejt i punës, ndërprerja e punës me marrëveshje, kalimi i kontratës ose largimi nga puna për shkak shtatzanisë. Nëse ju takon e drejta për kompensim, atëhere mund ta zgjidhni njërën nga këto variante.

**Variantet e mundshme**

- Pagesa e kompensimit
- Investimi në Abfertigungskassen, ekzistuese
- Bartja e mjeteve në Abfertigungskasse e punëdhënsit të ri
- Transferimi në sigurim pensional plotësues
- Investimi në aksionet e fondit pensional
- Bartja në Pensionskassen ekzistuese të punëmarrësit

**Gjat zgjedhjes keni kujdes!** Brenda 6 muajve pas ndërprerjes së marrëdhënjes së punës ta bëni këtë me shkrim. Nëse nuk vendosni, të hollat do të paguhen mëtutje në në Institutin Finaciar të Pensioneve (Abfertigungskasse).
Informacione më të hollsishme ofron Oda e punëtorve dhe nënpunësve (Arbeiterkammer für Arbeiter und Angestellte) në Austri të Epërme si dhe sindikatat.

Detajet dhe kushtet për rregullimin e kompensimit gjenden në adresën
**www.arbeiterkammer.at/beratung/arbeitundrecht/abfertigung** abrufbar.

## Kompensimi i papunësisë (Arbeitslosengeld)

Kush e humb vendin e punës duhet sa më shpejt të lajmërohet si i papunë në Entin për punësim (AMS) që është përgjegjës për vendbanimin e tij, në rastin e vendbanimit në Linz është AMS – Linz. Këtu do të merrni ndihmë profesionale për gjetje të punës si dhe informata për kompensim gjatë kohës së papunësisë.
**Kompensimi i papunësisë** është i paraparë për të siguruar ekzistencën, gjatë kohës kur kerkoni punë. Parimisht të drejt në kompensim kanë të gjithë ata të cilët janë në disponim të Agjencisë së Punësimit që d.m.th.: nëse ofrohet një punë që mundet të bëhet nga personi,duhet ta pranoj atë patjetër. Pra duhet të ekzistoj gatishmëria të pranoj një punë në një shumë fikse minimale. Gjithashtu duhet që të ekzistoj minimumi i kohës së paraparë të punësimit dhe pagesës së sigurimit për kompensim të papunësisë.

Detajet: **www.ams.at/sfa/14080.html**

## Shërbimet dhe qendrat për këshilla

- **Arbeitsmarktservice Linz (AMS)**
  Bulgariplatz 17-19, 4021 Linz
  Tel.: 0732-6903
  ams.linz@ams.at
  www.ams.at/ooe

- **AK – Kammer für Arbeiter und Angestellte für Oberösterreich**
  **E drejta e punës,Këshillim për tatimetL Këshillim për arsim dhe profesion,**
  **Vende pune për mësim në profesion etj.**
  Volksgartenstraße 40, 4020 Linz
  Tel.: 050-6906-1
  info@ak-ooe.at
  www.ooe.arbeiterkammer.at

- **Wirtschaftskammer Karriereberatung**
  **Bildungs- und Berufsberatung, Lehrlingsstelle etc.**
  WIFI-Gebäude, Wiener Straße 150, 4020 Linz
  Tel.: 05-90 909-4051
  www.wko.at/ooe/karriere

- **Bildungs- und Berufsberatungseinrichtungen der Wirtschaftsförderungsinstitute (WIFI)**
  und der Wirtschaftskammern Österreichs
  www.wifi.at/bildungsberatung

- **Österreichischer Gewerkschaftsbund**
  Weingartshofstraße 2, 4020 Linz
  Tel.: 0732-66 53 91
  www.oegb.at

## Përkrahja gjatë themelimit të firmave–Këshilla për biznes:

- **Wirtschaftskammer Oberösterreich**
  Hessenplatz 3, 4020 Linz
  Tel.: 05-90 909
  service@wkooe.at
  www.wko.at » Oberösterreich

# BANIMI NË LINZ



# 3 BANIMI NË LINZ

Linzi, si qendër inovative dhe impulsive e Austrisë së Epërme ofron shumë. Kualiteti jetësor në të gjitha fushat si dhe shërbimet gjërsisht tëofruara, e bëjnë Kryeqytetin e krahinës (Land) së Austrisë së Epërme si vend i kërkuar. Aktualisht janë në disponim më shumë se 100.000 banesa – Ofert e cila vazhdon të rritet. Këtu duhet theksuarse qyteti i Linzit i kushton mjaft rëndësi banimit social. Qëllimi parësor është që sa më shumë njerëzve tu ofrohet mundësi banimi dhe standarte optimale jetsore me çmime të pranueshme sociale.
Informatat e hollësishme sa i përket temës së banimit gjenden në faqen e internetit të qytetit nën **www.linz.at/wohnen**. Për shembull, informatat për kërkesa dhe ndihma, info mbi të gjitha ndërmarjet aktive të banimit në Linz si dhe Adresat e kontaktaktit me Qendrat e Këshillimit. Poashtu këtu është një listë aktuale e projekteve të ndërtimit.

## Informatat e rëndësishme për kërkimin e banesës

### Çka duhet të kemi parasysh, para se të nisim me kërkimin e banesës?

- Sa kam mundësi të paguaj për qira në muaj? Pa i haruar edhe shpenzimet plotsuese fikse, siç janë pagesa e garazhdit, ngrohjes, rryma dhe uji i nxehtë, telefoni, sigurimi i banesës etj.
- Sa jan shpenzimet fillestarre (Maklertarifa, Kaucioni, Pagesa për sendet-Ablöse etj.), dhe a mundem ti mbuloj këto shpenzime?
- Sa duhet të jetë e madhe banesa? A përputhet kjo deshirë me mundësit financiare?
- Ku duhet të jetë banesa? Këtu duhet të merren parasysh a janë afër: transporti publik, çerdhja për fëmij (kindergarten), shkolla dhe merkatet ushqimore.

### Me të cilat shpenzime të njëhershme duhet të llogarisim?

- **Kaucioni:** Është pagesë sigurie, në rast se qiramarësi nuk e paguan qiran ose dëmet e shkaktuara në banesë. Kaucioni rregulisht është dy ose tre qiraja bruto (maksimal e lejuar deri në gjasht qiraj bruto). Vetëm atëher kur qiramaresi ia kthen objektin e banimit në gjendjen sipas marveshjes (Mietvertrag) qiradhënësit, ky është i detyruar që qiramarësit t`ia kthej kaucionin me kamat. Prandaj kur lidhet kontrata e banimit (Mietvertrag) duhet të bëhet një protokoll mbi gjendjen e banesës gjat pranimit, si dhe gjendjen e banesës kur dorzohet nga qiramarrësi.
- **Kostoja e ndërtimit:** Kostoja e ndërtimit duhet të paguhet nga qiramarësi nga mjetet vetanake, për banesën e ndërtuar me kontribut. Ajo zvoglohet 1% në vit, dhe kur lëshohet banesa kthehen këto mjete.
- **Anëtarsimi:** Në bashkësit e banimit Shoqëritë e Shpërndarjes së Banesave (Wohnungs-genossenschaften) ndonjëherë duhet të paguhet anëtarsim.

– **Provisioni ndërmjetsues:** Nëse me kërkimin e banesës autorizohet një ndermjetës immobiliar (Makler),duhet të paguhet provision ndërmjetsues në shumë prej gati tre qirash bruto.

– **Pagesa e taksave:** Pagesa e taksave për Kontratën e banimit (Mietvertrag) në Zyren financiar (Finanzamt) bëhet gjithashtu nga qiramarrësi.

– **Qiraja e parë:** Gjithashtu duhet të mos harrohet qiraja e parë mujore!
Para se të pranohet banesa duhet të sqarohet se si do të behet pagesa e shpenzimeve fillestare, përmes tërheqjes nga llogaria rrjedhëse ose librezës së kursimit. Me regull qiramarësi nuk është i obliguar ti blej mobiljet dhe rregullimet e Qiradhënësit.

**Tipp:** Blerja e mobiljeve dhe sendeve për banesë, gjithashtu kushton shum.
Në institucionet sociale shiten me çmime shumë të volitshme mobilje të dorës së dytë!

## Sa kushton banesa në muaj?

Për çdo muaj duhet t`i parapaguhet qiraja kryesore plus Tatimqarkullimi, dhe Shpenzimet e punes-Betriebskosten ( uji, kanali, mbeturinat, tatimi mbi pronë, mirmbajtja, energjia elektrikepër vendet publike etj.) Qiradhënësit – pa marr parasysh se kur meret rroga. Këtyre u **shtohen** dhe **energjia elektrikedhe** shpenzimet për ngrohje. Nuk duhet të harrohen shpenzimet për sigurimin e banesës, për Radio, TV, dhe kështu me radhë.

**Tipp:** Te shpenzimet për energji mund të kurseni shumë nëse e përdorni me kujdes!

## Si mund të vijm deri te banesa?

- Përmes Shoqëritë e Shpërndarjes së Banesave (Wohnungsgenossenschaft) ose Shoqatave të banesave (Wohnungsgesellschaft)
- Përmes ndërtuesve privat të banesave.
- Përmeszyrave immobiliare ose ndërmjetësve immobiliar.
- Përmes tregut privat (Shpalljeve në gazeta)

Shikuar në afat të gjatë, propozohet që, kërkimi i banesës të bëhet përmes lajmërimit në Shoqëritë e Shpërndarjes së Banesave(Wohnungsgenossenschaft) ose Shoqatave të banesave. Këtu me rregull, duhet llogaritur me pritje disavjeçare. Gjithashtu është e mundur që të paraqitemi në më tepër shoqeri immobiliarenjëkohësisht. Shpenzimet e lajmrimit kthehen që me qiranë e parë ose kur tërhiqet lajmrimi. Duhet të merret parasysh se madhësia e banesës nuk mund të zgjidhet. Vendimtar është numri i personave që do të banojn aty. Disa ndërmarje banimi kan kushte të veçanta për dhënjen e banesave Migrantëve. Informacione në lidhje me këte në Bashkësit konkrete të banesave Lista e Shoqatave dhe Bashkësive të banesave është në Shtojcën në fund të kapitullit. Si dhe në internet nën adresën **www.linz.at/wohnen.**
Të gjith atyre që urgjent ju duhet banesë, ka ofertë edhe në tregun privat të banesave. Përvoja tregon se këtu më së shpeshti lidhen kontrata me afat të caktuar, dhe me çmime mesatarisht të larta.

### Këshilla për gjetjen e banesës:

- Të lajmroheni sa më shpejtë në njerën prej shoqerive immobiliarepër banesa
- Lexoni regullisht shpalljet në gazetë
- Caktoni shpejt një orar për shikimin e banesës, pasi banesat e volitshme kërkohen
- Te zyrat immobiljare keni kujdes në provizionin ndërmjëtsues
- Shkruani shpallje në gazeta, online-në tregun e banesave, në Tabelat e shpalljeve në Supermarket, në Komunë, në Universitet etj. ( Ky lloj i Shpalljeve është gratis ose me çmime shum të volitshme).

## Marrja me qira dhe pranimi i banesës

Kontrata me shkrim për banim (Mietvertrag) është parakusht për të drejtën në ndihm për banim (Wohnbeihilfe). Me rëndësi është të lexohet në tërsi para se të nënshkruhet. Për ç`ështjet e hapura dhe të paqartatë kompensimit të qerasë,dhoma e të punësuarve (Arbeiterkammer) ofron këshilla juridike falas. Me pagesë mund të anetarësoheni edhe në bashkësin e interesit të qiramarrësve dhe ti shfrytzoni këshillimet e tyre. Këto ju përfaqesojn edhe në procedurat gjyqsore ose në vendet e zgjedhjes së mosmarveshjeve jasht gjyqit.

➲ **Arbeiterkammer Oberösterreich**
Volksgartenstraße 40, 4020 Linz
Tel.: 050-6906
mietrecht@akooe.at
www.arbeiterkammer.com

➲ **Mietervereinigung Österreichs**
Noßbergerstraße 11, 4020 Linz
Tel.: 0732-77 32 29
www.mietervereinigung.at

➲ **Mieterschutzverband Österreichs**
Lederergasse 21, 4020 Linz
Tel.: 0732-77 12 88
www.mieterschutzverband.at

➲ **Mieter-, Siedler- und Wohnungseigentümerbund Österreichs**
Obere Donauländе 7, 4020 Linz
Tel.: 0732-77 03 72-0
www.mieterbund.at

## Lista e plotë për pranimin e banesës

– Llogaria për pagesën e shpenzimeve fillestare
– Kontrata e qiramarjes (Mietvertrag) e nënshkruar
– Dorzimi i të gjithëçelsave të banesës
– Protokolli i dorzimit të banesësduhet patjetër të përpilohet sëbashku me qiradhënësin.
– e nevojshme, që gjendja e banesës, përkatësisht, dëmtimet ekzistuese dhe mangësit të fotografohen dhe të shkruhen në protokoll. Kështu që kur të lëshohet banesa të mos mbaj përgjegjsi qiramarësi.
– Te lexohet sahati i rrymës dhe ngrohjes

## Menjëher pas pranimit të banesës

– Lajmërimi i vendbanimit të ri  në qëndrën për shërbimin e qytetarëve (Bürgerservice), ose ne bibliotekat e qytetit
– Lajmrimi i Rrymës dhe Gazit ( Pagesat mujore nuk duhet të caktohen shum të ulëta që tu largohemi pagesave të larta, kur të bëhet barazimi, në fund të vitit)
– Urdhëres Postës që letrat që vijn në adresë të vjetër ti dërgoj në adresë të re (Postnachsendeauftrag)
– Rilajmrimi në adresë të re, i telefonit, TV-Kabel, internetit
– Me ndrimin e adresës duhet të njoftohen (P.sh. pundhënësi, AMS - enti për punësim, banka, sigurimi, krankenkassa, enti social, çerdhja e fëmijve, shkolla etj.
– Lidhja e kontratës për sigurim të banesës
– Riregjistrimi i Veturës (Mbrenda një jave te sigurimi)
– Dorzimi i kerkesës për kompensim qeraje (Wohnbeihilfe te Land Oberösterreich)

# Rreziku nga humbja e banesës, dëbimi

Këshilla dhe ndihmë, kur ekziston rreziku për humbjen e banesës, ofrojn këto katër Këshillimore sociale - Kompass të qytetit

➲ **Sozialberatungsstelle (Këshillimore Sociale) Kompass Nord**
Neues Rathaus, Hauptstraße 1-5, 4041 Linz
Tel.: 0732-7070-2766 bis -2770
kompass@mag.linz.at

➲ **Sozialberatungsstelle Kompass Ost**
Seniorenzentrum Franckviertel, Ing.-Stern-Straße 15-17, 4020 Linz
Tel.: 0732-66 62 72-20 bis -24
kompass@mag.linz.at

- **Sozialberatungsstelle Kompass Süd**
  Seniorenzentrum Neue Heimat, Flötzerweg 95-97, 4030 Linz
  Tel.: 0732-37 01 70-12, -15 oder -16
  kompass@mag.linz.at

- **Sozialberatungsstelle Kompass Auwiesen**
  Stadtteilzentrum Auwiesen, Wüstenrotplatz 3, 4030 Linz
  Tel.: 0732-30 27 31-19 oder -20
  kompass@mag.linz.at

Gjithashtu edhe **Verein Wohnplattform (Shoqata Platforma e banimit) si dhe Qendra për koordinim dhe prevencion për debim nga banesamundohen** që ti parandalojn dëbimet. Shoqata ndihmon në zgjedhjen e konflikteve dhe u ofron klientve banesa të përkohëshme me shoqërim social-pedagogjik.

- **Verein Wohnplattform**
  Harrachstraße 54, 4020 Linz
  Tel.: 0732-60 31 04 -0
  kontakt@verein-wohnplattform.at

## Lajmërimi i vendbanimit

Në Austri çdo ndërrim i vendbanimit duhet të lajmërohet me shkrimbrenda tre ditëve të punës. Vendbanimi i ri mund të paraqitet si vendbanim kryesor (Hauptwohnsitz) ose plotsues (Nebenwohnsitz). Si vendbanim kryesor vlen ai vendbanim me të cilin ekziston marrdhënie më e ngushtë. Kriteriet per këtë janë, p.sh.:

- Kohëzgjatja, vendi i punës ose i shkollimit. Piknisja për në punë ose vendshkollim.
- Vendbanimi i të tjerëve, parasegjithash anëtarve të mitur të familjes, dhe të vendit ku ata shkojn në çerdhe ose ne shkollë, pra ku shkollohen ose punojn.
- Funksionet në organet publike ose private

Vendbanimi kryesor është vendimtar, përveç kësaj edhe për regjistrim në listën e votuesve si dhe për ëmit tjera, si p.sh.: regjistrimin e veturës, ndihmën sociale. Gjithashtu është vendimtar për marrjen e banesës nga bashkësit e banimit (Gemeinnützige Wohngemeinschaft).

Lajmrimi i vendbanimit mund të bëhet në qendrën për sherbime publike (Bürgerservice Center) ose ne 11 bibliotekat në pjesët e qytetit. Me veti duhet të kemi një dokument me fotografi – ose pasaporta ose patentën e makinës bashkë me çertifikatën e nënshtetësisë. Po ashtu, në këto qendrat e shërbimit mund të bëhet edhe ç´lajmrimi, riregjistrimi i vendbanimit. Detajet për shërbimet e lajmrimit mund ti gjeni edhe në internetin e qytetit, nën adresën: **www.linz.at/meldeservice**.

- **Bürgerservice Center**
  Neues Rathaus, Hauptstraße 1-5, 4041 Linz
  Tel.: 0732-7070
  info@mag.linz.at
  Montag-Freitag: 7-18 Uhr

# Informata të veçanta për qiramarrësit

## Ndihmë për banim (Wohnbeihilfe)

Përmes ndihmës për banim ju ofrohetqytetarëve me nënshtetësi Austriake,qytetarëve të zonës për zhvillim ekonomik Europian (EWR), me të ardhuratë ulta, familjeve me shumë fëmijë, studentëve, nxënësve, familjeve ku punon vetëm një person (Alleinverdiener) si dhe pensionistëve, që të jenë në gjendje të paguajnë një banesë të përshtatëshme për ato.

U takon atyre që nuk janë nënshtetas të EWR-shteteve, nëse;

- mbi 5 vjet pa ndërprerje e kan vendbanimin kryesor në Austri
- kan të ardhura, prej të cilave jan të detyruartë paguajnë tatim
- në bazë të punës së tyre paguajnë sigurim social në Austri dhe nga i cili kanë të drejt të marrin ndihmë si dhe në 5 vjetët e fundit, ose 36 muajt e fundit kanë pas të ardhura ose ndihma.

Ndihma për banim është një ndihmë nga Landi që paguhet në muaj. Kryesisht ka dallim ndërmjet banesave me subvencion dhe banesave të pasubvencionuara të banimit. Qiramarrësi i një banese me qira (edhe nga qirradhënsi privat), nëse ekziston kontrata me shkrim e banimit e vërtetuar dhe e taksuar ne zyren e financave (Finanzamt), dhe plotsohen kushtet e parapara, ka të drejt në ndihmë banimi. Kerkesat (Antrag) dhe informatat e hollësishme mund ti merrni në departamentin për ndihmë banimi (Abteilung Wohnbauförderung) te Landit OÖ. Formulari i kerkesës për ndihmë gjendet edhe në **www.linz.at/wohnen** nën pikën Wohnbeihilfe.

➲ **Enti i Landit**
**Landesdienstleistungszentrum**
Bahnhofplatz 1, 4020 Linz
Tel.: 0732-77 20-141 40
wo.post@ooe.gv.at

**www.land-oberoesterreich.gv.at** » Themen » Bauen und Wohnen » Förderungen » Wohnbeihilfe

## Rregullorja e banimit (Hausordnung)

Në Linz për çdo shtëpi vlen një e ashtuquajtur Rregullorja e banimit, cila e rregullon bashkëjetesën. Këtu p.sh. është e rregulluar koha e qetësisë (Ruhezeiten), rregulli, pastërtia, siguria ose mbjajta e shtazëve. Për t´jushmangur problemeve dhe për arritjen e një mirëkuptimi, duhet patjetër të respektohet rregullorja e shtëpisë (Hausordnung).
Në përgjithsi, prej orës 22 në mbrëmje deri në ora 7 të mëngjesit vlen qetësia e natës (Nachtruhe). Në këte kohë është e ndaluar të bëhet muzik, të këndohet si dhe aktivitete tëtjera që bëjnë zhurmë. Por edhe gjatë ditës duhet të merret parasysh nevoja për qetësinë e fqinjëve – parasegjithash për njerzit e moshuar dhe femijët e vegjël. Nëse është e paraparëndonjë festë, atëherë duhet të bisedohetme kohë fqinjët.

**Tipp:** Kur të vendoseni në banesë është mirë të prezentoheni te fqinjët!

Te problemet me fqinjët, propozohet gjithherë, së pari, një bisedë sqaruese.Mirkuptimi reciprok dhe kosiderata janë bazë për fqinjësi të mirë!

## Mbajtja e kafshëve shtëpiake

Mbajtja e kafshëve shtëpiake është e rregulluar nëRregulloren e banimit (Hausordnung) ose/ edhe me kontratën për qira(Mietvertrag). Për mbajtjen e qenve vlen Ligji i Austrisë së Epërme për mbajtjen e qenve. Para se ta bleni kafshën, duhet të bisedoni me qiradhënsin dhe të merni pëlqimin prej tij, për mbajtjen e kafshës shtëpiake. Është e mundur që ndonjë racë e qenve mos të lejohet të mbahet si kafshë shtëpiake në banesë. Detajet për këte temë mund ti lexoni në internet në **www.linz.at/hund**.

**Tipp:** Mbajtja e reptilieve (p.sh. gjarprinj) dhekafshëvetë tjera të mbrojtura, duhet ti paraqitet menaxhimit të banesës (Hausverwaltung) dhe autoriteteve (Behörde).

## Sigurimi i banesës

Sigurimi i banesës është sigurimi i sendeve që i kemi në banesë. Çdo qiramarrës do të duhet që për banesën e tij të ketë sigurim. Se paku do të duhej sigurim kundër zgjarrit, dëmeve nga uji, era, thyerrja e xhamave, vjedhja, vandalizmi dhe nga ndikimi indirekt i rrufes. Krahas sigurimit të banesës është edhe sigurimi i përgjegjësisë. Ky mbron nga detyrimet e jetës së përditshme, të cilat e rrezikojn ekzistencën – si p.sh.për shkaktimin e një aksidenti ku jeni fajtor.

## Përdorimi i TV

Shpesh ekziston një lidhje për TV kabllovike. Për vendosjen e antenës satelitore duhet pelqimi (Genehmigung) i qiradhënsit. Për shfrytzimin e TV duhet të paguhet taksa për TV. Info më të hollsishme **www.gis.at**

## Hedhja e mbeutrinave

Hedhjae drejt e mbeturinave fillon në banesën e vetë. Ç´farë mbetet nga ndarja e **qelqit, letrave të vjetra, metalit, plastikës dhe mbeturinave bio,** hidhen në kazanin e mbeturina të pergjithshme . Këto mbeturina si dhe letrat e vjetra dhe mbeturinat bio merren nga LINZ AG.

Për gjuajtjen e **qelqit, metaleve të vjetra, stofet e lehta dhe tekstilet e vjetra** ekzisojn 4 qendra per mbledhjen e materialeve të vjetra, si dhe 450 vende me kontejner të shënuar për mbledhjen e mbeturinave në qytet. **Materijet problematike** (p.sh.: ngjyra, llaku, baterit, gomat,...) dhe mbeturinat nga druri duhet patjetër të dërgohen në qendrat për mbledhjen e materialeve të vjetra. E njejta gjë vlen edhe për **mbeturinat e mbyllura** (Sperrmüll). Për këto ofron LINZ AG një bartje falas. Caktimi i orarit bëhet përmes telefonit **0732-3400-68 08**.

Për pyetjet në lidhje me ndarrjen e drejt të mbeturinave ekziston telefoni **0732-2130** Këtu mundet të bëhen edhe ankesa, sugjerime për temën e mbeturinave si dhe lajmrimi për kontejneret e stërmbushura.

Informata të hollsishme për këtë temë gjenden në internet, nën **www.linzag.at** në pjesën LINZ AG SERVICE, nën pikën “Abfall”, si dhe në faqen ekzistuese informative.

**Tipp:** Nësë mbeturinat nuk ndahen sipas kontonjerit ku duhet të hidhenrriten shpenzimet fikse të shtëpisë!

## Dëmet në banesë

Për problemet ose dëmet që i takojnë qiradhënësit duhet të informohet kujdesta-ri i shtëpisë (Hausbesorger), menaxhimi i banesës, përkatësisht q iradhënësi. Tipp:Dëmet që nuk riparohen (si p.sh.: uji që pikon etj.) mund të kushtojnë shumë!

## Informatat për paqartësit

Informatat për të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësve dhe qiradhënësve mund ti merrni te menaxh-menti i shtëpisë.

Gjithashtu një shërbim special i qytetit të Linzit ju ndihmon me këshilla dhe veprime për çështjet e banimit dhe çështjet e qiramarrjes:

- **Schlichtungsstelle im Bezirksverwaltungsamt**
  Neues Rathaus, Hauptstraße 1-5, 4041 Linz
  Tel.: 0732-7070
  Schlichtungsstelle.bzva@mag.linz.at

  E hënë dhe E enjteora 7-12.30 dhe ora 13.30-18
  E martë dhe E mërkurë ora 7-13.30
  E premte ora 7-14

# Shërbim special për migrantët

Ndihmë dhe perkrahje sa i përket banimit, special për migrantët, ofrojn:

- **Caritas Flüchtlings- und MigrantInnenhilfe**
  Hafnerstraße 28, 4020 Linz
  Tel.: 0732-7610-2361
  www.caritas-linz.at

- **Volkshilfe Oberösterreich – Flüchtlings- und MigrantInnenbetreuung**
  Stockhofstraße 40, 4020 Linz
  Tel.: 0732-60 30 99
  office@volkshilfe-ooe.at
  www.volkshilfe-ooe.at

- **migrare – Zentrum für MigrantInnen Oberösterreich**
  Është i mundur këshillimi në gjuhën amëtare në bashkësinë e qirramarësve
  Humboldtstraße 49, 4020 Linz
  Tel.: 0732-66 73 63
  office@migration.at
  www.migrare.at

# Bashkësit e banesave në Linz

- **GWG – Gemeinnützige Wohnungsgesellschaft der Stadt Linz**
  Eisenhandstraße 30, 4021 Linz
  Tel.: 0732-76 13
  gwginfo@gwg-linz.at
  www.gwg-linz.at

  Orari: Qendra e klientëve: E hënë – E enjte: ora 7.30-16, E premte: ora 7.30-12

- **NEUE HEIMAT Oberösterreich Gemeinnützige Wohnungs- und SiedlungsgesmbH**
  Gärtnerstraße 9, 4020 Linz
  Tel.: 0732-65 33 01
  office@neue-heimat-ooe.at
  www.neue-heimat-ooe.at

  Orari: E hënë - E enjte: ora 8-12 dhe ora 13-15.30, E premte: ora 8.30-12

- **Gemeinnützige Wohnungs- und Siedlungsgenossenschaft FAMILIE in Linz**
  Hasnerstraße 31, 4020 Linz
  Tel.: 0732-65 34 51
  office@familie-linz.at
  www.familie-linz.at

  Orari: E hënë – E enjte: ora 8-15, E premte: ora 8-12

- **Gemeinnützige Wohnungs- und Siedlungsgenossenschaft BAUREFORM-WOHNSTÄTTE**
  Dinghoferstraße 63, 4020 Linz
  Tel.: 0732-65 81 45
  office@brw.at
  www.brw.at

  Orari: E hënë – E premte: ora 8-11.30, E enjte: ora 13.30-15

- **WAG Wohnungsanlagen Ges.m.b.H.**
  Mörikeweg 6, 4025 Linz
  Tel.: 0732-33 38-0
  info@wag.at
  www.wag.at

  Orari: E hënë – E enjte: ora 7.30-16.30, E premte: ora 7.30-13

- **Vereinigte Linzer Wohnungsgenossenschaften VLW**
  Blumauerstraße 19, 4020 Linz
  Tel.: 0732-65 34 61-0
  infocenter@vlw.at
  www.vlw.at

  Orari: E hënë – E enjte: ora 7.30-12.00 dhe ora 13.30-15.30,
  E premte: ora 7.30-12

- **Gemeinnützige Wohnungsgenossenschaft LEBENSRÄUME**
  Handel-Mazzetti-Straße 1, 4021 Linz
  Tel.: 0732-69 400-0
  office@lebensraeume.at
  www.lebensraeume.at

  Orari: E hënë – E premte: ora 9:00-12:00,
  E hënë - E enjte: ora 13:30-15:30

- **Gemeinnützige Landeswohnungsgenossenschaft für Oberösterreich (LAWOG)**
  Garnisonstraße 22, 4021 Linz
  Tel.: 0732-93 96-0
  office@lawog.at
  www.lawog.at

  Orari: E hënë – E premte: ora 9-12,E enjte: ora 13-16

- **Gesellschaft für den Wohnungsbau (GWB)**
  Blumauerstraße 46, 4020 Linz
  Tel.: 0732-70 08 68 - 0
  office@gwb.at
  www.gwb.at

  Orari: E hënë - E enjte: ora 7:30-12:00 dhe ora 13:00-16:00,
  E premte: ora 7:30-12:00

- **EGW Erste gemeinnützige Wohnungsgesellschaft Heimstätte Gesellschaft m.b.H**
  Gärtnerstraße 9, 4020 Linz
  Tel.: 0732-65 33 01
  office@egw-linz.at
  www.egw-linz.at

- **Gemeinnützige Industrie-Wohnungs-AG (GIWOG)**
  Welser Straße 41, 4060 Leonding
  Tel.: 050-88 88 - 199
  kundencenter@giwog.at
  www.giwog.at

  Orari: E hënë - E enjte: ora 8.00-12.00, E mërkurë: ora 13:00-15:30

- **WOHNUNGSFREUNDE Gemeinnützige Bau- und Siedlungsgesellschaft m.b.H.**
  Blumauerstraße 46, 4020 Linz
  Tel.: 0732-700 868-0
  office@wohnungsfreunde.at
  www.wohnungsfreunde.at

  Orari: E hënë - E enjte: ora 7:30-12:00 dhe ora 13.00-16.00, E premte: ora 7:30-12.00

- **Gemeinnützige Oberösterreichische Wohn- und Siedlergemeinschaft (WSG)**
  Ederstraße 9, 4020 Linz
  Tel.: 0732-66 44 71
  service@wsg.at
  www.wsg.at

  Orari: E hënë – E enjte ora 8:00-12:00 dhe ora13:00-15:00, E premte ora 8:00-12:00

- **Gemeinnützige DONAULÄNDISCHE Wohnungsgenossenschaft Linz**
  Stifterstraße 22, 4020 Linz
  Tel.: 0732-77 32 74
  office@dwg.at
  www.dwg.at

  Orari: E hënë – E premte: ora 8:00-11:00

- **Gemeinnützige Wohnbaugenossenschaft EIGENHEIM Linz**
  Schörgenhubstraße 43, 4030 Linz
  Tel.: 0732-31 87 24
  office@eigenheim-linz.at
  www.eigenheim-linz.at

  Orari: E hënë – E enjte: ora 8:00-12:00 dhe ora 13:00-16:00 , E premte: ora 8:00-12:0

- **Private Wohnungsgesellschaften**
  onlinenë faqen http://portal.linz.gv.at/Serviceguide/viewChapter.html?chapterid=122293

# SHKOLLIMI NË LINZ



# 4 SHKOLLIMI NË LINZ

Shkollimi në Linz ka një vend me rëndësi qendrore. Qyteti disponon një ofert të gjërë dhe të shumllojshme. Qyteti i Linzit i mirëmban 57 shkollat e obligueshme, pra kujdeset për ndërtesat e shkollave dhe pajisjen e tyre. Linzi ka 4 Universitete, 2 Shkolla të Larta Pedagogjike, dhe një Kolegj. Poashtu në arsim dhe arsimim të mëtutjeshëm ekzistojn shumë mundësi parasegjithash në institucionet e arsimit për të rritur (Volkshochschule) në Wissensturm, Bfi ose Wifi.

Informata për shkollat me arsim të detyrueshëm në Linz:

➲ **Schule und Sport Linz**
Pfarrgasse 7, 4041 Linz
Tel.: 0732-7070-0
ssl@mag.linz.at
www.linz.at/schule

Në Hompage Schule und Sport Linz,mund ta gjeni broshurën „Wir entdecken Linz" (Ne e zbulojm Linz-in) në pdf.-format. Ai është një libër shkollor për klasën e 3 dhe të 4 të shkollës fillore, i miratuar nga Ministria e Arsim, Art dhe Kulturë (bm:ukk), dhe përmban informata interesante për qytetin e Linz-it. Librit i është bashkangjitur plani i qytetit të Linz-it. Në faqen e pasme, për nxënësit/et janë përmbledhur informatat më të rëndësishme. Broshurën mund ta merrni në Drejtorinë Arsimore dhe Sportit në Linz. në tel. nr.:0732 / 7070-1400 ose 1401.

Informata të vlefshme për shkollat në Linz gjenden në **www.eduhi.at**.

## Sistemi austriak i arsimit

Nëse fëmija i ka mbushur 6 vjet me 31.Gusht, atëherë fillon me arsimin e detyruar në shtator të atij viti. Shkollimi i detyruar në Austri është 9 vjet. Nga mosha 3 vjeçare duhet të filloj arsimi parashkollor në kopshtin për fëmij, kurse 1 vit para fillimit të shkollimit kjo është e obligueshme. Në Linz është në fuqi zgjedhja e lirë e shkollës, në shkollën fillore dhe të mesme dhe ju mund ta lajmroni fëmiun tuaj në shkollën që deshironi. Derisa të gjith femijët deri në klasen e 4 shkojn në të njejtën shkollë, nga klasa e 5 ekzistojn më shum mundësi për zgjedhje. Këshillimi në lidhje me këte bëhet në shkollë gjat vijimit të klasës së 4.
Rëndësi e veçant në Linz, i kushtohet bashkëpunimit të shkollës me prindëtb ato kanë një rol të rëndësishëm në perkrahjen e femijve gjatë arsimimit.

Në adresën **www.linz.at/bildung/schulen.asp** mund ti gjeni të gjitha shkollat e Linz-it, meofertat dhe fokusimin e tyre. Një pasqyrë mbi të gjitha llojet e shkollave ka në **www.eduhi.at**

## Pasqyrimi i sistemit shkollor në Austri

| | |
|---|---|
| Klasa e 1. – 4. | Shkolla fillore / Shkolla bazë |
| Klasa e 5. – 8. | Shkolla e mesme„Shkolla e re e mesme“<br>Shkalla e ulët e arsimit të lartëtë përgjithshëm |
| Klasa e 9 | Shkolla Politeknike / Shkolla e mesme (PTS/FMS)<br>Shkolla e mesme profesionale (BMS)<br>Shkolla e lartë profesionale (BHS)<br>Shkolla e lartë për arsim të përgjithshëm (AHS) |
| Klasa e 10.- 12./13 | Mësimi i profesionit / Shkollë për profesion<br>Shkolla për arsim të larte të përgjithshëm<br>(AHS-Gjimnazi i lartë)<br>Shkolla e mesme ose e lartë për profesion (BMS,BHS) |

# Shkollat e detyrueshme në Linz

## Arsimi parashkollor

**Zgjat nga mosha 3 der 6 vjeçare**

Prej moshës 1 deri 3 vjeçare, prindërit që punojnë, kanë mundësi që fëmijët ti vendosin në çerdhe. Çerdhet janë vende ose grupe për përkujdesjen e fëmijve, d.m.th. përkujdesje për fëmij të vegjël. Prej moshës 3 vjeçare, qyteti i Linz-it, i ofronçdo fëmije një vend në një kopsht për fëmij, si pregatitje e rëndësishme për shkollë.

**Informacion: Kinder- und Jugend-Services Linz**
**Tel.: 0732-7070-0**

Nëse përcaktohet se fëmiu nuk është ende i përgatitur për të hy në shkollën fillore, mund të vizitoj klasën parashkollore.

## Informata për zgjedhjen e lirë të shkollës fillore dhe të mesme(Shkolla e dëshiruar)

Me zgjedhjen e lirë të shkollës fillore dhe të mesme (shkolla e dëshiruar), të drejtat e prindve dhe të kujdestarëve ligjor, forcohen në mënyrë masive. Ata nuk janë më të mvarur prej shkollës së rrethit dhe administratës shkollore. Nëse kërkesat në një shkollë jan më të mëdha se sa ka vende – qoft për shkaqe personeli, vendi ose shkaqe organizative – atëher për pranim vlejn kriterjet e qarta siç janë: vendbaniminë afërsi, vëllezërit/motrat që janë duke e vizituarshkollën; ofertat pedagogjike, vendi i punës së prindëve në afërsi të shkollës; përkujdesja familjare ose private në afërsi të shkollës; frekuentimi kopshtit për fëmijë në afërsi të shkollës.

## Shkolla fillore

**Zgjat 4 vjet, shpesh nga mosha 6 deri 10 vjeçare**

Në Linz ekziston zgjedhje e lirë sa i përket shkollës fillore. Prindët e fëmijve në arsimin fillor marrin një letër nga Drejtoria Arsimore ku kërkohet që fëmija ta regjistroj në një shkollë fillore. Perveç kësaj në disa shkolla ka përkujdesje pas orarit shkollor, ose edhe një strehim ditorë për fëmij (Hort) në afërsi. Pasi ta kryejn shkollën fillore, fëmijt kanë në disponim dy drejtime shkollore:
Shkolla e mesme (Hauptschule)/ “Shkolla e re e mesme“ NMS ose shkolla e lartë për arsim të përgjithshëm (AHS).

## Shkolla e mesme/„Shkolla e re e mesme“

**Zgjat 4 vjet, shpesh nga mosha 10 deri 14 vjeçare**

Në Linz, për shkollën e re të mesme (më herët shkolla e mesme), ekziston zgjidhje e lirë e shkollës. Shkolla e re e mesme është shkollë e përbashkët e obligueshme për 10 deri 14 vjeçarët, e cila është e hapur për të gjith nxënësit, pas mbarrimit të klasës së 4 të shkollës fillore.
Mësimi në shkollat e reja të mesme zhvillohet sipas planit mësimor të gjimnazit, dhe mund të organizohet si shkollë gjat tërë ditës. Numri mesatar i nxënësve në klasë sillet rreth 25. Në shkollën e re të mesme ka katër drejtime priotare:

- Gjuhët-humaniteti-shkencat shpirtërore
- Shkencat natyrore-matematikore
- Ekonomike-konsumi
- Muzika-kreativiteti

Format e veçanta ofrohen me sportin ose muzikën si prioritet.

Në kuptimin e shmangies së ndarjes së hershme të fëmijve në kriteriume të ndryshme të arsimit, shkolla e re e mesme ka për qëllim që të gjith fëmijve tu ofroj arsim themelor dhe/ose të thellësishëm. Mësimi i thellësishëm, është i mundur në lëndën e gjermanishtes, matematik dhe një gjuhë moderne (sipas rregullit anglisht). Në dëftesë ose mesazhin shkollor, nga klasa e 7 të, evidentohet se mësimi në lëndën përkatëse është absolvu si themelor ose si i thellësishëm, në të cilën lëndë nxënësit mësohen së bashku, e jo të ndarë sipas rezultateve të përcaktuara (të arritura). Përveç dëftesës, në fund të vitit shkollor çdo nxënësi/sje i jepet një përshkrim i kompetencave, ku përshkruhen aftësitë kryesore të nxënëses/it. Nxënësit/et përkrahen individualisht përmes formimit të grupeve në afat kohor, formimit të kurseve për përkrahje dhe mësimit nga grupi i mësuesve (Teamteaching).

Përfundimi i suksesshëm, ia mundëson nxëses/it - mvarsisht nga niveli i arritur në mësim – të vazhdoj shkollimin në një shkollë të mesme. Mundësit e kalimit në shkollë të mesme mvaren nga rrezultatet e arritura. Nëse nuk e arrin suksesin e nevojshëm për kalim në shkollë më të lart, nxënësi/ja mund të jap provim pranues.

Me përfundimin e suksesshëm të „Shkollës së re të mesme“, mund të vizitohen këto shkolla të mëtutjeshme:

- Shkolla e mesme për arsim të përgjithshëm
- Shkolla e lartë për aftësim profesional
- Shkolla e mesme profesionale
- Shkolla e obligueshme profesionale (Shkolla profesionale)
- Shkolla Politeknike

## Mundësit e përmbushjes së detyrimit shkollor pas klasës së tetë

Pas vitit të tetë shkollor, duhet të gjeni një shkollë tjetër për ta plotsuararsimin e detyruar.Nga kjo varet se cilin drejtim do të zgjidhni. Me rëndësi është që për shkollimin e mëtejshëm ta bëni zgjidhjen e drejt. Vendimi duhet të jet me kohë, dhe i menduar mirë. Gati se të gjitha shkollat organizojn „Ditët e dyerve të hapura“ ose edhe „Schnuppertage“. Me këto organizime ju jepet mundësia juve dhe prindërve tuaj për ofertat e mundëshme, informatat për kushtet e pranimit, planet mësimore dhe mundësit e profesionit.

Për klasën e 9 mund të zgjidhni si vijon.

- **Shkolla politeknike(PTS)** zgjat 1 vjet.
  Me vijimin e kësaj shkolle në klasën e 9 plotësohet arsimi i detyruar.
- **Klasa e pare e një shkolle për ngritje profesionale**
  (Shkolla e mesme profesionale–BMSoseShkolla e lartë profesionale–BHS)
- **Klasa e pestë e shkollës për arsim të lartë të përgjithshëm**– AHS

## Shkolla për arsim special (Sonderschule)

**Zgjat 8 ose 9 vjet**

Për femijt me nevoja të veçanta pedagogjike ka lloje të ndryshme të shkollave për arsim special si dhe mundësit për përkujdesje integruese.
Sqarim: Mungesa në njohjen e gjuhës Gjermane nuk është shkak për përkrahje specialepedagogjike. Vetëm ato nxënës te të cilët ka nevoj për masa speciale pedagogjike duhet të vizitojn shkollën për arsim special (Sonderschhule).

## Informata për shkollat i detyruar e:

- **Schule und Sport Linz**
  Pfarrgasse 7, 4041 Linz
  Tel.: 0732-7070-0
  ssl@mag.linz.at

- **Bezirksschulrat Linz Stadt**
  **Drejtoria Arsimore,**
  p.sh. problemet në procesin e mësimit
  Pfarrgasse 7, 4020 Linz
  Tel.: 0732-7070
  BZSR-LI.Post@lsr-ooe.gv.at

- **Schulpsychologische Beratungsstelle Linz-Stadt**
  Psikologu i shkollës është pergjegjës për të gjitha çështjet në shkollë sa i përket këshillimit psikologjik, trajnimit dhe shoqërimit . Është vendi për kontakt të parë për problemet shkollore dhe pyetjet që kan personat e prekur nga këtoçështje (p.sh. prindët, nxënësit/set, drejtorët, arsimtarët, inspektorët shkollor). Psikologët shkollor janë ekspert për këshillim psikologjik dhe këshilla për kërkuesit e këshillave. Kjo ofert është pa pagesë dhe sekret.

- **Schulpsychologische Beratungsstelle Linz-Stadt**
  Sonnensteinstraße 20, 4040 Linz
  Duhet të caktoni orar në tel.: 0732-7071-2291
  Schulpsychologie.Linz@lsr-ooe.gv.at
  www.lsr-ooe.gv.at/schulpsychologie

# Arsimi pas shkollimit të detyruar

## Mësimi i profesionit (Lehre)

### Zgjat 2 deri 4 vjet

Mësimi i profesionit është një mësim praktik në profesion, pas përmbushjes së shkollimit të përgjithshem të detyruar (kryerja e 9 klasave). Te modeli „Lehre und Matura"bëhet pregatitja për provimin e pjekurisë profesionale (Matura) gjatë mësimit të profesionit.

**Informatat:**
Berufsinformationszentren në Wirtschaftskammer (Qendrat për informim në Dhomën Ekonomike), Zyra e Punës (AMS), në internet në adresën **www.bic.at, www.lehrvertrag.at, www.frag-jimmy.at** ose **http://ooe.arbeiterkammer.at/beratung/bildung/lehrausbildung/Lehre_mir_Matura.html**
Enti Austriak i Punësimit ka gjithashtu një bazë të gjërë të dhënash për ato që kërkojn vende pune për nxënës **www.ams.or.at/lehrstellen**
Një listë të profesioneve që mund të mësohen mund ta gjeni në adresën: **www.berufslexikon.at/lehre**

## Shkolla e lartë për arsim të përgjithshëm (AHS)

### Zgjat 8 vjet

Shkolla e lartë për arsim të përgjithshëm (AHS) është 8 vjet. Fëmijt mund të regjistrohen menjëher pas shkollës fillore, ose suksesit të mirë shkollor gjatë 4 viteve në shkollë të mesme / „Neue Mittelschule" mund të kalojn në AHS. Pas mbarimit të klasës së 4 mund të vijohet një shkollë e mesme ose e lartë profesionale. Kjo perfundon me provim të pjekurisë (Matura), pastaj mund të vijohet mësimi në Universitet, Kolegj ose Institut të Lartë Profesional.

## Shkollat e mesme për ngritje profesionale(BMHS)

Në **shkollat e mesme për ngritje profesionale** (ose shkollë profesionale) ofrohet kualifikim në profesion dhe njohuri e përgjithëshme. Ajo zgjat 3 ose 4 vjet dhe mbaron me provim përfundimtar. Kualifikimi i mëtejshëm mund të bëhët p.sh. përmes provimit për pjekuri profesionale ose arsimim të mëtejshëm. Mëtutje ekzistojn shkolla profesionale një ose dy vjeçare.
Në një **shkollë të lartë profesionale** ofrohet kualifikimi i lartë në profesion dhe thellohen njohurit e përgjithshme. Ajo zgjat 5 vjet dhe mbaron me provim diplome të pjekurisë. Me këte arrihet mundësia për regjistrim në një shkollë të përgjithshme të lartë, si dhe – mvarrësisht nga lloji i arsimimit – kualifikim të caktuar në profesion (Kualifikim të dyfisht).

Në Austri ekzistojn këto drejtime të shkollimit:

- Shkollat teknike, ekonomike dhe të artit
- Shkolla tregtare
- Shkollat për profesione ekonomike
- Shkollat për modë dhe veshje
- Shkollat për turizëm

- Shkollat për profesione sociale
- Shkollat për bujqësi dhe pylltari
- Instuticione për pedagogjikën e mësimdhënies
- Instuticionet për pedagogji sociale

Informatat mund ti merni në: **http://www.bmukk.gv.at/schulen/bw/bbs/bmhs_uebersicht.xml**

## Ngitja e arsimit profesional

**Zgjat 3 vjet**

Me absolvimin, e së paku, një shkolle të mesme trevjeçare, përmes kurseve mund të arrihet në maturë dhe diplomim. Për absolventët/tet e disa shkollave katërvjeçare ka edhe forma përkatse të kolegjeve speciale.

## Informatat e arsimit pas arsimit të detyruar

Informatat e përgjithshme për shkollim te Ministrisë së Arsimit , Artit dhe Kulturës (Bundesministerium für Unterricht, Kunst und Kultur) është vendi i parë për informata dhe këshillime për çështjet dhe problemet në lidhje me temën shkolla si dhe në vijimin e shkollës dhe arsimit përmes **schulinfo@ bmukk.gv.at** ose përmes telefonit 0810 / 20 52 20 (me tarif lokale në krejt Austrinë). Informata të mëtutjeshme gjenden në adresën **www.berufsbildendeschulen.at** ose në qendrat e shërbimitpër shkollim të Bordit të Krahinës.(Landit) për shkollim.
Tel.: 0732-7071-1051, -2251
LSR@lsr-ooe.gv.at

# Mënyra e dytë për diplomim

Kush nuk e mbaron shkollën ose aftësimin personal, ka mundësi që ta mbaroj si shkollimin e mesëm ose arsiminprofesional por edhe maturën ta bëjë më vonë. Ofertat e shumta të shkollave të natës, sidomos për të punësuarit ofrojn mundësi për shkollim individual të mëtejshëm.
Informatat: **www.linz.at » Bürgerservice » Service A-Z » Bildung-Schule**

**Kryerja e shkollës së mesme:** Në form të provimit ekstern ka mundësi ta kryeni shkollën e mesme. Në çdo qark administrativ (Bezirk), ka një shkollë që funksionon si vend për provime. Zyra e punës (AMS) ofron gjithnjë mundësi që në institutet e ndryshme, përmes kurseve të kryhet shkolla e mesme.

**Mesimi i profesionit:** Personat pa shkollim në profesion, mund ta kryejn shkollimin,

- nëse i kanë të mbushur 18 vjet, dhe i plotsojn kushtet në aftësi dhe dije për shkollim në profesion dhe këtë e kanë arrijnë në forma të tjera.
- nëse së paku, gjysmën e kohës së nevojshme për shkollim e kanë përfunduar, por nuk kanë mundësi të lidhin kontratë për mësim të mëtejshëm në profesion..

Informata më të hollësishme mund të merrni në Zyrën e Stazhierëve në Dhomën e Ekonomisë **Lehrlingsstelle der Wirtschaftskammer OÖ.**

**Provimi i aftësimit në profesion:** Provimimi i aftësimit në profesion, është krahas AHS- dhe BHS-me provim të pjekurisë në Austri, është mundësia e tretë për ta bërë maturën.

**Provimi për të drejtë studimi:** Ky provim mundëson studimin në një drejtim të caktuar në Universitet, Kolegj ose Institut të lartë profesional. Ky vlen vetëm për një drejtim të caktuar studimi ose për degë të përafërta, dhe nuk është i njehësuarpër shkollë të lartë të përgjithshme.
Informatata në: **www.erwachsenenbildung.at**

## START -Bursë studimi ( për fillestar)

Prej shtatori 2013 edhe në Austri të Epërme ekziston Bursë për fillestar (START-Stipendium). START ju jep Bursa nxënësve të angazhuar migrant, të cilët i kan kushtet e dobëta financiare.Qëllimi është që këtyre të rinjëve migrant të ju ofrohet mundësia për të mbaruar shkollim të lartë dhe kështu tu ofrohet shansa për një Integrim të suksesshëm. Bursistët kanë një funksion si shembull i mirë dhe motivim për të tjerët.Ata tregojn me shembullin e vet, se në Austri , me punë dhe angazhim mund të arrijnë qëllimet e tyre. Nga ana tjetër edhe shoqëria përfiton nga potenciali interkulturor i këtyre të rinjëve. START-Oberösterreich është një projekt që realizohet nga Raiffeisenlandesbank Oberösterreich AG, e cila së bashku me Qeverinë e Austrisë së Epërme(Land OÖ) dhe partnerëtëtjerë.Sekretariati Shtetëror për Integrim e ka marrë përkujdesjen dhe Bundesministeriumi për punë të Brendshme e përkrah START-in në nivel Austriak.Bursat financohen përmes Sponzorimeve nga Firmat, personat privat, organizatat kreative, ose me ndihmat që vijn nga grupet e interesit. Një herë, gjat vitit shkollor (gjithmon në pranver) u dërgohen dokumentet për konkurs të gjithë shkollave me matur në Austri të Epërme.Koha më optimale për konkurs, tre vjet para maturës.Për çdo vit në këtë program pranohen rreth dhjetë të rinj, oferta e rradhës është në pranver 2014.

Raiffeisen Landesbank Oberösterreich

START
Stipendien für engagierte Schülerinnen und Schüler mit Migrationshintergrund
www.start-stipendium.at



Financohen  nxënësit pa marr parasyshnacionalitetindhe statusin e qëndrimit të nxënësve, të cilët,

- Vizitojn shkallën e lartë të një shkollë të lartë të përgjithshme, ose shkollë të lartë/të mesme për ngritje profesionale, shkollë të natës ose Modelin arsimim me matur dhe e kan qëllimin që të maturojn,
- Vet ose njeni prej prindëve gjuhën gjermane nuk e ka gjuhë amëtare,
- Angazhohennë aspekt shoqëror d.m.th. social,
- kanë rezultate të mira në shkollë, dhe
- nuk kanë përkrahje të mjaftueshme financiare ose personale nga prindërit e tyre.

Të rinjët, përmes bursës START-Stipendium e fitojn këte përkrahje:

- 100 Euro në muaj, të holla për blerje dhe aktivitete shkollore (p.sh. material për mësim, mësim plotsues të nevojshëm, shpenzime për kultur)
- deri në 700 Euro të holla plotësuese për vit shkollor (p.sh. ekskurzion me klasën, mësim plotësues)
- një pajisje themelore kompjuterike  (Laptop, Printermultifunksional)
- një takim vjetor të bursistëve në nivel austriak
- dy seminare arsimore në fundjavë
- një program të zgjeruar të Workshop-eve ekskurzione
- Seminare të posaçmedhe këshillime për mundësit e studimit dhe orientimit profesional
- Këshillime dhe përkrahje  ndividuale

Të gjitha informatat për bursënSTART-Stipendienprogramm mund ti gjeni në **www.start-stipendium.at.**

## Arsimi pas maturës

Pas maturës ekzistojn mundësi të shumta për arsimim të mëtejshëm.

### Kolegjet

**Zgjat 2 ose me punë 3 vjet**

Kolegjet i kanë gati se të gjitha drejtimet për shkollim professional. Ato u mundësojnë maturantëve, në afat të shkurtër arsimin profesional. Arrihet i njejti përfundim sikurse me arsimin  5 vjeçar në shkollë të lartë (Provimi i diplomës).

Informatat: **www.bmukk.gv.at**

### Shkolla e Lartë Pedagogjike

**Zgjat 3 vjet (6Semestra**

Shkollat e Larta Pedagogjike ofrojn një arsimim të lartë (Akademik) në fushat pedagogjike (Shkollimi për mësues/e)

Informatat: **www.abc.berufsbildendeschulen.at**

# 4 SHKOLLIMI NË LINZ

Në Linz ka 2 shkolla të larta pedagojike:

- **Pädagogische Hochschule Oberösterreich**
  Kaplanhofstraße 40, 4020 Linz
  Tel.: 0732-7470-0
  office@ph-ooe.at
  www.ph-ooe.at

- **Private Pädagogische Hochschule der Diözese Linz**
  Salesianumweg 3, 4020 Linz
  Tel.: 0732-77 26 66
  office@ph-linz.at
  www.phdl.at

## Studimi në kolegj

**Studime Bachelor: 6 semestra – Diplomim: Bachelor / Studime Master: 2 deri 4 semestra, Diplomim Master**

Diplomimi ne studimin Master  mundëson studimin për Doktoratur në një universitet:
Informata dhe detaje tjera mund të gjeni në: **www.fhr.ac.at**

## Fachhochschule Oberösterreich, Campus Linz

Kolegji i Austrisë së Epërme në Linz ofron mundësi studimi në shëndetsi dhe në lëmit sociale. Studime-Bachelor janë teknika e mjekësisë, për Punë Sociale dhe Administrata dhe menaxhim Social. Studime-Master janë Teknika e Mjekësis, Services of General Interest dhe Puna Sociale dhe Management for Health Professionals – drejtimi kryesor menaxhimi i spitaleve

- **FH OÖ Studienbetriebs GmbH Fakultät für Gesundheit/Soziales**
  Garnisonstraße 21, 4020 Linz
  Tel.: 0732-2008-0
  officeping@fh-linzpong.at
  www.fh-ooe.at/campus-linz

## Kolegji për profesionet në shëndetësi

Ky kolegj ofron shtatë drejtimet Bachelor dhe Master për profesione në shëndetësi në Austrinë e Epërme në Linz, Steyr dhe Wels.Shkollimi për profesionet në shëndetësi janë të pranuara në nivel internacional.

Studimet Bachelor:

- Analitika e biomedicinës
- Ergoterapia
- Logopedia
- Teknologjia e Radiologjisë
- Dietologjia
- Mamia
- Fizioterapia

Studimet Master:

- Management for Health Professionals – drejtimi kryesor menaxhimi i spitaleve Studimi Master
- Didaktika e lartë për profesionet në shëndetësi

➲ **FH Gesundheitsberufe OÖ GmbH**
Semmelweisstraße 34/D3, 4020 Linz
Tel.: 050-344-20000
www.fh-gesundheitsberufe.at

## Universitetet në Linz

Në Linz mund të studjohet në 4 Universitete.Në shkollat e larta është i mundur studimi për Bachelor, Master, Diplom dhe Doktoratur.

➲ **Johannes Kepler Universität (JKU)**
„JKU“ disponon me një Fakultet të Drejtësisë, Ekonomisë dhe ekonomisë sociale si dhe Fakultetit teknik dhe i Shkencave Natyrore. Fakulteti i Mjekësisë në Linz është në plan.

Altenberger Straße 69, 4040 Linz
Tel.: 0732-2468-0
www.jku.at
Ndhimë për studentët dhe këshillimi në: Tel.: 0732-2468-1381 ose -1311

➲ **Universiteti për Art dhe Dizajn Industrial**
**(Universität für künstlerische und industrielle Gestaltung)**
Universiteti i Artit disponon këto institute: „Bildende Kunst und Kulturwissenschaften“, „Kunst und Gestaltung“, „Medien“, „Raum und Design“. Mbi një bazë të shkëlqyeshme profesionale në këto drejtime,Universiteti i Artit parasegjithash ofron një urë lidhëse në mes fushës së Arkitekturës, Dizajnit, planifikimit hapsinor në qytet , Ekologjisë e të Mediave.

Hauptplatz 8, 4010 Linz
Tel.: 0732-7898-0
www.ufg.ac.at

➲ **Anton Bruckner Privatuniversität**
Në UniversitetinBrukner studentët studjojnë muzikë, aktrim dhe vallëzim.

Wildbergstraße 18, 4040 Linz
Tel.: 0732-70 10 00-0
www.bruckneruni.at

➲ **Katholisch-Theologische Privatuniversität Linz**
Univerziteti privat Katolik-Teologjik ka Fakultetin katolik-teologjik dhe Institutin për shkencën e Artit dhe Filozofi.

Bethlehemstraße 20, 4020 Linz
Tel.: 0732-78 42 93
www.ktu-linz.ac.at

## Institucione tjera

- **LIMAK – Austrian Business School**
  LIMAK, si Business School, e Universitetit Johannes Kepler, është i njohur në fushën e shkollimit të  personaliteteve udhëheqëse.

  Bergschlößlgasse 1, 4020 Linz
  Tel.: 0732-66 99 44-0
  limak@jku.at
  www.limak.at

- **Qendra për shkollim në medicinë në AKhLinz**
  Qendra për shkollim medicinal ofron shkollime në degën e shëndetësisë dhe të përkujdesjes: Akademi të ndryshme, shkollim në shëndetësi dhe përkujdesje ndaj të sëmurëve, shkollimi special, ndihmë në përkujdesje (Pflege), përkujdesja profesionale të pleqëve dhe ndihmë sanitare.

  Paula-Scherleitner-Weg 3, 4021 Linz
  Tel.: 0732-7806
  office.medaz@akh.linz.at
  www.linz.at/akh/medaz.asp

## Nostrifikimi, pranimi i diplomave dhe shkollimi jashtë vendit

Nëse ju, në vendlindjen tuaj keni filluar shkollimin ose e keni kryer ate, keni mundësi që të bëni kërkesë për njohjen ose nostrifikimin e shkollimit ose të diplomës. Ju mund të vëzhdoni shkollimin, të studjoni ose të punësoheni në profesion.

**Nostrifikimi:**
Në bazë të programeveaustriake të arsimit, diploma mundet (nëse plotsohen parakushtet) të njehësohet edhe nga  një shtet tjetër. Me këte i fitoni ju të gjitha të drejtat si me diplomën austriake p.sh. e drejta për studim. Nëse ndonjë lëndë nuk keni dëshmi të mjaftueshme, atëher duhet të jepni provime plotësuese (provime të nostrifikimit). Në disa raste kërkohet që diploma të vërtetohet nga institucionet që e kanë dhënë diplomën jasht vendit. Instituti përgjegjës është Minisria e Arsiit, Artit dhe Kulturës.

Informatat: **www.berufsanerkennung.at**
AST–Zyra për personat që janë të kualifikuar jashtë vendit (Austrisë)
**http://www.migrare.at/cms1/index.php/angbote-kompetenzzentrum/ast-anlaufstelle**

**Ekuivalenca:**
Edhe shkollimet në profesion si p.sh. shkollimi në profesion ose provimet për mjeshtër në një profesion mund të pranohen në Austri. Në këtë rast flitet për ekuivalence (caktimi i vlerës së njejt). Instituti përgjegjës është Ministriapër Ekonominë, Familjen dhe Rininë.
Informatat: **www.bmwfj.gv.at**

# Arsimi itë rrriturve

Partner të rëndësishëm, në aftësim dhe ngritje të mëtejme profesionale janë Volkschochschule **VHS** në Wissensturm, qendra për arsim **MED në AKh Linz**, Wirtschaftsförderungsinstitut (Instituti për Zhvillim Ekonomik) **WIFI** dhe Berufsförderungsinstitut (Instituti për ngritje profesionale) **bfi, BBRZ.**

## Ndihma financiare për arsimin e të rriturve

- **Bonusi për arsim i AK të Austrisë së Epermë**
  Në kuadër të AK-Plus-Bildungsprogram i odës së punëtorve (AK) u ndihmon anëtarve të vet të kualifikohen në profesione kyçe si p.sh. EDV, gjuhë të huaja, kontabilitet, etj. Kryerja e shkollës së mesme ose kurse integruese është rruga e dytë e arsimimit. Për kurse dhe organizime të institutit për ngritje profesionale në Austri të Epërme (bfi) dhe shkollës për të rritur të Austrisë së Epërme dhe të Linzit, anetarët e Dhomës së Puntorëvë AK, me kartën e antarësis kanënjë ofertë.Përveç kësaj çeku i kulifikimit tëAK- (Bildungsbonus) vlen për „AK-Plus-Bildungsprogramm-in“.

- **Arbeiterkammer**
  Volksgartenstraße 40, 4020 Linz
  Tel.: 050-6906
  Informatat dhe në kurs në Hotline 050-6906-555
  www.ooe.arbeiterkammer.at
  Informatapër kartën e anëtarsisë mund të merrni në këtë numër:
  Tel.: 050-6906, mitglieder@akooe.at

- **Konto e arsimit e Austrisë së Epërme**
  Masat e arsimit që i shërbejn aftësimit të mëtejm profesional ose rikualifikimit, nën parakushte të caktuara, ndihmohen përmes „Oberösterreichische Bildungskonto“

- **Amt der Oberösterreichischen Landesregierung**
  Integrimi, shkollimi dhe shoqëria
  Bahnhofplatz 1, 4021 Linz
  Tel.: 0732-7720-14 900
  bildungskonto@ooe.gv.at

## Kushndihmohet?

- Punëtoreve dhe punëtorve, pra personave që janë në marëdhënje pune
- Personave që kanë pagesë për përkujdesjen e fëmijve, personave në karenz dhe në kompensim javor
- Atyre që rikthehen pas pushimit të përkujdesjes së femijës (karenz), atyre që kerkojn punë në AMS dhe nuk marin përkrahje nga AMS
- Të punësuarve me orar të shkurtuar pune
- Personave që marrin kompensim si të papunë ose ndihmë sociale
- Punëtorëve me kontratë
- Personave me arsim akademik, të cilët në muaj nuk fitojn më tepër se1.500 Euro brutto
- **Firmave me një person, maksimumi 2 të punësuar me orar të shkurtuar ose 2 stazhier (maksimumi 2 persona)**

## Ç´farëndihmohet?

– Mbulohen shpenzimet e kursit për arsimim

## Cilët parakushte duhet të plotësohen?

– Vendbanim i përhershëm në fillim të kursit në Austri të Epërme
– Arsimimi (Kurset, Seminaret, Shkollat për Mjeshtër, Akademitë Profesionale) duhet të shërbej për aftësim të mëtejm ose rikualifikim
– Masat e arsimit duhet të bëhen përmes institucioneve me vulën për kualitet të arsimimit të të rriturve në Austri të Epërme ose që janë të çertifikuara sipas procesit të ngjajshëm për absolvim
– 75 perqind pjesmarrje në shkollimit dhe pjesmarrja të vertetohet.

## Këshillimi për arsimin e të rriturve

Shkolla për të rritur (Volkshochschule) në Wissensturm, Oda e Punëtorve (Arbeiterkammer) në Austri të Epërme dhe Qendra për Këshillim në arsimimin e të rriturve, në oraret fikse ofrojn këshilla individuale për shkollim dhe për zgjedhjen e profesionit. Gjithashtu do të merrni informata për përkrahjet siç janë: pushimin pa pagesë për arsimim, shkollimi me orar të shkurtuar ose për ti dhënë provimet që ju mungojnë.

➲ **Volkshochschule Linz**
**Wissensturm**
Kärntnerstraße 22, 4020 Linz
Tel.: 0732-7070
vhs-bib@mag.linz.at
www.vhskurs.linz.at
Pas orarizimit përmes telefonit, E martë: ora 16-19

r

➲ **Arbeiterkammer Oberösterreich (AK)**
Volksgartenstraße 40 – Beratungszentrum, 4020 Linz
Tel.: 050-69060
info@ak-ooe.at
www.ooe.arbeiterkammer.com
Këshillim personal:
E hënë – E enjte: ora 7:30-16:00, E premte: ora 7.30-13:30
Këshillim përmes telefonit të marten deri në ora 19:00

➲ **Amt der oberösterreichischen Landesregierung**
Direktion Bildung und Gesellschaft
Bahnhofplatz 1, 4021 Linz
Tel.: 0732-7720
bi.post@ooe.gv.at
www.land-oberoesterreich.gv.at
E martë – E enjte: ora 8:00-17:00

➲ **Këshillimi për karrier në Odën ekonomike të Austrisë së Epërme (WirtschaftskammerOberösterreich)**
Këshillimi për shkollim dhe profesion në formë të një analize të potencialit (me pagesë), Oraret sipas marrëveshjes
Wiener Straße 150, 4021 Linz
Tel. 0590909-4051
wko.at/ooe/karriere

## Institucionet për arsimin e të rriturve

➲ **Wissensturm**
Ndërtesa e Diturisë (Wissensturm i qytetit te Linz-it9 gjendet përball Stacionit hekurudhor. Aty janë të vendosura Volkshochschule, biblioteka e qytetit si dhe bibleoteka për gjuhë të huaja, një qendër për mësim, puntori e mediave në të njejtën kohë dhe "Hot-Spot" me internet falas.

Wissensturm është **i hapur për të gjithë** dhe si „qendër për integrim"nxit bashkëjetesen e njerzëve nga vende dhe me kulturë të ndryshme. Për migrantët ka shumë oferta speciale të shkollimit dhe medime. Një çështje tjetër kyçe është mësimi i gjuhëve. Në Service-Center ofrohen edhe Shërbimi për qytetarët(Bürgerservice).

**Arsimi bazë** është ofertë shumë e rëndësishme e ketij. Kjo u ofrohet sidomos njerzve që nuk e kanë pasur të lehtë ta bëjnë shkollimin. Këta janë personat që nuk e kanë të kryer shkollimin. Kurset e ofruara për arsimin bazëndihmojn në përmirsimin e aftësive në lexim dhe llogaritje si dhe njohuri bazë kompjuterike

Kurset e mëtutjeshme ofrojn pregatitje për kryerjen e shkollës së mesme. Këshillimi personal dhe përmes telefonit (0810 / 20 08 10) e lehtëson zgjedhjen e drejt të ofertës së arsimit bazik. Në kurset për ngritje profesionale janë kurset për pregatitjen e provimit për mjeshtër. Kurse ofrohen posaçërisht për nënat si dhe për personat që ende nuk flasin gjermanisht.

Programi vjetor i organizimeve në **Shkolla për të rritur(Volkshochschule)** ofron 2.000 kurse ose ligjerata. Mbi 100.000 libra, filma dhe CD jan në disponim në **Bibliotekën e qytetit.** Në **qendrën e mësimit në Wissensturm (LeWis)** mund të gjenden vendet e punës me internet, stacionet për dëgjim si dhe vendet me TV dhe DVD mundësojn mësim dhe kalim kohe të lirë. Kombinimi në mes mësimit në kurse dhe përmes mediumeve, ofrohet në 7drejtime: shoqëria dhe politika / natyra dhe teknika / shëndetësia dhe mirëqenia / jetesa dhe banimi / arsimimi dhe profesioni / kultura dhe kreativiteti / gjuhëte huaja

**Wissensturm**
Kärntnerstraße 26, 4020 Linz
Tel.: 0732-7070
www.linz.at/bildung/wissensturm.asp

- **Berufsförderungsinstitut (bfi)**
  Instituti i Orientimit Profesional (Bfi) ofron një spektër të gjërë të masave për kualifikimtë mëtejm profesional krahas punës, përmes seminareve, Workshop-eve, kurseve si dhe këshillime dhe masa tjera të politikave të tregut të punës.

  Raimundstraße 3, 4020 Linz
  Tel.: 0732-6922, www.bfi-ooe.at

- **BBRZ-Gruppe**
  Qendra e Rehabilitimit Profesional( BBRZ) është grupi më i madh për shkollim dhe shërbime sociale në Austri. Kërkesa dhe detyrimi i BBRZ është që njerzitaktivpër punë, ti përkrah dhe ti orientojë,që aftësit dhe shanset e tyre personale, ti shfrytëzojnë dhe ti zhvillojnë. Në kuadër të Grupit BBRZ janë BFI, BBRZ Reha GmbH dhe FAB (Shoqata për përkrahje të punës dhe të punësimit). Këto organizata punojnë për grupe të ndryshme, fushëveprimtaria është „arsimimi profesional“, „rehabilitimi profesional“ si dhe „punë dhe ndërmjetsim“.

  **BBRZ-Gruppe**
  Grillparzerstraße 50, PF 322, 4021 Linz
  Tel.: 0732-6922-0, www.bbrz-gruppe.at

- **Das BIZ Berufsinformationszentrum des Arbeitsmarktservices**
  Ofron mediateka moderne me shumë material informues, broshura, dosje informative, videofilma, dhe PC pa pagesë.

  Bulgariplatz 17-19, 4021 Linz
  Tel.: 0732-6903

- **Wirtschaftsförderungsinstitut (WIFI)**
  WIFI ofron kurse në fusha të ndryshme për arsim dhe aftësim të mëtejm profesional. Detyrimet e veta i sheh në aftësimin e personave dhe organizatave, të angazhuar në ekonomi, që tu përgjigjen nevojave bashkëkohore.

  Wiener Straße 150, 4021 Linz
  Tel.: 05-7000
  www.ooe.wifi.at, www.wifi.at/bildungsberatung

- **Karriereberatung der Wirtschaftskammer OÖ**
  Wiener Straße 150, 4021 Linz
  Tel.: 05-90 909-4052, wko.at/ooe/karriere

- **PGA Akademie**
  Akademia PGA ofron kurse/seminare për shkollim dhe shkollim të mëtutjeshëm në drejtimet Shëndetësi, Psikologji, Pedagogji dhe Sport, si dhe këshillimin përkatës për shkollim të tillë. Katalogun mund ta porositni në: 0732/787810 dhe në faqen www.pga.at

  **PGA, Verein für prophylaktische Gesundheitsarbeit**
  Museumstraße 31a, 4020 Linz
  Tel.:0732-77 12 00, office@pga.at

## Gjuha,çelsi i suksesit

Kush dëshiron të shkollohet ose të punoj në Austri,duhet patjetër të flas dhe të shkruaj në Gjuhën gjermane. Për ta mësuar drejtë një gjuhë, është e mundur përmes përsëritjes së vazhdueshme. Kurset profesionale të gjuhës gjermane e lehtesojnë mësimin. Në Ndërtesën e Diturisëdhe në shumë institucione të arsimit ofrohen kurse të gjuhës për fillestar dhe të avancuar.

## Përkrahja e fëmijve në mësimin e gjuhës

**Promovimi i ri i gjuhës në kopshtet e fëmijve të qytetit**

Prej vjeshtës 2011 të gjithë djemt dhe vajzat në kopshtet e fëmijve të qytetit – me ose pa prejardhje migrante -testohen dy herë në vit, për njohurit e tyre nëgjuhës gjermane. Nëse një fëmije konstatohet mungesë e njohurisë së gjuhës, nis menjëherë përkrahja për mësimin e gjuhës. Qëllimi kryesor është ngritja e njohurive të gjuhës deri sa fëmija të nisë shkollën. Fëmija për tre vjet sa është në kopsht i ka gjithsej 540 orë mësimi plotësuestë gjuhës gjermane që i përshtatet moshes së tij. Ky program i gjithpërfshirës për mësimin e gjuhës, është unik në Austri. Se sa kjo iniciativë është e suksesshmee tregon një studim ngaUniversiteti i Hamburgut 2012. Aty shihet që fëmijët që kanë përkrahjen në mësimin e gjuhës kanë treguar përmirësim të dukshëm në njohjen e gjuhës gjermane.

**Çanta e shpinës me libra me fotografi (Bilderbuchrucksack)**

Së bashku me Institutin për Literaturën për të Rinj, në vitin 2011 në tetë objektet e kujdesit të qytetit nisi projekti Kopshti me Libra me fotografi (Bilderbuchkindergarten). U zgjodhën gjithsejt 12 libra me fotografi, nga prodhimi më i ri në gjuhën gjermane. Përmbajtja e këtyre librave, qëndron kryesisht në tema relevante shoqërore siç janë migracioni, ksenofobia ndaj të huajve, varfëria dhe roli i gjinive. Pasi u lexohet, dhe njoftohen melibrat ecaktuar fëmijët, zgjidhet një libër së bashku me fëmijët, dhe ai përpunohet dhe interpretohet në mënyrë kreative nga fëmijët.Rezultatet – vizatimet, tekstet, punët zejtare, fotografit, etj. – një herë në vit, në vende të ndryshme në Linz, prezentohen në mënyrë publike.

**Nëna meson gjermanisht**

Nënat me prejardhje migrante, nganjëher me arsimim të disfavorshëm, kanë deficite edhe ne gjuhën e tyre amëtare. Te kryeprojekt, përveç mësimit të gjuhës gjermane, janë në plan mësimoredhe çështjet e arsimit ose promovimi kompetencës interkulturore dhe integrimi. Për kontakt më të lehtë me gratë, këto kurse të Institutit për Pedagogji Interkulturore ofrohen në kopshtet e fëmijve dhe në shkolla.

**Lesetandem**

Fjala Tandem qëndron për bashkpunimin ndërmjet një famulli (Patenkind) të një shkolle fillore të Linzit dhe një kumbari ose kumbareje. Për një ose dy semestra, ata takohennë shkollëdyhere në javë mbasditeve. Kumbarët e leximitnë takime lexojnë,i motivojnë që ata të lexojnë ne dëshirë, i mësojn se si të lexojnënëmënyrëinteresant dhe me emocione. Kumbarët/et shkollohen për detyrat e tyre speciale dhe përkrahen gjatë punës së tyre vullnetare nga Shoqata për takime interkulturore dhe ndërmjetsim kulturor (ibuk).

**Tregime (Vorlesebuch)**

Me projektin e Shoqatës ibuk, fëmijët nga kopshtime ose pa prejardhje migrante vizitojnë rregullisht Objektet e Azileve të Pleqve në Linzit. Fëmijët ndahen në grupe të vogla. Një mentor ose mentore kujdeset për katër deri pesë fëmijë. Orët e projektit Lesetandem përkrahen edhe nga pedagoget e kopshteve. Mentoret/ët shkollohen dhe përkrahen për detyrat e tyre në objektet e senioreve.

**Rucksack-Modell (Projekti çantëa se shpinës)**
Nën udhëheqjen e Institutit për Pedagogji Interkulturore, e promovon gjuhën amëtare dhe gjermane për fëmijët në moshën katër deri gjasht vjeçare me prejardhje migrante. Në këte projekt inkuadrohen edhe prindërit dhe personeli pedagogjik i kopshtit. “Rücksack“ e ka qëllimin për rritjen e kompeten-cave në gjuhën amëtare dhe gjermane dhe për promovimin e zhvillimit të përgjithshëm të fëmijëve. Gjatë së cilës nënat janë eksperte për mësimin e gjuhës amëtare. Përmes udhëheqjes dhe ndihmës nga materialet e punës, prëgatiten ato për promovimin e gjuhës amëtare.Ato takohen një herë në javë për dy orë (zakonisht në kopshtin e fëmijve) dhe pregatiten për aktivitete të përbashkëta, të cilat i marrin me vehte nënat në çantë („Rucksack“)në shtëpi që të ushtrojnë me fëmijët e tyre. Projekti Rucksack mbyllet me projektin „Griffbereit“. Përmes tij fëmijët në moshën një deri tre vjeçare, përmes lojës aftësohen për të folur

## Informatat për të gjithë ofertat

- **Kinder- und Jugend-Service Linz – (KJSL)**
  Rudolfstraße 18, 4041 Linz
  Tel.: 0732-7070

- **Schule und Sport Linz – (SSL)**
  Pfarrgasse 7, 4041 Linz
  Tel.: 0732-7070
  ssl@mag.linz.at
  www.linz.at/bildung/schulen.asp

- **Volkshochschule Oberösterreich**
  **Institut Interkulturelle Pädagogik – (IIP)**
  Bulgariplatz 12 / 4. Stock, 4020 Linz
  Tel.: 0732-66 11 71
  anita.allerstorfer@vhs-ooe.at
  www.vhs-interkulturell.at

## Përkrahja në mësim jashtë shkollës

Zyra për Integrim e Qytetit të Linz-it financon kurse për ndihmë, nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme. Për informata të mëtejshme, pyetje, kërkesa, këshilla dhe monitorim për keto projekte, kurse të gjuhës gjermane mund të merrni në:

- **Integrationsbüro der Stadt Linz**
  Altes Rathaus, Hauptplatz 1, 4020 Linz
  Tel.: 0732-7070-1150
  integration@linz.at
  www.integration.linz.at

## Përkrahja në mësimin e gjuhës

Nga institute të ndryshme për shkollim ofrohen kurse për gjuhë dhe integrimi dhe kurse për analfabet. Disa nga këto institute pranojnë edhe provime-ÖSD. ÖSD d.m.th. Diplom Austriake për Gjermanisht (Österreichisches Sprachdiplom Deutsch).Ai është një provim për testimin e gjermanishtes si gjuhë e huaj, me 9 provime, në 6 nivele. Diploma e gjuhës ÖSD,u sjell shumë përparsi të diplomuarve si vërtetim standard për njohuri të gjuhës gjermane. Si kualifikim plotësues në tregun e punës (AMS) si në institutet e tjera për orientim profesional, për pranim në universitetet, si vërtetim i pranuar për njohuri të gjuhës gjermane, kur merret nënshtetësia austriake si dhe për leje qëndrimi dhe vizë qëndrimi.

**Wissensturm/Volkshochschule**
Instituti i Arsimit per te Rritur (Volkshochschul) në Ndërtesën e Diturisë (Wissensturm), është në Linz ofruesi më i madh i kurseve të gjuhës gjermane në nivele të ndryshme. Këtu mësohen mbi 20 gjuhë, ndër to „Deutsch als Fremdsprache“ (Gjermanishtja si gjuhë e huaj) dhe „Deutsch-Integrationskurse“ (Kurse të Gjermanishtes për integrim). Kurset organizohenjovetëm në Wissensturm por edhe në pjesët tjera të qytetit. Në vit mund të zgjidhen mbi 100 kurse të gjuhës gjermane. Poashtu edhe mësimi individual është i mundshëm. Të gjithë pjesëmarrësit e kurseve mund ta shfrytëzojnë falas Qendrën për mësim vetiak në Wissensturm.

VHS si qender e licensuar, ofron provimin për Diplomat Austriake për Gjermanisht (ÖSD) si dhe Çertifikatat Europiane të Gjuhës (telc-Zertifikate) dhe provimet për çertifikata në të gjitha shkallët. Sidomos është mjaft e kërkuar p.sh. Çertifikata për gjermanisht, që nevoitet për punë në profesionet për përkujdesje (Pflegeberuf). Ajo ofron njohuri të gjuhës, që mundëson pa veshtirësi të tejkalohen problemet në përditshmeri dhe në profesion.

- **Wissensturm**
  Kärntnerstraße 26, 4020 Linz
  Tel.: 0732-7070
  vhs-bib@mag.linz.at
  Këshillimi personal për kurse të gjuhës
  Tel.: 0732-7070-4323 (Lernzentrum -4390)
  E hënë: ora 17-19
  E enjte: ora 12-14

- **Universiteti Linz (Kurse në gjuhën gjermane për studentët)**
  Altenberger Straße 69, 4040 Linz
  Qendra profesionale për gjuhë dhe komunikacion interkulturor, sekretariat
  Tel.: 0732-2468
  www.lang.uni-linz.ac.at
  www.jku.at
  E hënë, E mërkurë: ora 14:00-17:00
  E martë, E enjte: ora 9:00-12:00

- **Kooperacion Shkolla e lartë pedagogjike, Landi i Austrisë së Epërme, Bashkisë të Linzit etj.**
  Kaplanhofstraße 40, 4020 Linz
  Tel.: 0732-7470-0
  www.ph-ooe.at

- **BFI**
  Bulgariplatz 12, 4020 Linz
  Tel.: 0732-6922-6238
  www.bfi-ooe.at

- **Wirtschaftsförderungsinstitut WIFI**
  Wiener Straße 150, 4021 Linz
  Tel.: 05-7000-77
  www.ooe.wifi.at

- **Volkshilfe OÖ – Flüchtlingsbetreuung**
  (Frauenprojekt)
  Schillerstraße 34, 4020 Linz
  Tel.: 0732-60 30 99
  www.fluechtlingsbetreuung.at

- **migrare – Zentrum für MigrantInnen OÖ.**
  Humboldtstraße 49, 4020 Linz
  Tel.: 0732-61 08 61-19
  www.migrare.at

- **Verein MAIZ**
  Hofgasse 11, 4020 Linz
  Tel.: 0732-77 60 70-4
  www.maiz.at

- **Verein Begegnung Arcobaleno**
  Friedhofstraße 6, 4020 Linz
  Tel.: 0732-60 58 97
  www.arcobaleno.info

## Faqe të dobishme në internet për temën Shkollimi/Arsimi/Gjuha

- **BIC–BerufsInformationsComputer (Kompjuteri për informata të Profesionit)**
  Informata për më shumë se 1 500 profesione, profile interesi, tips përzgjedhjen e profesionit si dhe informata të tjera (pjesërisht edhe në më shumë gjuhë)
  www.bic.at

- **Berufsinformation des AMS**
  www.berufslexikon.at (Berufsdatenbank des AMS)
  www.yourchoiceinfo.at (Aus- und Weiterbildungsinformation)
  www.ams.at/qualifikationsbarometer
  (Informatatë Entit për punë – AMS tregun e punës dhe zhvillimin e aftësive )

– **Informata për sistemin e shkollës dhe arsimit në Homepage të AK**
http://ooe.arbeiterkammer.at/beratung/bildung/bildungsundberufswahl/Bildungswege_in_Oesterreich.html

– **Gjithçka për shkollën: Informatat dhe adresat, këshillat psikologjike në shkollë broshurat informuese**
www.schule.at
www.schulpsychologie.at
www.berufsbildendeschulen.at

– **Informatat për kolegjet dhe studimet në to**
www.fhr.ac.at
www.fachhochschulen.at

– **Udhëheqes Online për studime dhe informatat për Univerzitetet**
www.studienwahl.at
www.wegweiser.ac.at

– **Portal informues për arsim, trajnim dhe aftësim të të rriturve**
www.eduvista.com (Program me të dhëna për shkollim të mëtutjeshëm
www.erwachsenenbildung.at
www.ams.at/weiterbildung (Baza e të dhënave për trajnim e AMS-Entit për punësim)

– **Informatat e Bundesministeriumit për shkollat**
www.bmukk.gv.at
www.bmukk.gv.at/schulen/bw/ueberblick/bildungswege.xml
(Publikation „Bildungswege in Österreich“, në më shumë gjuhë)

– **Informacion për mësim profesioni nga Oda Ekonomike e Austrisë**
www.bmwfj.gv.at » Service » Lehrlingsservice

– **Lehrstelleninformation der Wirtschaftskammern Österreichs**
www.wko.at/lehrstellen (vende mësimi në profesion në kooperim me AMS)
http://lehrbetriebsuebersicht.wko.at
(Firmat që pranojnë nxënës, por jo informata për vende të lira mësimi)

– **Bundesministeriumi për Ekonomi, Familje dhe Rini**
Të gjitha rregulloret për trajnimet profesionale
www.bmwfj.gv.at » Service » Lehrlingsservice

– **Qëndrimi jashtë vendit i nxënësve (Lehrlinge)**
www.ifa.or.at

# LINZI SI QYTET SOCIAL



# 5 LINZI SI QYTET SOCIAL

Linzi ofron një kualitet të lartë jetësor. Përveç situatës së mirë, përsa i përket vendeve të punës, në masë të madhe është edhe angazhimi i politikës dhe administratës së qytetit në aspektin social. Kështu një e treta e buxhetit të qytetit është e paraparë për çështje sociale.

Shërbimet gjithpërfshirëse sociale të qytetit të Linzit, ndërkohë janë shembull për krejt Austrinë. Qoftë në përkrahjen e familjeve dhe fëmijve ose mbështetja dhe përkujdesja për të moshuarit dhe njerëzve me të ardhura të pakta, u jepet mundësia që të marrin pjesë aktive në jetën shoqërore. Sidomos për të rinjtë papunë dhe ata që kërkojnë një vend mësimi në profesion, përkujdeset qyteti së bashku me shoqatat sociale për zgjedhjen e shpejt dhe adekuate të problemit.

Ofertat sociale, në parim ofrohen dhe koordinohen nga Departamenti për Çështje Sociale, të Rinjtë dhe Familjen. Ky departament i qytetit ka në disponim 4 zyra këshillimi për çeshtje sociale. Informata jep sherbimi i qytetarëve (Bürgerservice) nën tel. numer: 0732 / 7070 – 0. Nën adresën www.linz.at/soziales mund gjithashtu ti shihniqartë ofertat gjithpërfshirëse për çështjet sociale.

- **Sozialberatungsstelle Kompass Nord**
  Neues Rathaus
  Hauptstraße 1-5, 4041 Linz
  Tel.: 0732-7070
  kompass@mag.linz.at

- **Sozialberatungsstelle Kompass Ost**
  Seniorenzentrum Franckviertel
  Ing.-Stern-Straße 15-17, 4020 Linz
  Tel.: 0732-66 62 72-20, -21, -22, -23 oder -24
  kompass@mag.linz.at

- **Sozialberatungsstelle Kompass Süd**
  Seniorenzentrum Neue Heimat
  Flötzerweg 95-97, 4030 Linz
  Tel.: 0732-37 01 70
  kompass@mag.linz.at

- **Sozialberatungsstelle Stadtteilzentrum Auwiesen**
  Volkshaus Auwiesen
  Wüstenrotplatz 3, 4030 Linz
  Tel.: 0732-30 27 31
  kompass@mag.linz.at

## Përkujdesja për fëmijët

Qytetit i Linzit mundëson nëmënyrë gjithpërfshirëse dhe parasegjithash financiarisht të përballueshme, në përkujdesjen e fëmijve. Në plan të parë qëndron përkrahja e prindërve në planifikimin e familjes, profesionit si dhe përkrahjen e fëmijve që në moshën e re. Kjo fillon që nga çerdhja e cila zgjërohet gjithnji sipas kërkesës. Përsa i përket kopshtit të fëmijve dhepërkujderit pas mësimit të nxënësve (Hort),

sëbashku me ofertat private ekziston një furnizim i plotë. Çdo fëmijë i cili me 1 shtator i ka mbushur 3 vjeç, e ka të garantuar një vend në kopësht (Kindergarten), pothuajse 95% të rasteve në një kopsht sipas dëshirës.

Përkujdesja për fëmijët bëhet përmes Departamentit të Qytetit siç është:

- **Kinder- und Jugend-Services Linz**
  Rudolfstraße 18, 4041 Linz
  Tel.: 0732-7070
  kjs@mag.linz.at

## Çerdhet për fëmijë (Krabbelstube)

Çerdhet për fëmij u ofrojn prindërve një përkujdesje për fëmijt prej moshës 8 javore deri në moshën 3 – vjeçare. Përkujdesja është e njejtë në të gjitha institucionet dhe përbëhet kryesisht nga pjesë të njejta përbërëse siç janë: lëvizja, perceptimi, muzika, gjuha dhe puna me prindërit.
Pagesa në çerdhe është e caktuar sipas tarifave sociale. Mospagimi është i mundshëm nëse të ardhurat janë të pakta.

**Pranimi:** Kushtet për pranim janë vendbanimi i përhershëm i fëmiut dhe njerit prind në Linz, punësimi i prindërve, partnerëve maksim.20 orëve në javë.

Fëmija mundet të lajmërohet në çerdhe përmes telefonit, personalisht, përmes formularit në internet: **www.linz.at** » Leben in Linz » Soziales » Kinder » Kinderbetreuung vorgemerkt werden.
Lajmërimi bëhet në:

- **Kinder- und Jugend-Services Linz**
  Rudolfstraße 18, 4041 Linz
  Tel.: 0732-7070
  kjs@mag.linz.at
  https://egov.linz.at/kjslanmeldung/krabbelstube.asp

## Kopshti për fëmij (Kindergarten)

Kopshtet për fëmij janë institucione për përkujdesjen e fëmijve prej mbarimit të moshës 3 – vjeçare deri në fillimin e shkollimit. Vendosja dhe ushqimi i fëmijve në kopsht, në qytetin e Linzit, është pa pagesë. Mjaft e përshtatshme për familjet është orari fleksibil i kopshteve. Të gjitha kopshtet e fëmijve në qytetin e Linzit janë të hapura nga ora 6:30 deri ne orën 17. 30 e disa prej tyre, madje deri në orën 20. Kopshtet e fëmijve të qytetit të Linzit janë gjatë gjithëvitit të hapura, përveç gjatë festave të krishtlindjeve.

Për fëmijët me gjuhë tjetër amtare dhe që vijnë nga një rreth tjetër kulturorë, ka një përkrahje të shumëllojshme, derisa fëmija të shkojë në shkollë mundet ta përvetësojë gjuhën gjermane. Në Austri është obligim, që fëmijët nga mosha 5 – vjeçare, ta frekuentojnë rregullisht sëpaku gjysëmdite kopshtin.

**Promovimi i gjuhës (program i Ri)**
Nga vjeshta e vitit 2011 të gjithë djemtë dhe vajzat – me ose pa prejardhje migrante – në kopshtet e fëmijve të qytetit, testohen dy herë në vit për njohurit e tyre të gjuhës gjermane. Nëse te ndonjë fëmij vërehen mungesa në njohjen e gjuhës, fillohet menjëher me promovim të gjuhës. Ngritja e kompetencave gjuhësore deri në nivelin parashkollor është qëllimi kryesor. Fëmijës në kopsht,për tre vjet, i ofrohen gjithësej 540 orë mësim të gjuhës gjermane, që i përshtatet moshes së tij. Promovimi i gjërë i gjuhës, është unik në Austri.Që kjo iniciativ ka rezultat, tregon një Studim i Universitetit të Hamburgut në vitin 2012. Aty konstatohet se të gjithë fëmijët që kanë marrë pjesë në programin Promovimi i RI i Gjuhës(Sprachförderung NEU), u është rritur dukshëm njohuria e gjuhës gjermane.

**Pranimi:** Fëmija mund të regjistrohetpërmes telefonit, personalisht ose përmes formularit në internet **www.linz.at** » Leben in Linz » Soziales » Kinder » Kinderbetreuung vorgemerkt werden. Fundi i afatit të pranimit është 31 marsi i vitit në të cilin fëmija duhettë fillojëkopshtin.

Paraqitja bëhet në:

- **Kinder- und Jugend-Services Linz**
  Rudolfstraße 18, 4041 Linz
  Tel.: 0732-7070
  kjs@mag.linz.at
  https://egov.linz.at/kjslanmeldung/kindergarten.asp

## Kujdestaria pas shkollës për nxënësit (Hort)

Kujdestaria pas shkolles u ofrojnë nxënësve të shkollave fillore (Volksschule), pas orarit shkollor, një përkujdesje gjithpërfshirëse,edukim dhe arsimim. Parasegjithash janë paraparë për prindërit që i rrisin femijt të vetmuar, për prindërit që punojnëdhe për ato që deshirojnë që fëmijët e tyre të kenë një edukim dhe arsimim plotësues. Ashtu si në kopsht, fëmijët kanë edhe këtu përkujdesje të plotë. Tarifat edhe këtu janë të shkallëzuara në mënyrë sociale. Mospagesaështë e mundshme nësë të ardhurat mujore janë të ulta.

**Pranimi:** Regjistrimi për vitin shkollor që vijon bëhet deri në fund të muajit mars. Regjistrimi bëhet direkt te drejtuesja e kujdestarisëose online në **https://egov.linz.at/kjslanmeldung/hort.asp.** Gjatë shpërndarjes së vendeve merret parasysh nëse janë prindërit të punësuar, vendbanimi i te cilëve gjendet në afërsi të shkollës. Lajmërimet pas afatit të regjistrimit merren parasysh vetëm nëse ka vende të lira.

## Përkujdesja me orë për fëmijët e vegjël„Schaukelpferd“

Që të mund tu përshtatet nevojave të ndryshuara të familjeve dhe shoqëris, dhe përshtatjes në mes të profesionit dhe familjes, Qyteti i Linzit përkrah me ofert plotësuese familjet me fëmijët nën tre vjeç. Objekti ”Schaukelpferd“në Wienerstraße 260,juofron prindëve një mundësi fleksibël për përkujdesje. Kjo ofert u bëhet prindëve që kanë nevojë për përkujdesjen e fëmijve për disa orë ose disa ditë. Përkujdesja maksimale në javë është e parapar për 20 orë. Kjo vlen vetëm për fëmijt deri në moshën tre vjeçare të cilët – si dhe së paku njeni Prind ta ken vendbanimin kryesor në Linz.Çmimi për një orë përkujdesje është tre Euro. Nëse shfrytëzohet kontigjenti ndërmjet 48 deri 80 orë në muaj, pagesa është e kufizuar maksimalisht me shumën prej 145,27 Euro. Përtej kësaj, përkujdesja kushton përsëri tre Euro në orë.Për fëmijt mund të porositet aty edhe drekë.

➲ **Flexible Kinderbetreuung Schaukelpferd**
Wiener Straße 260, 4030 Linz
Tel.: 0732-34 92 71-626
Mobil: 0676-51 23 100
schaukelpferd@spattstrasse.at
www.spattstrasse.at

### Dadot (Tagesmütter)

Dadot janë femra, të cilat fëmijt nga mosha 8 javore deri në 16 vjet, i marrin në përkujdesje te shtepia e tyre në atmosferë të ngrohtë familjare. Të gjitha dadot kanë arsimim përkatës për këtë veprimtari. Në Linz është shoqata Aktion Tagesmütter përgjegjëse për ndërmjetësim:

➲ **AKTION TAGESMÜTTER OÖ**
Raimundstraße 10, 4020 Linz
Tel.: 0732-6922-7780
www.tagesmuetter.kinderplattform.info

### Përkujdesja pasdite në shkolla

Për nxënësit e shkollimit të obligueshëm në shkollë fillore dhe në mësimin politeknik ekziston përkujdesja pasdite me ushqim, në shkollë. Këtu bëhen detyrat e shtëpisë, mësim plotësues si dhe aktivitete të lira. Pagesa në strehim është në mënyrë sociale e shkallëzuar.

**Pranimi:** Lajmërimi për një vend në përkujdesje mbasdite bëhet direkt në shkollë.

## Familja

### Edukimi dhe mirëqenia e të rinjve në qytetin e Linzit

Detyra e Departamentit për Mirëqenien e të Rinjve është këshillimi dhe përkrahja e prindërve në problemet e edukimit si dhe mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve nga reziqet. Personeli i diplomuar ne çeshtjet sociale ofrojnë.

- Informata dhe përkrahje në problemet e edukimit dhe krizat mbrenda familjes
- Këshillat për nënat ose baballarët e ndarë
- Ndihmë në rastet e dhunës në familje

Detyrat kryesore të punëtorëve soicalë të departamentit për ndihmë në edukim janë këshillat e edukatës, problemet e pubertetit, problemet e sjelljes së fëmijve, vizita dhe përkujdesja e fëmijve gjatë divorcit të prindërve si dhe gjatë delikteve dhe fajeve penale të fëmijve dhe të rinjve. Zgjedhja e problemeve në radhë të parë ka për qellimtë përkrahë prindët në edukim dhe bashkarisht të gjenden zgjidhje. Në rastet e lënies pasdore ose rrezikimit të fëmijve dhe të rinjve, departamenti ndërrmerr masa në mënyrë të pavarur.

Informatat e përgjithshme dhe sqarimet fillestare bëhen në qendrën për këshillim të parë. Qendrat e jashtme për këshilla ka në pjesët e qytetitEbelsberg, Spallerhof, Franckviertel, Auwiesen dhe Neue Heimat.

➲ **Amt für Soziales, Jugend und Familie**
Erstabklärung – Neues Rathaus
Hauptstraße 1-5, 4041 Linz
Tel.: 0732-7070-2830
asjf@mag.linz.at
E hënë-E premte: ora 8:00-12:00

Përkrahje në kërkesat e mirëmbajtjes (alimentet) mund të gjeni në sektorin e Departamentit Ligjor nën numrin: 0732/7070

## Instituti për këshilla të familjeve dhe të rinjve në qytetin e Linzit

Përmes institutit për këshilla familjeve dhe të rinjve, qyteti i Linzit ofron një vend kontakti gjatë problemeve në familje, partneritet, me fëmijt si dhe për nevojat e të rinjeve. Personeli i shkolluar në aspektin psikologjik, psikoterapist dhe pedagogjik i përkrahin klientët gratis dhe anonim. Duke u bazuar në pyetsorin përkatës pra në kombinimin e arsyeshëm ofrohen këto shërbime:

Këshilla në edukim, diagnostika psikologjike të fëmijve, psikoterapia e fëmijve, këshillimi i familjes me terapi, përkrahja në mësim, trajnimi i perceptimit, trajnimi autogjen, grupet e fëmijve gjatë problemeve të divorcit.
Mediacioni, këshillimi gjatë divorcit, këshillimi i shtatëzanisë, këshillime tjera sociale për çeshtje familjare, këshillim personal dhe terapi, këshillim të bashkëshortëve dhe terapi, këshillim ligjor në çështjet e të drejtës famljare.

Puna e qendrës për këshilla i nënshtrohet fshehtësisë së obligueshme. Këshillimet bëhen të hënën dhe të mërkuren nga ora 9:00 deri 10:00 si dhe përmes telefonit.

➲ **Institut für Jugend- und Familienberatung der Stadt Linz**
Rudolfstraße 18, 4040 Linz
Tel.: 0732-7070-2700
inst.fjb@mag.linz.at
www.linz.at/soziales/fjb.asp

## Këshilla për nënat

Në qendrat që udhëhiqen nga pediatër ose mjek/e të përgjithshëm, foshnjave u bëhet kontrolli gratis dhe u jepen këshilla prindërve për zhvillimin, kujdesin dhe ushqimine foshnjave dhe fëmijëve të tyre të vegjël.

- **Eltern-, Mutterberatungsstelle Auwiesen**
  Allendeplatz 4, 4030 Linz
  Tel.: 0732-31 17 42
  Orari: E hënë ora 14.30-17:00, E enjte ora 9:00-11.30

- **Eltern-, Mutterberatungsstelle Biesenfeld**
  Dornacher Straße 7, 4040 Linz
  Tel.: 0732-24 35 61
  Orari: E martë ora 14:00-16.30, E premte ora 9:00-11.30

- **Eltern-, Mutterberatungsstelle Eltern-Kind-Zentrum der Stadt Linz Ebelsberg-Ennsfeld**
  Hofmannsthalweg 8, 4030 Linz
  Tel.: 0732-30 10 56-18
  Orari: E hënë ora 9:00-11.30 dhe E mërkurë ora 14.30-17:00

- **Eltern-, Mutterberatungsstelle Oed**
  Europastraße 12, 4020 Linz
  Tel.: 0732-37 13 75
  Orari: E premte ora 9:00-11.30

- **Eltern-, Mutterberatungsstelle IGLU Franckstraße (Dorfhalle)**
  Franckstraße 68, 4020 Linz
  Tel.: 0732-65 45 41-14
  Orari: E mërkurë ora 9:00 deri 11.30

- **Eltern-, Mutterberatungsstelle Spallerhof**
  Glimpfingerstr. 10-12, 4020 Linz (Seniorenzentrum,Pallati4,Hyrja nga oborri)
  Tel.: 0732-3408-12607
  Orari: E martë ora 14.30-17:00

- **Eltern-, Mutterberatungsstelle Karl-Steiger-Straße**
  Karl-Steiger-Straße 2, 4030 Linz
  Tel.: 0732-30 20 71
  Orari: E mërkurë ora 14:00-16.30

- **Eltern-, Mutterberatungsstelle Hessenplatz**
  Hessenplatz 12, 4020 Linz
  Tel.: 0732-78 25 48
  Orari: E enjte ora 14.30-17:00

- **Eltern-, Mutterberatungsstelle Leonfeldner Straße**
  Leonfeldner Straße 80, 4040 Linz
  Tel.: 0732-73 12 69
  Orari: E mërkurë ora 14.30-17:00

- **Eltern-, Mutterberatungsstelle Neues Rathaus**
  Hauptstraße 1-5, 4041 Linz
  Tel.: 0732-7070-2660
  Orari: E enjte ora 14.30-17:00

- **Eltern-, Mutterberatungsstelle Pichling**
  Heliosallee 84, 4030 Linz
  Tel.: 0732-32 00 71-31
  Orari: E martë ora 14:00-16.30, E enjte ora 9:00-11.30

- **Eltern-, Mutterberatungsstelle Neue Heimat**
  Rohrmayrstraße 1, 4030 Linz
  Tel.: 0732-38 20 08
  Orari: E martë ora 14.30 deri 17:00

- **Eltern-, Mutterberatungsstelle Tegetthoffstraße**
  Tegetthoffstraße 23
  Tel.: 0732-65 35 68
  Orari: E enjte ora 14:30-17:00

- **Eltern-, Mutterberatungsstelle Zaunmüllerstraße**
  Zaunmüllerstraße 4, 4020 Linz
  Tel.: 0664-47 45 002
  Orari: E hënë ora 14.30-17.00

## Qendrat për prindër dhe fëmijë

Në Linz për familjet ekzistojnë 11 qendra në dispozicion të prindërvë dhe fëmijët, si institucione për këshilla, vendtakime, qendra për komunikacion dhe organizime. Në punën e hapur të qendrës ka gjithnjë mundësi që të njihemi me fëmijë dhe prindër të tjerë, të bëhet këmbim i përvojave dhe të merren informacione.

Qyteti i Linzit ka vet 2 institucione të ketilla. Qendra për prindër dhe fëmij Ebelsberg – Ennsfeld dhe qendra për familje Pichling. Në të dy qendrat ka një ofertë të madhe plotësuese në ligjerata, kurse, workshop për temën familja dhe fëmijët. Atje ka njëprogram vjetor.

- **Eltern-Kind-Zentrum Ebelsberg-Ennsfeld**
  Hofmannsthalweg 8, 4030 Linz
  Tel.: 0732-30 10 56
  ekiz@mag.linz.at

- **Familienzentrum Pichling**
  Heliosallee 84, 4030 Linz
  Tel.: 0732-32 00 71
  familienzentrum.pichling@mag.linz.at

- **Eltern-Kind-Zentrum Linz**
  Figulystraße 30, 4020 Linz
  Tel.: 0732-66 96 11
  office@eltern-kind-zentrum.at
  www.eltern-kind-zentrum.at

- **Eltern-Kind-Zentrum rund.um**
  Ing.-Stern-Straße 35, 4020 Linz
  Tel.: 0676-88 56 63 12
  ekiz.rundum@kinderfreunde.cc
  www.kinderfreunde.cc

- **Eltern-Kind-Zentrum minikäfer**
  Zibermayrstraße 40, 4020 Linz
  ekiz.minikaefer@kinderfreunde.cc
  www.kinderfreunde.cc

- **Eltern-Kind-Zentrum minikids**
  Zaunmüllerstraße 4, 4020 Linz
  Tel.: 0676-88 56 63 16
  ekiz.minikids@kinderfreunde.cc
  www.kinderfreunde.cc

- **Familienbundzentrum Linz-Bambini**
  Kainzweg 10, 4020 Linz
  Tel.: 0732-77 67 68
  fbz.linz@ooe.familienbund.at
  www.ooe.familienbund.at/de/familienbundzentren/linz-bambini.html

- **Familienbundzentrum Linz-Kleinmünchen**
  Schickmayrstraße 16, 4030 Linz
  Tel.: 0732-30 31 61
  fbz.kleinmuenchen@ooe.familienbund.at
  www.ooe.familienbund.at/de/familienbundzentren/linz-kleinmuenchen.html

- **Familienbundzentrum Linz-Urfahr**
  Dornacherstraße 17, 4040 Linz
  Tel.: 0732-24 72 15
  fbz.urfahr@ooe.familienbund.at
  www.ooe.familienbund.at/de/familienbundzentren/linz-urfahr.html

- **Eltern-Kind-Zentrum Rappelkiste**
  Hagenstraße 10, 4040 Linz
  Tel.: 0676-88 56 63 11
  ekiz.rappelkiste@kinderfreunde.cc
  www.kinderfreunde.cc

- **Eltern-Kind-Zentrum Zwergerltreff**
  Johann-Wilhelm-Klein-Straße 70, 4040 Linz
  Tel.: 0676-88 56 63 10
  ekiz.zwergerltreff@kinderfreunde.cc
  www.kinderfreunde.cc

## Kompensimi për përkujdesjen e fëmijve (Kinderbetreuungsgeld)

Në Austri, prindët biologjik, adoptiv dhe prindët strehues të fëmijve, që kanë lindur pas 31.12.2001, pranojnë kompensim për përkujdesjen e fëmijëve. Për të lindurit prej 1.10.2009 vlen varianti i ri paushale si dhe sistemii kompensimit(Kinderbetreuungsgeld) qe prej 1.01.2011 është i pamvarur nga të ardhurat mujore. Prej vitit 2010, prindërit munden të zgjedhin në mes të dy sistemeve.

- **Pagesa fikse**
  Pagesa në formë fikse e kompensimit. Prindëve u njihet përkujdesja dhe kompensimi u bëhet pjesërisht. Pagesën fikse e pranojnë prindërit, pavarsisht nga puna që kanë kryer para lindjes së fëmijës.

- **Kompensimi për fëmijët  sipas të ardhurave mujore**
  Kompensimi për fëmijëtsipas të ardhurave mujore, është një kompensim i pagës për prindët, të cilët kanëtë ardhuratë larta mujore dhe vetëm për një kohë të shkurtër, tërhiqen nga jeta profesionale.

**Parakushtet për pagesën e shtesave për fëmijët janë:**

- E drejta në shtesat familjare
- Qendra e banimit në Austri
- Lejeqëndrimi i rregulluar në Austri
- Vendbanimi i përbashkët me fëmijën
- Kontrolli i rregullt mjeksor i fëmijës sipas Mutter-Kind-Pass
  (5 kontrolle gjatë shtatzanisë dhe 5 kontrolle të fëmijës)
- Shuma e tëardhurave,në bazë të ligjit mbi pagat, nuk duhet ta tejkalojë shumën e caktuar mbi të ardhurat plotësuese. Nëse kjo shumëtejkalohet, brenda vitit kalendarik, shuma e marre më tepër duhet të kthehet.

Kërkesa për kompensimin për përkujdesjen e fëmijëve (Kinderbetreuungsgeld) bëhet përmes një formulari në Sigurimet Shoqërore(Gebietskrankenkasse) përkatëse. Kjo vlen për të siguruarit ose për familjarët e të punësuarve. Për ata që kanëbiznese private(Selbstständige) dhe përfamiljarët e tyre, kërkesa bëhet te Sigurimet për Ekonomi dhe Industri (Sozialversicherungsanstalt der gewerblichen Wirtschaft), Bujqit e bëjnë kërkesën te Sigurimi Shoqërori Bujqve(Sozialversicherungsanstalt der Bauern). Personat që nuk kanë pas sigurim ose nuk kanë pasur të drejtë, munden ta bëjnë kërkesën te Sigurimet Shoqërore (Gebietskrankenkasse). Ata që pranojnë pagesë javore, u dërgohet kërkesa automatikisht.

➲ **Oberösterreichische Gebietskrankenkasse (OÖGKK)**
Gruberstraße 77, 4020 Linz
Tel.: 05-78 07-50 37 30
karenzbetreuung@ooegkk.at
www.ooegkk.at

➲ **Sozialversicherungsanstalt der gewerblichen Wirtschaft**
Mozartstraße 41, 4010 Linz
Tel.: 0732-7634
http://esv-sva.sozvers.at

# Fëmijët dhe të rinjt

## Zyra e Linzit për fëmijë dhe të rinj

Për kërkesat e fëmijve dhe të rinjve në qytet, përkujdeset zyra e qytetit për fëmij dhe të rinj. Kjo qendër e shërbimit të qytetarëve më të rinj të Linzit, e përkrah kulturën për fëmijë dhe të rinj, planifikon së bashku me zbatuesit, ndërtimin e parkut me lojra dhe fushat e sportit, organizon shfaqje të ndryshme si dhe organizime të shumta. Për problemet e të rinjve siç janë, borxhet, seksualiteti ose pavarsëria, zyra e të rinjve i dërgon të rinjt në qendrat përkatëse për ndihmë.

➲ **Kinder- und Jugend-Services Linz / Kinder- und Jugendbüro**
Rudolfstraße 18, 4041 Linz
Tel.: 0732-7070-2831 dhe -2863
jugend@mag.linz.at
www.linz.at/jugend

## Qendrat për të rinj

Për shfrytëzimin e kohës së lirë të të rinjve, shoqata për të rinj dhe kohë të lirë e qytetit ka në disponim 13 qendra për të rinj. Shtat këshillimore në qendrat për të rinj, merren me problemet private të të rinjve. Për aktivitetet në rrugë janë në disponim edhe katër institucione Streetwork.
Qendrat për të rinj ofrojnë aktiviteteve të liradhe kulturore, përmes bisedave me këshilltarët e kualafikuar social, u ofrohet ndihmë për zgjedhjen e problemeve dhe u jepen informata për institucione tëtjera. Hyrja në qendrat për të rinj është gratis.

➲ **VJF – Verein Jugend und Freizeit**
Lederergasse 7, 4020 Linz
Tel.: 0732-77 30 31
office@vjf.at
www.vjf.at

## Jugendschutz (mborjtja e të rinjve)

Informata për temën e mbrojtjes së të rinjve dhe ligjit për mbrojtjen e të rinjve. ofron shërbimi për ndihmë në edukim i entit për çështje sociale, të rinj dhe familje si dhe shërbimi për të rinj i Landit të Austrisë së Epërme.

➲ **Amt für Soziales, Jugend und Familie**
Hauptstraße 1-5, 4041 Linz
Tel.: 0732-7070-2830
asjf@mag.linz.at
E hënë – E premte: ora 8-12.00

➲ **Jugendservice des Landes Oberösterreich**
Bahnhofplatz 1, 4020 Linz
Tel.: 0732-66 55 44
www.jugendservice.at
E hënë- E premte: ora 13-17.00

## First-Love-Ambulanz (Ambulanca e dashurisë së parë)

First-Love-Ambulanz është këshillimore për vajzat e reja dhe partnerët e tyre, ku mund të shkohet vetëm, me një shoqe, me prindërit, me partnerin ose dike tjetër që dëshiron ta shoqërojë. Një psikologe, një gjinekologe dhe një infermierejapin informata dhe ndihmë për tema të ndryshme.
Pyetjet më të shpeshta janë në lidhje me „herën e parë“, lidhjen e parë intime, problemet në lidhje intime, mbrojtja nga shtatzania, kontrolli i parë te gjinekologu/ja, menstracionet si dhe sëmundjet seksuale.
Ambulanca është, çdo të **mërkurë nga ora 15:00– 17:00** e hapur. Nuk është e nevojshme, as karta e sigurimit shendetësor (e – Card) as paralajmërim. Keshillimi është pa pagesë dhe i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e fshehtësisë.

➲ **First Love Ambulanz**
AKh Haupteingang, Bau B, 1. Stock, departamenti gjinekologji
Krankenhausstraße 9, 4021 Linz
Tel.: 0732-7806-1270
firstlove@akh.linz.at
http://firstlove.linz.at

## Programi i pushimeve verore AKTIV-TAGE

Për çdo vit,ky program, u ofron fëmijve dhe të rinjve, nga mosha 6 deri në 15 vjeçare, një program gjithëpërfshirës për kohën e lirë gjatë pushimeve verore. Kjo është parasëgjithash një lehtësim organizativ dhe financiar, që ofron qyteti, për prindët që gjat verës nuk mund të marrin pushim ose nuk kanë mundësi që të udhëtojnë diku. Me tepër se 100 Workschops të ndryshëm, kurse, pushime javore, ekskursione, lojra, argëtim etj., janë mundësi e mirë kundër mërzisë dhe qendrimit të gjatë para TV-së ose kompjuterit. Për orientim, për ofertën dhe planifikimin e pushimit veror, para pushimeve verore del fletprogrami i ditëve aktive (Aktiv-Tage). Gjendet në institucionet e ndryshme publike të qytetit të Linzit, siç janë bibliotekat e qytetit, shkollat, qendrat për shërbimet e qytetarëve, si dhe në internet në adresën www.linz.at/aktivtage.asp. Planifikimi i ditëve aktive bëhet nga zyra e qytetit për femij dhe të rinj.

# Linzi për të moshuarit (Seniorët)

## Qendra tëKonsultimit social Kompass

Për pyetjet dhe përkrahjen e më të vjetërve në Linz,janë Qendrat e Konsultimit(3 Kompass), zyra-tkryesore. Këtu merret informacion për të gjitha ofertat ekzistuese për ndihmë regjionale, si p.sh. banimi me përkujdesje, klubet aktiv, përkujdesja, pranimi në shtëpin e pleqve, si dhe organizimi dhe sqarimi për shpenzimet e përkujdesjes në shtëpi. Këshillat janë pa pagesë, konfidenciale dhe sipas dëshirës anonime. Qendrat e Konsultimit  mund të vizitohen pa paralajmerim  **të martave prej orës 9 – 12.30 dhe të ejteve prej orës 13.30 deri 16,** jasht këtij orari vetëm me orar. Adresat e këtyre 4 këshillimoreve sociale gjenden në fillim të kapitullit "LINZI SI QYTET SOCIAL".
Punëtorët/et eQendrave të Konsultimit (3 Kompass) ofrojnë gjithashtu këshilla p.sh.kur është e rrezikuar dalja nga banesa si dhe në rastet e problemeve sociale dhe financiare.

## Udhërëfyesi për të moshuarit (Seniorët)

Broshura „Linz für SeniorInnen" i permban të gjitha ofertat dhe shërbimet ekzistuese për të moshuarit në qytet. Informatat për qendrat e të moshuar, shtesat për përkujdesjen e të moshuarve, banimi me përkujdesje, përkrahja e atyre që kanë në familje persona në përkujdesje etj. paraqiten qartë dhe me sqarime. Broshurën mund ta gjeni në qendrën për shërbimin e qytetarëve (Bürgersevice Center) në Neue Rathaus si dhe në qendrat tjera për shërbim si dhe bibliotekat e qytetit.
Online në faqen **www.linz.at** » Bürgerservice » Service A - Z » SeniorInnen » Seniorenratgeber

## Klubet- Aktiv

Klubet –Aktiv, janë vendtakime për të moshuarit dhe të moshuarat në zonat të ndryshme të qytetit, ku kalohen orë të këndëshme në rrethin e miqve dhe të njohurve. Në bashkëpunim me shkollat për të rritur ofrohet një program kreativ i shumëllojshëm për shfrytzimin e kohës së lirë, siç janë shoqërimi, lëvizja, shëndeti, arsimi dhe arti. Ndër të tjera janë edhe shfaqjet, skulptura dhe vizatimi, leximi, ekskurzionet, joga, vallëzimi popullor dhe shumë aktivitete tjera. Për ti vizituar klubet nuk duhet të jemi të anëtarsuar, ato jane gratis. Në Linz ka gjithsejt 17 Klube.
Për të moshuarit që kanë kufizime në levizje, ekziston shërbimi me pagesë për transportin e invalidëve i Samaritenbund në Linz në nr. tel. 7070-2127. Adresat e klubeve gjenden në broshurat e Linzit për senior (te moshuar). Informata ofron edhe shërbimi i qytetarëve (Bürgerservice) i qytetit të Linzit nën nr. e tel. 0732 / 7070.

## Shërbimet mobile

Shërbimet mobile u ofrojn të moshuarve që kanë nevojë për përkujdesje, që deri në moshë shum të vjetër të mbeten në banesë. Kështu përkujdesja e të moshuarve, e cila bëhet nga personeli profesional për përkujdesje dhe nga ndihmëset, u ndihmojnë në punët shtepiake, mbajtjen e pastërtisë së trupit,i shoqërojnë ata te mjeku dhe te institucionet, si dhe u japin këshilla dhe u ndihmojnë familjarve.
Përkujdesja mjeksore shtëpiake, u mundëson përkujdesje mjeksore, dhe përkujdesje të moshuarve në shtëpi. Personeli i diplomuar për përkujdesje në këte rast i kryen shërbimet mjeksore që i ka caktu

mjeku. “Essen auf Rädern” është një furnizim mobil me ushqim i cili çdo ditë e sjell ushqimin e ngroht deri në banesë.Si përkujdesja për të moshuar ashtu edhe përkujdesja mjeksore, kanë çmime sociale, pamvarësisht nga ardhurat. Shërbimet mobile bëhen nga organizatat private dhe koordinohen nga qyteti i Linzit. Të gjitha ofertat, pa përjashtim, ndërmjetësohen nga Qendrat e Konsultimit (Kompass).

## Qendrat ditore

Të moshuarit, të cilët banojn në shtëpi dhe pjesërisht kanë nevojë për mbështetje në jetën e përditëshme në përkujdesje ose këshillim, mund ti shfrytëzojnë qendrat ditore të Linzit. Qyteti i Linzit ofron tre shërbime të këtilla që janë të vendosura në qendrat për të moshuar në Dornach/Auhof, Franckviertel dhe në Kleinmünchen. Oferta e tyre përmban përkujdesje, këshillim psikosocial, këshillim të përgjithshëm si dhe aktivitete tjera në kohën e lirë. Duke fillu nga grupet për qeramik dhe vizatim, grupet e bisedave dhe ekskursionet e përbashkëta. Njerëzve të moshuar që janë të vetmuar u ofrojn mundësi për kontakte me të moshuar të tjerë. Qendra ditore, Regenbogen e Volksihilfe-s është krijuar special për njerëzit me dobësi psiqike.

- **SZL Seniorenzentren Linz GmbH**
  Glimpfingerstraße 12, 4020 Linz
  Tel.: 0732-3408
  dion@szl.linz.at
  www.seniorenzentren-linz.at

- **Tageszentrum Regenbogen**
  Maderspergerstraße 11, 4020 Linz
  Tel.: 0732-3405-415

## Banimi me përkujdesje

Banimi me përkujdesje për të moshuarit është një alternativ, në rastet kur pengesat në banesë dhe nevoja për përkujdesje sociale është mjaft e ulët. Banesat me reth 50 metra katror ,,të rregulluara enkas për të moshuarit janë të vendosura kryesisht në vende tëfavorshme komunikacioni. Kështu mundësohet qe në rastet e thirrjeve emergjente, ndihmatë arrijë sa më shpejt atje. Personat nga mosha 60 vjeçare me kushtejo të përshtatshëm për banim ose nga mosha 70 vjeçare për përkujdesje tëpakët ose mesatare, mund të përfitojne këto banesa. Gjithashtu mjafton  një propozim i shërbimeve mobile, në bazë të gjendjes së posaçme sociale. Informata për banimin me përkujdesje japin Qendrat e Konsultimit (Kompass). Lajmërimi bëhet në shoqatat e caktuara për banim, sipërmarrësit e ndërtimt dhe organizatat. Ato informojnë gjithashtu edhe për çmimet.

## Shtëpitë  e pleqve me përkujdesje

Në Linz, për personat e moshuar, që kanë nevojë të përhershme për përkujdesje, janë në disponim 16 qendra për të moshuar. 9 prej tyre i udhëheq Seniorenzentren Linz GmbH, 7 të tjerat udhëhiqen nga organizatat private. Gjithësejt më shumë se 2.100 vende kualitative për përkujdesje, ofrohen momentalisht. Për të gjithë të moshuarit është e garantuar mundësia e vendosjes. Nëse nuk mjaftojn të ardhurat personale, diferencën e paguan qyteti i Linzit. Banuesve në këto qendra, për nevojat e tyre personale u mbeten edhe:

– 20 % nga pensioni
– I gjithe pension i 13-të dhe 14-të
– Të hollat për përkujdesje në shumën prej 44,30 Euro (Gjendja e 2013) në muaj

Shumica e qendrave për të moshuar, disponojnë vende për përkujdesje në afat të shkurtër. Kështu u ofrohet familjarëve ndihmë në rastet e sëmundjes ose pushimit.
Informata për qendrat për të moshuar ka në broshurat e ndryshme të cilat gjenden në qendrat e shërbimit të qytetarëve të linzit ose në Seniorenzentren Linz GmbH.
Pranimi: Pranimi në qendrat për të moshuar dhe shtëpitë e pleqve bëhet vetëm përmes këshillimoreve sociale Kompass (Adresa e tyre gjendet në fillim të kapitullit, LINZI SI QYTET SOCIAL)
.

## Përkrahje dhe mbështetje

### Sigurimi minimal sipas nevojës

Në kuadër të sigurimit minimal sipas nevojës, u jepet ndihmë financiare njerzve, të cilët janë në gjendje të rëndë sociale dhe nuk janë në gjendje që vetë (me të ardhurat dhe pasurin e tyre) ti mbulojnë shpenzimet për jetesë.
Qëllimi i sigurimit minimal (Mindestsicherung), është pengimi i varfërisë dhe përjashtimit social si dhe ndihmë për fillimin ose rikthimin në punë.

Sigurimi minimal (Mindestsicherung), përmban pagesa mujore për sigurimin e shpenzimeve për jetesë dhe banim, si dhe sigurimit ligjor shëndetësor d.m.th. i jepet karta e sigurimit shëndetësor e-card (nëse nuk e ka). Në vend të hollave mundet gjithashtu ti ofrohet kualifikim për profesionin ose një punë (ndihmë për punësim) e cila i paguhet.
Me një pagesë fikse (Standardminimal) duhet të mbulohen sidomos nevojat fikse për banim, ushqim, veshje, pastërti trupore, familje, ngrohje dhe rrymë si dhe pjesëmarrje në jetën kulturore dhe sociale. Nëse shpenzimet e banesës janë më të ulta ose i paguan dikush tjetër, atëherë standarti minimal ijetesës (Mindeststandard) reduktohet për këtë shumë.

Informacione të hollësishme mund të merni online në **www.ooe.gv.at** » Themen » Gesellschaft und Soziales » Bedarfsorientierte Mindestsicherung

### Aktivpass

Me qëllim që qytetarët e Linzit me të ardhura të ulta, të mund të marrin pjesë në jetën shoqërore në qytet, në vitin 1986 vendoset aktivpass-i. Me këte kartë që sjell përparësi në qytet, ka oferta në shumë institucione të qytetit si në muzeume, në shfaqje, në shkollën për të rritur (Volkshochschule), në Ars Electronica Center, në pishinat e LINZ AG dhe shumë më tepër. Sidomos në shfrytzimin e mjeteve të qarkullimit publik, ofron zbritje të madhe. Kështu bileta mujore me zbritje, e qarkullimit me LINZ LINIEN, kushton vetëm 10 Euro. Te biletat për një udhtim me pagesë për MINI, ju takon bileta MIDI, e në vend të saj jutakon bileta MAXI. Të gjitha përparësitë që i ofron aktivpass, mund ti gjeni në internet në adresën: **www.linz.at/aktivpass.**

Aktivpass ju takon të gjith personave të rritur me vendbanim të përhershëm në Linz, qe fitojn më pak se 1.139 Euro netto në muaj. Kjo shumë vlen për vitin 2013, dhe rritet sipas indeksit.
Aktivpass mund të merret në Qendrën për sherbimin e qytetarëve në Bashkin e Re (Neue Rathaus) ose në qendrat e shërbimit  në bibliotekat e qytetit.

**Gjatë parashtrimit të kërkesës nevoiten edhe këto dokumente:**

- Vërtetimi aktual mbi të hyrat
- Dokument me fotografi
- Fotografi

➲ **Bürgerservice Center**
Hauptstraße 1-5, Neues Rathaus, 4041 Linz
Tel.: 0732-7070
info@mag.linz.at
www.linz.at/aktivpass
E hënë - E premte: ora 7:00-18.00

## Pagesa për përkujdesje (Pflegegeld)

Personat, të cilët janë me vendbanim në Austri, nën kushte të caktuara kanë të drejtë të bëjnë kërkesë për pagesë përkujdesjeje. Me këte pagesë, bëhet pjesërisht, financimi i përkujdesjes së personave që kanë nevoja të posaçme. Parakushtet për pagesë janë nevoja e përhershme për përkujdesje, për shkak të aftësive të kufizuara fizike, psiqike ose shqisore. Poashtu, nevoja për përkujdesje të jetë, së paku 50 orë në muaj edhe ate të parashifet që kohëzgjatja të jetë më shumë se 6 muaj. Shuma  e pagesës për përkujdesje është e ndarë në 7 shkallë, sipas kohës së nevojshme për përkujdesje, e llogaritur në orë të nevojshme në muaj. Pagesa behët 12 herë në muaj dhe është e liruar nga tatimi mbi të hyrat. Kërkesa parashtrohet kryesisht te sigurimi përkatës i pensionit. Qendrat e Konsultimit  sociale Kompass, ndihmojn në plotsimin dhe dorëzimin e kërkesës.

## Dhurata për lindje të fëmijve

Qyteti i Linzit i përkrah prindërit e rinj, pas lindjes së fëmijës, me një dhurat. Kjo është sipas zgjedhjes, një ulëse për femij në automjet ose  kupon për blerje në vlerë prej 100 Euro. Deri në moshën 3 vjeçare të fëmijës dhurata mund të merret në qendrën për shërbimin e qytetarve në Bashkinë e re (Neue Rathaus), ose në qendrat e shërbimit në bibliotekat e qytetit.

**Parakushtet janë:**

- Që nëna ose babai të jetë me vendbanim në Linz, më tepër se 6 muaj, para lindjes së femijës, dhe të banojnë edhe më tej në Linz me fëmijën.
- Që kontrollet në Mutter-Kind-Pass (Pasaportën Nënë-Fëmijë) të bëhen me rregullë.
- Të ardhurat brutto  në familje (nga 2013) të jenëmaksim. 4.110 Euro (për çdo fëmij më tej, plus 363,36 Euro).

**Për këtë nevojiten këto dokumente:**

- Vërtetimi mbi të ardhurat mujore
- ërtetimi i pagesës së përkujdesjes për fëmijë
- Pasaporta Nënë – Fëmij (Mutter-Kind-Pass)
- Çertifikata e lindjes së fëmijës

➲ **Bürgerservice Center**
Hauptstraße 1-5, Neues Rathaus, 4041 Linz
Tel.: 0732-7070
info@mag.linz.at
E hënë - E premte: ora 7:00-18.00

## Shoqata për prevencion social dhe punë të përbashkët komunale

Shoqata sociale VSG – Shoqata për prevencion social dhe punë të perbashkët komunale në Linz, ka për qellim që me projekte inovative sociale, të mbrojë personat në gjendje të pafavorshme sociale nga kufizmi social përmes projekteve rqë u përshtaten nevojave të tyre individuale. Qellimi kryesor i VSG, është integrimi i këtyre personave në jetën shoqrore. Për këtë, shoqata ndërmerr masa të shumta preventive, të cilat ndihmojnë në udhëheqjen e pavarur, me përgjegjësi individuale dhe në bazë të vlerave solidare të jetës. Shoqata i shoqëron të rinjët në ngritjen profesionale, ndëmjetson në arsimim dhe arsimim të mëtejshëm dhe ndihmon në vendosjen e kontakteve sociale. Kjo shoqatë ofron, momentalisht 8 projekte të ndryshme:

- kick–Projekt për të rinj
- factory–Shkolla për prodhim
- move–Ndihmë për fëmijë dhe të rinj
- woman–Këshillimore për femra
- learn–Qendër për mësim
- time–Berza për këmbimin e kohës
- view–Puna në pjesët e qytetit
- ulf–Qendra vendore, vullnetare

➲ **VSG – Verein für Sozialprävention und Gemeinwesenarbeit**
Hahnengasse 5/1, 4020 Linz
Tel.: 0732-77 73 75
www.vsg.or.at

# Lindja, martesa, vdekja

Për dokumentimin e kurorëzimit, lindjeve dhe vdekjeve në Linz, është në disponim Zyra e Banorëve dhe e gjendjes civile:

➲ **Einwohner- und Standesamt**
Hauptstraße 1-5, Neues Rathaus, 4041 Linz
Tel.: 0732-7070
standesamt@mag.linz.at
Orari: E hënë dhe E enjte: ora 7-12.30 dhe ora 13.30-18
E martë dhe E mërkurë :ora 7-13.30
E premte: ora 7-14

## Kurorëzimi

Për kurorëzim,ështëi nevojshem lajmërimi personal në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit. Në Linz kjo është Zyra e Banorëve dhe e gjendjes civile në Bashkinë e Re (Neues Rathaus). Aty merren të dhënat, bisedohen çështjet kryesore dhe çiftet këshillohen. Cilët dokumente duhet të merren me vehte mund të lexoni në faqen e internetit **www.linz.at** » Bürgerservice » Service A-Z » Eheschließung. Për pyetje speciale, Zyra e Gjendjes Civile, është në disponim edhe përmes telefonit.

Lajmërimi mund të bëhet, më së hershmi, 6 muaj paramartesës. Rezervimi i orarit mund të bëhet personalisht, me telefon ose online përmes Online-Trauungskalender **http://standesamt.linz.at.**
Në rastet e rezervimit me telefon ose online, është e nevojshme që brenda 2 javësh të kontaktoni-personalisht në zyrë.

## Lindja

Lindja e fëmijës duhet të lajmërohet brenda javës nga dita e lindjes. Kjo bëhet automatikisht nëse fëmija lind në ndonjërin nga spitalet e Linzit. Për lindjet në shtepi private, lajmërimi bëhet nga mjeku ose nga mamia. Çertifikata e lindjes jepet nga Zyra e Gjendjes Civile. Dhënja e parë e çertifikatës për të gjithë fëmijët deri në moshën 2 vjeçare është pa pagesë. Sipas kërkesës jepen edhe çertifikata internacionale.
Informata më të hollësishme në: **www.linz.at** » Bürgerservice » Service A-Z » Schwangerschaft und Geburt

## Vdekja

Lajmërimi i rastit të vdekjes me rregull bëhet përmes kompanive të varrimit. Çertifikata e vdekjes merret në Zyrën e banorve dhe të gjendjes civile. Ajo mund të porositet edhe online.
Informata të hollësishme në: **www.linz.at** » Bürgerservice » Service A-Z »Todesfall

## Firmat për organizimin e varrimit

- **LINZ AG-Bestattung (Linz-Mitte)**
  Landstraße 15, Winklerbau, 4020 Linz
  Tel.: 0732-3400 -6700 dhe -6706 (lidhja 24 orëe hapur)
  E hënë – E premte: ora 8:00-17:00
  E shtunë, E diel dhe festa ora 8:00-12:00

- **LINZ AG-Bestattung (Zweigstelle Pichling)**
  Traundorfer Straße 135, 4030 Linz
  Tel.: 0732-3400 - 6731
  www.linzag.at/bestattung
  E hënë-E premte, ora 8:00-14:00

- **LINZ AG-Bestattung (Zweigstelle Urfahr)**
  Rudolfstraße 6, 4040 Linz
  Tel.: 0732-3400-6710
  www.linzag.at/bestattung
  E hënë - E premte: ora 8:00-14:00

- **LINZ AG-Bestattung (Zweigstelle Kleinmünchen)**
  Zeppelinstraße 2, 4030 Linz
  Tel.: 0732-3400-6711
  www.linzag.at/bestattung
  E hënë - E premte: ora 8:00-14:00

- **Bestattung Dobretsberger**
  Landstraße 35, Mozartkreuzung, 4020 Linz
  Tel.: 0732-77 96 88 (lidhja 24 orëe hapur
  www.dobretsberger.at
  E hënë – E premte: ora 7.30-18:00
  E shtunë ora 8:00-12:00
  E diel ora 9:00-12:00 (vetëm në zyrën Rudigierstraße 8/1.Stock)

- **Bestattungshaus Alkin (Zentrale)**
  Friedhof Ebelsberg, Florianer Straße 2, 4030 Linz
  Tel.: 0732-30 76 81
  bestattungalkin@aon.at
  www.bestattung-alkin.at

## Varrezat

- **Bergfriedhof Pöstlingberg**
  Hohe Straße, 4040 Linz-Puchenau
  Tel.: 0732-3400 -6714 ose -6715
  www.linzag.at/friedhoefe

- **Friedhof Ebelsberg**
  Florianer Straße 2, 4030 Linz
  Tel.: 0732-30 76 81

- **Barbarafriedhof**
  Friedhofstraße 1, 4020 Linz
  Tel.: 0732-65 45 14
  office@barbarafriedhof.at
  www.barbarafriedhof.at

- **Friedhof Urfahr**
  Friedrichstraße 20, 4040 Linz
  Tel.: 0732-73 11 54
  http://pfarre-urfahr.dioezese-linz.at/friedhofNEU.htm

- **Islamischer Friedhof im Stadtfriedhof Sankt Martin**
  Wiener Bundesstraße 101, 4050 Traun
  Tel.: 0732-3400-6717 dhe -6718
  www.linzag.at/friedhoefe

- **Jüdischer Friedhof im Friedhof Sankt Barbara**
  Friedhofstraße 1, 4020 Linz
  Tel.:0732-65 45 14

- **Stadtfriedhof St. Martin**
  Wiener Bundesstraße 101, 4050 Traun
  Tel.: 0732-3400 -6717 ose -6718
  www.linzag.at/friedhoefe

- **Urnenhain Kleinmünchen**
  Pestalozzistraße, 4030 Linz
  Tel.: 0732-3400 -6717 ose-6718
  www.linzag.at/friedhoefe

- **Urnenhain Urfahr/Krematorium**
  Urnenhainweg 8, 4040 Linz
  Tel.: 0732-3400-6714 ose -6715
  www.linzag.at/friedhoefe

# SHËNDETËSIA NË LINZ



# 6 SHËNDETËSIA NË LINZ

## Sigurimi social

Në Austri të punësuarit dhe punëdhënësit paguajnëautomatikisht sigurim social (sigurimi i detyruar). Në të përfshihen

- sigurimi shëndetsor,
- sigurimi ndaj aksidenteve,
- sigurimi pensional dhe
- sigurimi gjatë papunësisë.

Pagesa e kontributit për sigurim socialnga i punësuari kryhet çdo muaj nëpërmjet zbritjes nga paga sipas skemës së detyrueshme (llogaritja bëhet sipas shumëssë të ardhurave). Që nga dita e parë e punës ekziston sigurim i plotë social. Sigurimi shëndetsor i pranon shpenzimet për shërim (p.sh.: trajtimet mjeksore, qëndrimi në spital,...). Punëdhënësi/ja është i/e detyruar që vërtetimin e lajmërimit në sigurimin social të ia përcjell punëtorit/es. Ai që nuk e merr këtë vërtetim duhet të drejtohet vetë tesigurimi shëndetsor (Krankenkasse).
Sigurimi i plotë ekziston edhe atëherë kur punëdhënsi nuk e lajmëron me kohë të punësuarin. Në këtë rast mund të dalin probleme si p.sh. karta e sigurimit, “e-card”, te mjeku tregon se nuk ka sigurim shëndetsor.

### Numri i sigurimit social dhe e-Card

Numri i sigurimit social i duhet personit (ose personave të bashkësiguruar) të siguruar gjithmon gjatë

- vizitave te mjeku, te stomatolgu ose shërbime tjera mjekësore,
- kontaktit me shkrim me sigurimin shëndetsor.

Me kartën e sigurimit, e-Card, keni numrin e sigurimit gjithmonëme vete. E-card zëvendson çertifikatën mjeksore (Krankenschein) e cilamë parë, duhej të merrej patjetër, për vizita te mjeku ose në një institucion shëndetsor.

### Sigurimi shëndetësor (edhe për anëtarët e familjes)

Në Austri personat e siguruar dhe anëtarët e tyre të familjes kanë të drejt në shërbime. Këtu përfshihen;

- bashkëshortët, partnerët e regjistruar në kushte të posaçme, personat në bashkjetesë
- fëmijët deri në 18 vjet
- fëmijët deri në 27 vjet, nëse gjenden në shkollim
- anëtarët e tjerë të familjes, si fëmijët e bashkëshortëve, nipat dhe mbesat.
  Për këta vlejnë rregulla të veçanta.

Fëmijët sigurohen pa pagesë. Gjithashtu bashkëshortët, partnerët e regjistruar dhe partnerët në bashkëjetesë te familjet me fëmij.

**Sqarim:** Për bashkëshortët pa fëmijëvlejnë rregulla të posaçme, bashkësigurimi është me pagesë.

## Personat pa sigurim shëndetsor

Ato që nuk janë të siguruar në Austri shërbimet mjeksore, **shpenzimet për diagnozë dhe terapi duhet ti paguajnë vetë.**
Nëse në këtë rast mjetet financiare nuk mjaftojn, dhe sëmundja sipas vlerësimit mjeksor duhet patjetër menjëherë të trajtohet, ekziston mundësia që së pari të bëhet pa pagesë në një spital publik (p.sh. Allgemeines Krankenhaus der Stadt Linz). Shërbimi nuk është falas por shuma e përgjithshme (ose me kamatë) duhet të paguhet, kur personika të ardhura. Në përgjëithsi për personat që nuk kanë sigurim të detyrueshëm (ose të bashkësiguruar si anëtar të familjes) ekziston mundësia për **freiwilligen vetësigurim vullnetar.** Në këto raste sigurimi nuk fillon menjëher por në disa raste ka **kohëpritje.**

- **Oberösterreichische Gebietskrankenkasse (OÖGKK), Hauptstelle**
  Gruberstr. 77, 4020 Linz
  Tel.: 05-78 07-0
  ooegkk@ooegkk.at
  Orari për Kontakt personal: E hënë – E premte ora 6.45-15:00
  Informata – Shërbimi me partnerët: E hënë – E enjte ora 6:00-17:00,E premte ora 6:00-15:00

- **Sozialversicherungsanstalt der gewerblichen Wirtschaft, Landesstelle OÖ**
  Mozartstr. 41, 4010 Linz
  Tel.: 05-08 08 -20 24
  vs.ooe@svagw.at
  Orari: E hënë – E enjte ora 7.30-14.30,E premte ora 7.30-13.30

- **Versicherungsanstalt der öffentlich Bediensteten (BVA), Landesstelle OÖ**
  Hessenplatz 5, 4010 Linz
  Tel.: 05-04 05
  Lst.linz@bva.sozvers.at
  Orari: E hënë - E enjte ora 7:30-14:00, E premte ora 7:30-12:00

- **Versicherungsanstalt für Eisenbahnen und Bergbau, Außenstelle Linz**
  Bahnhofplatz 3-6, 4020 Linz
  Tel.: 050-23 50
  gbz.linz@vaeb.at
  Orari: E hënë – E enjte ora: 7.30-15:00, E premte ora 7.30-13:00

- **Sozialversicherungsanstalt der Bauern**
  Blumauerstraße 47, 4020 Linz
  Tel.: 0732-76 33
  rb.ooe@svb.at

## Sigurimi i aksidenteve

Sigurim të aksidentit në punë ose gjat një smundje profesionale ofron sigurimi i aksidentit.
Si **aksidente në punë** llogariten ata aksidente që ndodhin në vendin e punës, orarin e punës dhe kanë lidhje me punën ose gjatë specializimit profesional. **Sëmundjet profesionale** janë sëmundjet që vijnë si rrjedhojë e ushtrimit të aktiviteteve të punës.
Çdo aksident në punë, gjat të cilit i siguruari është plotësisht ose pjesërisht i paaft për punë më tepër se tre ditë,duhet patjetër të lajmërohen te sigurimi i aksidenteve (AUVA). Sëmundjet profesionale duhet të lajmrohen te punëdhënësi dhe te mjeku. Detyrimet e sigurimit ndaj aksidenteve janë mbrojtja nga aksidentet dhe sëmundjet profesionale, trajtimi mjeksor në punë, përkujdesja për ndihmën e parë, shërimi pas aksidentit ose sëmundjes profesionale, rehabilitimi, dëmshpërblimi dhe riaftësimi.

Sigurimi më i madh ndaj aksidenteve është

➲ **Allgemeine Unfallversicherungsanstalt (AUVA)** AUVA-Landesstelle Linz
Garnisonstraße 5, 4017 Linz
Tel.: 0732-23 33-0
LVR@auva.at
Orari: E hënë – E enjte ora 7:30-16:00, E premte ora 7:30-15:15

# Vizita te një mjek ose mjeke

## e-card

Për një trajtim në objektet shëndetsore të sigurimit social ose vizitat mjeksore, nevoitet një e-card.

**Ç´farëështëe-card?**
„e“është simboli për “elektronike” d.m.th. përkrahje elektronike të proceseve administrative. Përmes e-card-ës mjeku verifikon a jeni dhe në cilin Sigurim Shoqëror (Krankenkasse) jeni i siguruar, llogaritja e shërbimit bëhet automatikisht meSigurimin Shoqëror(Krankenkasse). Përveç shpenzimeve tëshërbimit, pacienti nuk ka pagesa tëtjera për trajtimin mjeksor. Të siguruarit te sigurimet tjera shëndetsore si p.sh. punëdhënsit kanë pjesëmarrje procentuale në shpenzime për shërbime të caktuara.

**Kush ka të drejtën e-card-ës?**
Çdo person (i vetësiguruar ose anëtar i familjes), që në 9 muajt e kaluar ka pranuar shërbime nga një sigurim shëndetsor në Austri në bazë të ligjeve që vijojn:

- Ligji i përgjithshëm për sigurim social (ASVG)
- Ligji për sigurimin shëndetsor dhe të aksidenteve për nënpunës(B-KUVG)
- Ligji për sigurim social të bujqve(BSVG)
- Ligji social për punëtor të biznesit privat (GSVG)
- Për të punësuarit me orar minimal, edhe pse ata nuk përfshihen në sigurim shëndetsor.
- Personat të cilat pranojnë ndihmë minimale.
- Personat të cilat jan të siguruar përmes më tepër ligjesh, kanë vetëm një e-card.
  Gjatë vizitës mjeksore mund të vendoset nga cili sigurim do të bëhet pagesa.
- Të sapo lindurit pajisen automatikisht me e-card menjëherë pas regjistrimit në krankenkasse.

**Ç´farëndodh kur harrojmë e-card-ën?**
Nëse gjatë vizitës mjeksore nuk e kemi e-card-ën me vethte, mjeku mund të kërkoj një paradhënje si garanci që e-card-ës, me qëllim qëtë sillet më vonë. Kjo paradhënie, kërkohet në rastet kur pacienti/a nuk është pacient i rregullt i atj mjeku. Nëse garancia kërkohet në të holla (zakonisht kushton 20 deri në 40 Euro) mjeku/a mund të vendos vetë për shumën e pagesës. Kur e-card-a i paraqitet mjekut,pacientiti kthehentë hollat.

**Kohëzgjatja e vlefshmërisë dhe pagesa për e-card-ën**
Kohëzgjatja e vlefshmërisë së e-card-ës është e pakufizuar. Karta duhet të zëvëndësohet vetëm atëherë kur ndryshojnë të dhënat personale (p.sh. ndërrimi i emrit ose titullit) ose kur karta është e dëmtuar. Nëse në faqen e prapme të kartës ekziston data e kalimit të afatit, kjo vlen vetëm për kartelën e sigurimit evropian.
Pagesa për shërbim, për një **vit kalendarik** është € 10,30 (Gjendja e 2013). Pagesa bëhet edhe për sigurimin e personave të bashkësiguruar. Pagesa për shërbimin tërhiqet automatikisht nga rroga e të punësuarit nga 15 Nëntori i vitit pasardhës.

**Personat e përjashtuar nga pagesa e e-Card-ës:**

- Të punësuarit me orar minimal (Geringfügig),
- Të punësuarit/at të cilët me 15.11. nuk marrin të ardhura (p.sh. përfitim javor, të lindjes , të shërbimit ushtarak ose civil),
- Tëpunësuarit/at për shkak të paaftësisë për punë përfitojn nga punëdhënsi më pak se gjysma e pagës mujore,
- Personat për të cilët dihet se në tremujorin e parë të vitit kalendarik do të dalin në pension dhe me këtë do të çlajmrohen nga sigurimi i detyruar shëndetësor.

**Sa shpesh kemi të drejtë ta përdorime-card-ën?**
Për çdo tremujori, sipas nevojës mund të vizitohet një mjek specialist i të njejtit drejtim (mjek i përgjithshëm, gjinekolog, okulist, stomatolog, etj.) Kjo nënkupton se mund të merren shërbime mjeksore sa herë që është e nevojshme. Në rastet speicifike, mbrenda një tremujori nukështë e mundur që të merren shërbime mjeksore për të njëjtindrejtim, nga dy mjek të ndryshëm specialist. Kjo p.sh. në afatin nga janari deri në mars (tremujori i parë) nuk mund të vizitohen dy mjek të ndryshëm për sëmundje të fytit, hundës dhe veshit (HNO). Përjashtime bëhen nëse ka argumente bindëse edhe këte e aprovon OÖGKK (për vizit te mjeku tjetër speicalist për këtë rast "lejohet" përdorimi i e-card)

Tremujorshi i parë: 1Janar deri 31 Mars
Tremujorshi i dytë: 1Prill deri 30 Qershor
Tremujorshi i tretë: 1Korrik deri 30 Shtator
Tremujorshi i katërt:1Tetorderi 31 Dhjetor

**Humbja e e-card-ës**
Humbja e kartës elektronike duhet që sa më shpejt tëinformohet te sigurimi shëndetsor ose Serviceline të e-card-ës, nën numrin 050/1243311(tarif lokale në gjithë Austrinë).Nësendërkohë keni nevojë për vizitëte mjeku/ja, ka mundësi që përmes numrit të sigurimit të kontrollojë a është ose si është personi i siguruar. E-card duhet më vonë patjetër ti paraqitet mjekut/es.

## Zgjedhja e mjekut sipas nevojës?

Te problemet shëndetësore, hapi i parë është te mjeku i shtëpisë (Hausarzt). Ai nuk e trajton vetëm rastin tuaj shëndetsorpor edhe situatën e përgjithshme, të punës dhe familjes. Përveç kësaj, për rastet që nuk mund të shërohen në ordinancën e tij ju dërgon sipas nevojës te specialisti për trajtim përkatës (p.sh. Përkujdesje, terapi fizike etj.).
Mjekët/et specialiste kanë specializimin përkatës për një drejtim të caktuar të mjeksisë: p.sh. internistët, specialistët për sy, gjinekologët etj. Për këtë drejtim e kanë kryer fakultetin përkatës. Është e arsyshme qëte mjeku specialist të merret një rekomandim nga mjeku i shtëpisë (Hausarzt).

## Kur është e nevojshme vizita në spital?

Në spitale ekzistojnëshërbimetmjekësore të specializuara përkatëse(p.sh. ambulanca për aksidente, për fyt-hundë-vesh, për stomatologji,...), te të cilat bëhet kontrolli dhe sipas nevojës mund përsëri të ktheheni në shtëpi. Kontrollet pas qëndrimit në spital bëhen në ambulancën e spitalit. Ka raste kur mjeku ju udhëzon për kontrolle të mëtejshme.Gjatë fundjavës dhe festave janë të hapura ambulancat e spitaleve që kanë pranim. Për lajmërim nevojitet patjetër e-card-a.Vizita në ambulancën e spitalit është e nevojshme në këto raste:

- Të jepet ndihma e parë jashtë orarit të punës së mjekut,
- Kontrollimi pas dhënies së ndihmës së parë,
- Shërimi duhet të vazhdojënë spitalin ku ka qenë edhe përpara në kurim, dhe
- Shërbimet dhe kontrollet e nevojshme mund të jepen vetëm në atë spital dhe askund tjetër.

**Sqarim:** Ambulancat nuk duhet të kuptohen si zëvendësim i vizitës te mjeku i shtëpisë.

## Klinikat mjeksore

Për mos të pritur gjatë te mjeku, në shumicën e rasteve është e nevojshme të caktoni një orar. Orarit duhet ti përmbaheni dhe të shkoni me kohë (Mund të ndodhë që rastet akute të ken përparësi). Nëse nuk mund të shkoni nëorarin e caktuar, mos harroni ta çlajmëroni atë!

**Zgjedhja e lirë e mjekut / mjekesë**
Kryesisht pacientët mund ta zgjedhin mjekun/ene tyre.

**Mjekët/et e kontraktuar** me sigurimin shëndetsor përkatës (këto janë mjekët/et të cilët kanë kontratë me sigurimin shëndetsor p.sh. me OÖGKK) kanë të drejtë që honorarin për shërbimeta ta llogarisin direkt me sigurimin shëndetësor (Krankenkasse).Pacienti te këta mjek, nuk ka nevojë të paguaj.
Është me rëndësi që, **mjeku i shtëpisëtë** jetë i besueshëm për ju dhe ta zgjidhni afër vendbanimit (Zakonisht këta janë mjekë të përgjithshëm). Mjekët e dinë historinë e sëmundjes suaj dhe mund ta caktoj më lehtëdiagnozën e parë. Nëse ka nevojë do ju dërgoj përmes **udhëzimit me ngjyrë të verdhë,** te specialisti.

**Mjekët privat (pa kontratë)**
Ekziston mundësia që të vizitoni një mjek/e privat. Këta mjek mund të vizitohen nëse pagesa bëhet në mënyrë private, d.m.th. honorari paguhet privat. Llogaria, pas pagesës dërgohet në sigurimin shëndetsor, i cili sipas rregullit i mbulon 80% të honorarit, që do të kishte llogaritur mjeku me kontratë. Mjekët privat honorarin e caktojnë vetë dhe për këte sigurimi shëndetësor mund ta mbuloj një pjesë

të vogël të faturës. Diferenca mund të jetë e madhe. Për këtë shkak, para fillimit të trajtimit, duhet patjetër të informoheni për shpenzimet.

**Mjekët/et me njohuri të gjuhëve të huaja**
Në Linz ka rreth 600 mjekë/e prej të cilëve rreth 200 mjek të mjekësisë së përgjithshme, të tjerët janë mjek specialist si p.sh. stomatolog, për syt (okulist). Mjeket/ët me njohuri të gjuhëve të huaja mund ti gjeni në listën e Dhomës së Mjekëve /Ärztekammer) të Austrisë së Epërme.
Adresa në internet: **http://aekooe.or.at/cms/index.php?id=1037**

## Pushimi mjeksor për të punësuarite

Gjatë sëmundjes dhe paaftësisë për punë duhet patjetër të lajmroheni menjëherë te punëdhënësi.

- Pushimi mjeksor principielisht duhet të caktohet nga mjeku që ju trajton.
  Mjekët me kontratë e bëjnë direkt lajmrimin në sigurimin shëndetsor.
- Nëse jeni të paaftëpër punë për shkak të sëmundjes, duhet menjëherë të shkoni te mjeku. Lajmrimi i pushimit mjeksor, më shumëse një ditë pune, është i mundur vetëm në rastet e arsyeshme!
- Sigurimit shëndetsor(Krankenkasse) i duhet lajmrimi dhe çlajmrimi i pushimit mjeksor që të mund ta jap çertifikatën e pushimit mjeksor. Kjo vlen edhe në ato raste – p.sh. për kompensim – nuk ka marrë pagesë për pushim mjeksor.
- Gjatë një trajtimi në ambulancë të një spitali, nuk dorëzohet automatikisht lajmërimi i pushimit mjeksor. Për këte duhet të merrni vërtetim nga ambulanca e spitalit dhe me këtë ta la jmëroni pushimin mjeksor në Sigurimin Shoqëror (OÖGKK).
  Karta e ambulancës nuk vlen si lajmërim i pushimit mjeksor!
- Qëndrimi në spital (kjo vlen edhe për qëndrimin në qendër rehabilitimi) lidhet automatikisht me pushimin mjeksor. Ju lutemi që pasi të dilni nga spitali ta vizitoni mjekun tuaj, i cili e cakton a ka, dhe sa gjat ka nevojë të rini në pushim mjeksor. Çlajmrimi i pushimit mjeksor mund të bëhët përmes mjekut tuaj.

Pasi të lajmroheni si i shëndoshë duhet këtë ta paraqitni te Krankenkasse. Për ndërprerjen e pushimit mjeksor është përgjegjës mjeku juaj. Por është e mundur dhe ju vetë ta ndërprisni pushimin mjeksor (p.sh. në ÖOGKK lajmrohuni si i “shëndoshë” ne internet përmes formularit „Gesundmeldung“ në internet **www.ooegkk.at** » Gesundmeldung).

**Pagesa e pushimit mjeksor:**
Nëse pagesa e rrogës nga punëdhënsi mbaron, ka mundësi që për vazhdimin e paaftësisë për punë për një kohë të caktuar të merret pagesa e pushimit mjeksor. Pagesa e pushimit mjeksor e zëvendson një pjesë të madhe të rrogës gjatë punës.

# Informata rreth spitalit

## Spitalet në Linz

- **Allgemeines Krankenhaus der Stadt Linz**
  Krankenhausstr. 9, 4020 Linz
  Tel.: 0732-78 06
  www.akh.linz.at
  Orari i vizitave: çdo ditë ora 13.30-15.30; ora 18:00-19:00
  E shtunë, e dielë, ditët e festave nga ora 10:00-11:00

  Në pavionin intensiv ekzistojnë vizita individuale (Informatat te personeli për përkujdesje)
  Në rast se nevojitet ndihmë për të komunikuar mundësohet prania e përkthyesve.

- **Diakonissenkrankenhaus Linz**
  Weißenwolffstr. 15, 4020 Linz
  Tel.: 0732-76 75-0
  www.diakonissen-krankenhaus-linz.at

- **Krankenhaus der Barmherzigen Brüder**
  Seilerstätte 2, 4020 Linz
  Tel.: 0732-78 97-0
  www.bblinz.at
  Orari i vizitave: çdo ditë nga ora 13:00-15:00 ora 18:00-19:00

- **Krankenhaus der Barmherzigen Schwestern**
  Seilerstätte 4, 4020 Linz
  Tel.: 0732-/76 77-0
  www.bhslinz.at
  **Orari i vizitave:** çdo ditë ora 13:00-15.30; ora 17.30-19:00,
  të dielave dhe ditët e festave: ora 10:00-11:00
  **Pavioni i fëmijve:** ora 13.30-17.30 për prindët nuk ka kufizim vizitash
  **Pavioni intensiv operativ:** çdo ditë ora 13.30-18.30
  **Sigurim suplementar:** çdo ditë ora 7:00-20:00

- **Krankenhaus der Elisabethinen**
  Fadingerstr. 1, 4020 Linz
  Tel.: 0732-76 76-0
  www.elisabethinen.or.at
  Në spitalin këtë spital nuk ka orar fiks për vizita, por është me rëndësi të merret parasysh koha e pushimit:
  Koha e pushimit, në pavioni normal: ora 12:00-14:00 dhe ora 20:00-7:00
  Koha e pushimit në pavioni intensiv operativ: ora 13.30-15.30 dhe ora 18:00-7:00
  Koha e pushimit, në pavionin intensiv të organeve: ora 14.30-16.30 dhe ora 20:00-7:00

**Landesfrauen- und Kinderklinik Linz**
Krankenhausstr. 26-30, 4020 Linz
Tel.: 050-554 63-0
www.frauenklinik-linz.at

Koha e vizitave te pavioni i grave dhe i lindjeve:
çdo ditë ora 13.30-15.30 dhe ora18:00-19:00
Pushim në kohë dreke ora 11.30-13.30

Orari i vizitave në stacionin e fëmijve:
Për prindët e fëmijës nuk ka kufizim.
Orari i vizitave: çdo ditë ora 14-18
Pushim: ora 12:00-14:00

Në pavioninintensiv interdisiplinar dhe neonatologjik nuk ka kohë të përcaktuar vizitash. Kuptohet prindët mund ta vizitojnë fëmijën 24 orë në marrëveshje me personelin për përkujdesje. Sipas nevojës mundësohet prania e përkthyesve.

**Landesnervenklinik Wagner Jauregg**
Wagner-Jauregg-Weg 15, 4020 Linz
Tel.: 050-554 62-0
www.wagner-jauregg.at

Orari i vizitave: çdo ditë ora 14:00-15.30; ora 18:00-19:00
E shtunë, e dielë, ditët e festave në ora 9.30-10.30
Në rast se nevojitet ndihmë për të komunikuar mundësohet prania e përkthyesve.

Unfallkrankenhaus
Garnisonstraße 7, 4020 Linz
Tel.: 0732-69 20-0
www.auva.at/ukhlinz

Orari i vizitave: çdo ditë ora 13-20
E shtunë, e dielë, ditët e festave në ora 9-11.30

## Cili spital ka pranime?

Informatat për spitale të tjera të Linzit, të cilët kanë pranim, mund ti gjeni në gazetat aktuale ditore ose në internet: **www.linz.at/akh/1489.asp**

## Qëndrimi në spital

Për pranim në spital duhet patjetër e-card-a dhe nëse e keni rekomandimin e mjekut. Pacientët me sigurim suplementar duhet gjithashtu ta kenë numrin e sigurimit suplementar dhe duhet të nënshkruajnë një formular të veçantë. Të jini të përpikët në orarin që keni!

**Kostoja e shtrimit në spital**
Sigurimi shëndetsor i mbulon shpenzimet – me përjashtim të një pagese minimale-participimi (Selbstbehalt) i cili paguhet nga pacienti – e shtrimitnë spital.

**Tarifa ditorepër të siguruarit:11,46Europër ditë** (Gjendja në2013), por për më së shumti 28 ditë në vitin kalendarik –kjo donë të thotë nëse dikush qëndron më gjat se 28 ditë në spital mbrenda vitit kalendarik për ditët tjera (mbi 28 ditë) nuk duhet të paguajtarifën ditore.Kjo tarifë nuk vlen për pacientët që janëtë rimbursuar nga Sigurimi Shoqëror (OÖGKK) dhe pacientët me sigurim suplementar.

**Tarifa ditorepër anëtarët e familjes: deri në 18,30 Euro për ditë** (Gjendja në 2013 maksim. për 25 ditë për vit kalendarik). Tarifa ditorenuk vlen për lindjet. Tarifa duhet patjetër të paguhet në ditën e daljes nga spitali. Nëse dikush del nga spitali të shtunën, të dielën ose gjatë festave, llogaria i dërgohet me postë në shtëpi.

## Këshillim dhe shoqërim gjatë problemeve psiqike

Raste të rënda (humbja e vendit të punës, vdekja e të afërmve, probleme financiare, divorci, ...) janë ndryshime rrënjësore në jetën e njeriut dhe e trondisin ekuilibrin shpirtëror. Nëse njeriu është i paaftë për tu përballura me problemet dhe nuk di se si duhet të vazhdojë jetën normale ose sëpaku e ka ndjenjën se gjithçka e bën gabim, atëherë nuk duhet të ngurojë që të marrë ndihmën profesionale te psikologu, psikiatri ose psikoterapisti.

### Urgjenca

- **Urgjenca e shërbimit psikosocial**
  Urgjenca për krizë psiqike, 24 orë pa pagesë
  Tel.: 0732-65 10 15

- **Qendra e ndërhyrjes në raste krizash**
  Qender e terapisë për njerëzit me kriza psiqike
  Hessenplatz 9, 4020 Linz
  Tel.: 0732-21 77
  Prej të hënës deri të enjten ora 8:00-17:00
  Të premten ora 8:00-15:00

- **Urgjenca për ndihmë shpirtrore 142**

- **Landesnervenklinik Wagner-Jauregg**
  Wagner-Jauregg-Weg 15, 4020 Linz
  Tel.: 050-554 62-0

### Qendra të tjera kontakti

- **Klinika interkulturore, Landesnervenklinik Wagner Jauregg**
  Te sëmundjet akute ose të rënda psiqike oferta speciale për trajtim me përkthyes
  (pas caktimit të orarit)
  Wagner-Jauregg-Weg 15, 4020 Linz
  Tel.: 050-55 462-26 531
  E martë ora 13-15, E premte ora 9-11

- **Qendra psikosociale në Linz, Pro mente**
  Scharitzerstr. 16, 4020 Linz
  Tel: 0732-66 82 38
  psb.linz.mitte@promenteooe.at
  Znj. **Mag.[a] Zarfina Helac** Psikologe, konsulta, terapi sociale në gjuhën boshnjake-kroate-serbe

**Point, këshillimore për çështje të pamvarësisë Pro mente**
Figulystr. 32, 4020 Linz
Tel.: 0732-77 08 95-0
www.sucht-promenteooe.at

Orari: E hënë, e premte ora 10:00-14:00
E martë, e enjte ora 13:00-17:00

**Qendra psikosociale Linz-Urfahr, Exitsozial**
Këshillim,ndërhyrje gjatë krizave, psikoterapi
Wildbergstr. 10a, 4040 Linz
Tel.: 0732-71 97 19
pszlinz.beratung@exitsozial.at

Orari: E hënë – E premte ora 8:00-16:00

**Ambulanca sociopsiqike, Exitsozial**
Këshillim specialistik dhe informacion, diagnostik dhe trajtim, urgjencë psikiatrike, këshillimi i anëtarve të familjes, trajnim psikologjik, pregatitje për psikoterapi, terapi grupore në klinikat ditore
Wildbergstr. 10a, 4040 Linz
Tel.: 0732-70 05 95
ambulanz@exitsozial.at

Orari: E hënë, e premte ora 9-15
E martë, e enjte ora 14-18
E mërkurë ora 14-16

**Përkujdesja mobile, Exitsozial**
Konsultë dhe shoqërim në banesë
Ferihumerstraße 5/1, 4040 Linz
Tel.: 0732-71 69 63
Mobet.wg@exitsozial.at

**Migrare–Zentrum für MigrantInnen OÖ**
Humboldtstr. 49, 4020 Linz
Miladinka Dujakovic, Konsultë psikosociale në gjuhën boshnjake-kroate-serbe dhe gjermanisht,
Tel.: 0732/66 73 63-12
Cihangir Murat Özbilgin, Konsultë psikosociale në turqisht dhe gjermanisht,
Tel.: 0732-66 73 63-28

**Volkshilfe Flüchtlingsbetreuung Oberösterreich,**
**OASIS Përkujdesje psikoterapeutike për refugjatët**
Tel.: 0732-60 30 99-30
therapieprojekt@volkshilfe-ooe.at

➲ **BILY qendër konsultimi për çështjet seksuale për të rinj dhe familje**
Weißenwolffstr. 17a, 4020 Linz
Tel.: 0732-77 04 97
beratung@bily.info

| | | |
|---|---|---|
| Orari: | E hënë: | ora 15:00-18:00 |
| | E mërkurë: | ora 17:00-20:00 |
| | E enjte: | ora 12:00-15:00 |

➲ **PGA – Shoqata e punës shëndetsore profilaktike**
PGA ofron në Linz (dhe në gjithë Austrinë e Epërme) në ambulancat shëndetësore psikoterapi gratis. Në këtëzyrë të interesuarit mund të marrin sqarime për nevojat e tyre.
Museumstr. 31a, 4020 Linz

Zyra për psikoterapi
0800/202 533
info@clearingstelle.net

| | | |
|---|---|---|
| Orari: | E hënë: | ora 8.30-12.30 |
| | E martë: | ora 8.00-17.30 |
| | E mërkurë: | ora 8.30-14.30 |
| | E enjte: | ora 8.00-17.30 |
| | E premte: | ora 8.30-13.30 |

# Shërimi

## Barnat, receta

Në rastet kur mjeku ju rekomandon barna, ju jep një **recetë.** Receta duhet të jetëe plotësuar. Në një barnatoreju merren barnat e nevojshme. Me këtë nuk paguhet çmimi i plot i barnave, që  në disa raste mund të jetë shumë i lartë, por vetëm **tarifa për recetë prej 5,30 Euro** (Gjendja në 2013) për një medikament.

**Rimbursimi i medikamenteve:**
Nëse të ardhuratmujore neto, nuk e kalojnë shumën e mëposhtme mund të paraqitni kërkesën, për-rimbursim të medikamenteve në  Sigurimin Shoqëror (Gebietskrankenkasse):
€ 837,63 për persona që jetojnë vetëm*
€ 1.255,89 për çifte*
*(Gjendja në2013)
Shuma rritetpër çdo fëmijë që banon me ju, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetsore dhe ka sh-penzime të larta, ato duhet të jenë të  dokumentuara.

**Produktet me bazëhomeopatike**
Medikamentet homeopatike janë të prodhuara në bazë krejt natyrale, dhe gjenden në barnatore. Meqenëse efikasiteti i produkteve homeopatike nuk është i vërtetuar shkencërisht, Sigurimi Shoqëror(Krankenkasse) sipas rregullit nuk i mbulon shpenzimet për to.

**Kujdes me medikamentet:**
Në barnatore shënohet te paketa e barnave si dhe sa shpesh duhet të merret një medikament: si p.sh. „(1 / 1 / 2)“ nënkupton se në mëngjes merret një tabletë, në drekë një tabletë dhe dy tableta në mbrëmje, ose„(1 / - / 1)“: një tabletë në mëngjes, në drekë nuk merret asnjë dhe në mbrëmje një tabletë.

- Sidoqoftë, duhet patjetër ti përmbaheni dozimit që e ka caktuar mjeku!
  Nëse medikamentin nuk mund ta duroni (efekte negative), duhet sa më parë ta kontaktoni mjekun ose të informoheni në barnatore!
- Me rëndësi është që ti përmbaheni edhe kohëzgjatjes së përdorimit të medikamenteve – ato nuk duhet ti ndërpritni pa u konsultuar me mjekun!
- Disa barna duhet të ruhen në frigorifer – Lexoni shënimin në paketë!
- Për barnat që duhet ti merrni rregullisht. Përkujdesuni që me kohë ta merrni recetën te mjeku/ja!
- Barnat që keni në shtëpi, duhet gjithmonë t'ua kontrolloni skadimin e afatit që është i shënuar në paketën e barnave!
- Barnat, të cilave u ka skaduar afati, mos i hidhni në mbeturinat e shtëpisë, por dorëzoni në një barnatore!
- Për paqartësi pyesni në barnatore!

**Barnat pa recetë**
Ka edhe medikamente që mund të merren pa recetë mjeksore (tableta kundër dhimbjeve, vitamine, shurup kolle...) në barnatore. Për këte ka në të gjitha barnatoret, në çdo kohë këshillim pa pagesë. Edhe për barnat që merrni pa recetë duhet të informoni mjekun/en, nëse merrni barna të caktuara nga mjeku.Medikamentet pa recetë mund të kenë ndikim negativ, nëse merren së bashku me një medikament tjetër.

## Barnatoret në Linz

Barnatoret mund ti gjeni kudo, ku e shihni shenjën, Apothek. Barnatoret, që kanë shërbim gjatë **Natës** ose gjatë **fundjavës** ose gjatë **festave,** mund ti shihni në gazetat aktuale ditore ose në tabelat e barnatoreve në afërsi të vendbanimit si dhe në internet në **www.apotheker.or.at** si dhe në ORF në faqen 649 të teletekstit.

**Informata në telefon:**

| | |
|---|---|
| Samariterbund | 0732-21 24 |
| Rotes Kreuz | 0732-76 44-0 |
| Rettungsleitzentrale | 0732-21 44 |

Plani i kujdestarisë mund të merret në barnatore. Blerja e barnave në barnatorenme shërbim në kohën prej orës 20:00 në mbrëmje deri në orën 8:00 në mëngjes kushton **3,80 Euro** më tepërtë dielën dhe gjatë festave **1,30 Euro*** (*Gjendja në 2013).

# Ruajtja e shëndetit

Në Austri ka oferta të shumta të cilat ndihmojnë për shëndetin dhe ruajtjen e tij.

## Vizitat profilaktike mjeksore (Vorsorgeuntersuchung)

Edhe pse njeriu ndjehet i shëndoshë, është mirë që të bëjë kontrolle të rregullta mjeksore të gjendjes shëndetsore. Shumë sëmundje që zbulohen herët mund të tejkalohen dhe më shpejt dhe më lehtë të shërohen. Për personat mbi 18 vjeç, një herë në vit mund të bëjnë një kontrollë parandaluese (profilaktike) pa pagesë.

**Programi bazik i vizitës profilaktike përmban:**

- Analizë gjaku
- Analizë urine
- Analizë e jashtëqitjes për gjurmë gjaku (mbi moshën 40 vjeçare)
- Sondë anale e zorrës së trash (për personat mbi moshën 50 vjeçare/çdo 10 vjet)
- Konsulltë për sëmundjet e deritanishme dhe shqetësimet aktuale
- Kontrollë e përgjithshme e trupit (përfshin gjoksin/prostatën)
- Matja e tensionit të gjakut
- Bisedë përfundimtare

Gjat bisedës përfundimtare do ti merrni rezultatet e analizave dhe këshillat si mund ti zvogloni faktorët e rrezikut dhe të jetoni më shëndetshëm. Për gratë ofrohet vizitë profilaktike speciale te mjeku/mjekja e grave (gjinekologu) e cila përbëhet nga një bisedë me qëllim të konstatimit të hershëm simptomatik të sëmundjeve dhe në marrjen e analizës për pap-testin (test për zbulimin e hershëm të kancerit). Për gratë mbi moshën 40 vjeçare ofrohet gjithashtu një herë në vit një vizitë radiologjike (mamografi) e gjoksit. Për këte duhet ti kryeni këto vizita profilaktike vjetore! P.sh. në OÖGKK:

➲ **Vorsorgeuntersuchung Linz**
OÖ. Gebietskrankenkasse
Garnisonstraße 1a, 4020 Linz
Caktimi i orarit: Tel.: 05-78 07-10 35 43
vorsorgeuntersuchung@ooegkk.at

## Qendra konsulltimi për nënat (prindërit)

Për çështjet e shëndetit të foshnjës ose fëmijëve të vegjël, qendrat e konsultimit në Linz ju ofrojn **konsullta gratis** në afërsi të vendbanimit tuaj, përmes një **specialisti për fëmij (pediatri ose pediatre)** në lidhje me: ushqimin, përkujdesjen, vaksinimin

➲ **Auwiesen, Allendeplatz 4, 4030 Linz**
Tel.: 0732-31 17 42
E hënë ora 14.30-17:00, E enjte ora 9:00-11.30

➲ **Biesenfeld, Dornacher Str. 7, 4040 Linz**
Tel.: 0732-24 35 61
E martë ora 14-16.30, E premte ora 9-11.30

➲ **Ebelsberg-Ennsfeld, Hofmannsthalweg 8, 4030 Linz**
Tel.: 0732-30 10 56-18
E hënë ora 9:00-11.30, E mërkurë ora 14.30-17:00

➲ **Oed, Europastr. 12, 4020 Linz**
Tel.: 0732-37 13 75
E premte ora 9:00-11.30

➲ **Franckstraße (Dorfhalle), Franckstr. 68, 4020 Linz**
Tel.: 0732-65 45 41-14
E mërkurë ora 9:00-11.30

➲ **Spallerhof, Glimpfingerstr.10-12, 4020 Linz**
Seniorenzentrum, Bau 4, Eingang Gartenebene
Tel.: 0732-34 08-12 607
E martë ora 14.30-17:00

➲ **Karl-Steiger-Straße, Karl-Steiger-Str. 2, 4030 Linz**
Tel.: 0732-30 20 71
E mërkurë ora 14:00-16.30

➲ **Leonfeldner Straße, Leonfeldner Str. 80, 4040 Linz**
Tel.: 0732-73 12 69
E mërkurë ora 14.30-17

➲ **Neues Rathaus, Hauptstraße 1-5, 4041 Linz**
Tel.: 0732-70 70-26 60
E enjteora 14.30-17:00

➲ **Pichling, Heliosallee 84, 4030 Linz**
Tel.: 0732-32 00 71-31
E martë ora 14:00-16.30, E entje ora 9:00-11.30

➲ **Neue Heimat, Rohrmayrstr. 1, 4030 Linz**
Tel.: 0732-38 20 08
E martë ora 14.30-17:00

➲ **Tegetthoffstraße, Tegetthoffstr. 23, 4020 Linz**
Tel.: 0732-65 35 68
E enjteora 14.30-17:00

➲ **Zaunmüllerstraße, Zaunmüllerstr. 4, 4020 Linz**
Tel.: 0664-47 45 002
E hënë ora 14.30-17.00

## Vaksinimi

Vaksinat janë mjeti më efektiv mbrojtës nga sëmundjet e rrezikshme – p.sh. nga riqrat (FSME), paraliza fëminore, difteria, fruthi – shytat – rubeola,... Libreza e vaksinimit ndihmon që të kemi një pasqyrë për vaksinat që fëmija ka bërë. Në raste sëmundjesh libreza është ndihmëse e madhe për mjekun/en, në konstatimin e mbrojtjes vaksinore të organizmit të fëmijës.

**Vaksina kundër rriqrës (Zecke)**
(FSME)
Pickimi nga një rriqër mund të shkaktoj sëmundje nga virusi FSME. Pasojat e kësaj sëmundje mund të shkaktojnë paraliza dhe të shkaktojnë vdekjen. E vetmja mbrojtje efektive për këtë është vaksina.

- Është i mundur pas moshës një veçare, vaksina bazike përbëhet nga 4 vaksina të pjesëshme
- Zgjatja e efektit mbrojtës të vaksinës: së paku 5 vjet (nga mosha 60 vjeçare 3 vjet), pastaj rekomandohet rivaksinimi.

**Hepatiti A / Hepatiti B**
Bartja e virusit të hepatitit A bëhet përmes : ujit të papastër, lëngjeve ose kontaktit direkt me personin e infektuar.

- Vaksinë e kombinuar (A+B)ose vaksinë e veçantë
- Nga hepatiti A mbrojtja zgjat 20 vjet, nga hepatiti B, 10 vjet

**Vaksina kundër tetanozit (Tetanus)**
Sporet e tetanozit ndodhen në tokë në mbarë botën dhe jan shumë rezistente. Ndotja e një plage me këto spore mund të shkaktoj futjen e tyre në trup.

- Të rriturit: 2 vaksina të pjesëshme me një ndërprerje 4 javore, e treta pas 6-12 muajsh
- Rivaksinimi: çdo 10 vjet
- Fëmijët: Mund ta marrin qysh si foshnjë

**Vaksina kundër gripit**
Sidomos për njerëzit e moshës mbi 60 vejçare, të sëmurëve kronik dhe fëmijëve të vegjël, rekomandohet.

- Vaksinim një herë në vit

(Përmbledhje „Vaksinat“ bazuar në broshurën „Gesund bleiben und mit Krankheiten umgehen“; Rotes Kreuz, 2003)

**Fëmijët dhe të rinjt u ekspozohen një rrezikut të madh nga infektimi, prandaj mbrojtja me vaksinimi është shumë e rëndësishme. Vaksinimi me kohë e mban familjen të shëndoshë!**

**Shërbimi për vaksina i Zyrës  për Shëndetsi të Qytetit të Linzit ofron këto vaksina kundër**

- Difterisë-Tetanozit
- Pertusit(Kolli i mirë)
- Hemofilus influencab
- Poliomielitit(Paraliza e fëmijve)
- Fruthit-shtytave-rubeolës
- HepatititB
- Rriqrave (FSME)
- Gripit
- Meningokokken
  (aktuel deri në moshën 15 vjeçare pa pagesë)
- Pneumokokken

Vaksinat (me përjashtim të vaksinës kundër rriqrave dhe gripit) për fëmijët deri në moshën 18 vjeçare (meningokoket deri në moshën 15 vjeçare) janë pa pagesë. Për koston e vaksinave për të rritur, ju informon Zyra e Shëndetësis.
(Gjendja: Korrik 2013)

- **Gesundheitsamt der Stadt Linz, Impfservice**
  Neues Rathaus, Hauptstr. 1-5, 4041 Linz
  Tel.: 0732-70 70-26 31
  impfservice@mag.linz.at
  E hënë - e premte: ora 7.30-12:00
  E hënë - e enjte: ora 14:00-17:00

- **Institucionet dhe iniciativat tëtjera**
  www.lovetour.at
  Në www.lovetour.at të rinjtë mund të gjejnë informata dhe sqarime për seksualitet, pubertet, mbrojtje nga shtatëzania, flirtin. Gjithashtu ofrohen edhe këshillime personale për çështje seksuale online.

- **PGA Këshillime për shëndetin e dhëmbëve**
  PGA këshilltarët për shëndetin e dhëmbëve i këshillojn fëmijët në moshën shkollore dhe në çerdhet e fëmijve. Së bashku me fëmijët i mësojn teknikën e larjes së dhëmbëve, e provojn këte dhe japin këshilla për ushqim të shëndetshëm. Gjithashtu edhe për prindër dhe pedagoge ka programe informative.

- **PGA, Shoqata për punë profilaktike të shëndetit**
  Museumstraße 31a, 4020 Linz
  Tel.: 0732-77 12 00
  office@pga.at
  www.pga.at

# Çështjet e grave

## Shtatzania

Gratë,nga fillimi i shtatzanisë së tyre duhet të vizitojnë rregullisht gjinekologun/en. Atyre atje ju jepet një **pasaportë nënë – fëmijë (mutter-Kind-Pass).** Me pasaportë nënë – fëmijë mundësohet **kprogrami i vizitave gratis,**gjatë shtatzanisë dhe viteve të para të foshnjës.Vetëm kështu sëmundjet mund të zbulohen herët dhe me kohë të shërohen. Pasaporta nënë – fëmijë, lëshohet që në fillim të shtatzanisë. Gjatë shtatzanisë parashikohen brenda afateve të caktuara 5 vizita gjinekologjike.
Për fëmijën tuaj janë të parapara gjithsejt nëntë vizita mjeksore, nga java e parë ederi në moshën 5 vjeçare. Të gjitha vizitat regjistrohen në pasaportën nënë – fëmijë nga mjeku përkatës (gjinekologu, pediatri, mjeku i përgjithshëm). Duhet ta keni parasysh që, vizitat shëndetsore gjatë shtatzanisë sëbashku me vizitat e fëmijës deri në muajin e 14-të, janë kushti për aprovimin e pagesës së plotë të kompensimit për përkujdesje ndaj fëmijve, gjithashtu edhe pas muajit të 21-të të fëmijës.

**Ku merret pasaporta nënë – fëmij?**

- te gjinekologja ose gjinekologu
- te mjeku i përgjithshëm
- te Zyra e Shëndetësisë e Qytetit të Linzit
- në ambulancat e spitaleve me pavionlindje

**Duhet të keni kujdes që:**

- Pasaportën nënë – fëmië gjatë shtatzanisë duhet  ta keni gjithmonë me vete! Ajo lehtëson dhënien e shpejt të ndihmës në raste emergjente.
- Të gjitha vizitat mjekësore duhet të kryhen në kohën e caktuar dhe të regjistrohen!
- Vizitat e obligueshme mjekësore jan kushti themelor për të drejtën në kompensim për p ërkujdesje ndaj fëmijve.
- Gjatë shtatzanisë duhet t´u largoheni ngarkesave fizike!
- Për gratë që janë të punësuara është e rregulluar me ligj që, 8 javë para lindjes dhe 8 javë pas lindjes, nuk lejohet të punojnë (Mutterschutz).

**Kompensimi për nënën dhe fëmijën nga Qeveria e Krahinës (Land OÖ)**
Land OÖ aprovon një kompensim prej 370 Euro për nënën dhe fëmiun (pagesa bëhet dy herë nga 185 Euro). Kusht për aprovimin e kësaj ndihme financiare është kryerja e vizitave të obligueshme në **„fletoren profilaktike“** („Vorsorgeheft“). Atë mund ta gjeni te mjeku i shtëpisë, pediatri ose gjinekolo-gu. (Ato gra që kanë vendbanim të përhershëm në Linz, nuk ka nevojë që formularit të kërkesës t‘ia bashkangjesin vërtetimin e bashkisë)

**Kujdesi gjat shtatzanisë**

- **Kurs parapregatitor për lindjen**

Sipas mundësive do të duhej të vizitohej kursi parapregatitor për lindjen! Këto kurse mundësojnë kontaktin me gra të tjera, të cilat gjithashtu presin fëmijë. Gjatë kësaj kohe mund të merrni këshilla të rëndësishme për periudhën e shatzanisë, të lindjes dhe kontaktit të parë me foshnjën. Kurse parap-regatitore ofrojnë të gjithë spitalet me pavion gjinekologjik dhe të lindjes, por edhe shumë gjinekolog, Volkshochschule Linz (VHS) si dhe qendrat për prindër e fëmijë.

**Konsulta për gratë shtatzëna**
Nëqoftëse gjatë shtatzanisë keni nevojë për konsulta atëherë drejtoheni në adresat e mëposhtme:

➲ **Frauen- und Kinderklinik Linz**
Ambulanca gjineklologjike dhe ambulanca për intervenca ditore
Krankenhausstr. 9, 4020 Linz
Tel.: 05-05 54 63-23 730
E hënë – E premte ora 8:00-14:00

➲ **Instituti i Konsultave për Familje dhe të Rinj i Qytetit të Linzit**
Rudolfstr. 18, 4040 Linz
Tel.: 0732-70 70-27 00
inst.fjb@mag.linz.at

➲ **Zoe konsultë për gratë shtatzëna**
Gruberstraße 15, 4020 Linz
Tel.: 0732-77 83 00
office@zoe.at
www.zoe.at

E hënë - e enjte ora 8:00-12:00
(Për konsultë duhet të caktoni orar)

## Lindja e fëmijës

**Lindja në spital**
Për lindjen e fëmijës ju mund të zgjidhni një nga spitalet e mëposhtme në Linz:

- Frauen- und Kinderklinik Linz
- Allgemeines Krankenhaus der Stadt Linz
- Krankenhaus der Barmherzigen Brüder
- Diakonissen-Krankenhaus (Nevojitet sigurim suplementar!)

Pasi të keni vendosur në cilin spital do të kryeni lindjen, duhet menjëherë të kontaktoni me personelin e spitalit, mundësisht që në muajt e parë të shtatzanisë.Shfrytëzoni mundësinë, që të shihni sa më parë pavionin dhe sallën e lindjes!
Ekziston edhe alternativa e **"lindjes ambulante":** Ju mund ta lindni fëmijën në spital dhe të dilni nga spitali 24 orë pas lindjes dhe të keni përkudjesjen e një mamie në shtëpi.
Të gjitha gratë që dëshirojn një **lindje në shtëpi („Hausgeburt"),** duhet sa më parë të interesohen të siguroni një mami si dhe për kushtet që duhet plotësuar për lindjen:
**Oö. Hebammengremium:** Tel. 0676-684 18 44
**www.oberoesterreich.hebammen.at**

## Vizita profilaktike gjinekologjike

Për një konstatim dhe trajtim të hershëm të sëmundjeve, është e rëndësishme ti nënshtroheni **çdo 6 muaj** një vizite gjinekologjike te mjekja/u speicalist. Vizita gjinekologjike përfshin ekzaminimin e përgjithshëm, atë të gjoksit si dhe pap-testin.

## Aborti

Ndërprerja e shatzanisë (aborti) në Austri është e mundur para përfundimit të muajit të tretë të shtatzanisë me konsultë mjeksore. Në Linz aborti mund të bëhet në Allgmeines Krankenhaus.

**Informacione tëtjera për temën shëndeti i grave:**

➲ **Linzer Frauen Gesundheitszentrum**
Kaplanhofstr. 1, 4020 Linz
Tel.: 0732-77 44 60
office@fgz-linz.at
www.fgz-linz.at

Öffnungszeiten:

| | |
|---|---|
| E hënë | ora 9-12 |
| E martë | ora 13-16 |
| E mërkurë | ora 15-19, Frauencafé ora 16.30-18 |
| E enjte | ora 9-12 |
| E premte | ora 9-12 |

# Personat në pritje për azil politik

Prej datës 1.5.2004, në Austri ka hyrë në fuqi sistemi i "Shërbimit Bazë Shëndetsor" për të "huajt",të cilët kanë nevojë për përkrahje dhe ndihmë (personat në kërkim të azilit politik, personat me azil politik, të dëbuarit nga vendi i tyre, që nuk kanë mundësi të kthimit direkt dhe të tjerët që nuk mund të dëbohen për arsye të caktuara). Përmes këtij ligji ata kanë në dispozicion njësigurim shëndetsor.

Për të gëzuar të drejtën e sistemit shëndetsor (vizita mjeksore, barna,...) nevojitet numri personal i sigurimit shëndetsor, të cilin e lëshojnë qendrat fillestare të pranimit (St. Georgen im Attergau ose Traiskirchen).

- **Dienststelle Linz - Hauptstelle**
  Gruberstraße 77, 4020 Linz
  Tel.: 05-78 07-0
  ooegkk@ooegkk.at
  Orari: E hënë – E premte ora 6.45-15:00

- **Dienststelle Linz Urfahr**
  Hauptstrasse 16-18, 4040 Linz
  Tel.: 05-78 07-24 39 00
  urfahr@ooegkk.at
  Orari: E hënë - E premte ora 6.45-15:00

- **Dienststelle Linz Kleinmünchen**
  Zeppelinstraße 58, 4030 Linz
  Tel.: 05-78 07-23 37 00
  kleinmuenchen@ooegkk.at
  Orari: E hënë-E premte ora 6.45-15:00

Vajtja për herë të parë në shërbimet shëndetësore, duhet bërë pas konsultimit me personelin e kujdestarisë në qendrën e strehimit tuaj. Personat me procedurë për azil politik nuk paguajnë **arifën e recetës** mjeksore për barnat, si dhe **tarifën ditore të shtrimit në spital.**

## Rastet emergjente

Gjatë lajmrimit për një aksident, duhet patjetër të jepni të dhënat e mëposhtme:

**Ku ka ndodhur aksidenti?**
**Ç´farë ka ndodhur gjat aksidentit?**
**Sa është numri i të lënduarve / tësëmurëve?**
**Ç´farë lloj lëndimesh / sëmundjesh janë?**

### Numrat e telefonit për raste emergjente

| | |
|---|---|
| ***Urgjenca** | **144** |
| ***Zjarrfikësit** | **122** |
| ***Policia** | **133** |
| **Bashkimi vullnetar (Samariterbund)** | **0732-2124** |
| ***Urgjenca e mjekëve** (vetëm në fundjavë nga ora 7:00 e mëngjesit të së shtunës deri në orën 7:00 të mëngjesit të ditës së parë të punës) | **141** |
| **Urgjenca për raste helmimi** | **01-406 43 43** |
| **Këshilla nëpërmjet linjës telefonike (RataufDraht)** (Konsultë për fëmij dhe të rinj për probleme të çfarëdo lloji) | **147** |
| ***Linja telefonike kundër dhunës ndaj grave** | **0800-222 555** |
| **Urgjenca për gratë e përdhunuara** | **0732-60 22 00** |
| **Urgjenca psiko-sociale** | **0732-65 10 15** |
| **Qendra e ndërhryjes në raste krizash** | **0732-21 77** |
| ***Urgjenca telefonike për probleme shpirtërore** | **142** |

*Nga këto numra telefonohet pa prefiks (kod) dhe gratis nga gjithë Austria! Informacione për spitalet që marrin urgjenca, i gjeni në gazetat akutale ditore ose në faqen e internetit **www.linz.at/akh/1489.asp** entnehmen.

# GRUAJA NË LINZ



# 7 GRUAJA NË LINZ

Zyra e Grave në Linz, përfaqëson intereset e grave të Linzit me qëllim që të avancoj barasinë reale në mes të gjinisë femrore dhe mashkullore, në të gjitha fushat shoqërore. Zyra e krijon dhe përkrah masat kundër diskriminimit të grave (p.sh.: barabarsia në të ardhura, përfaqësimi në funkcionet udhëheqëse, shansat për karierë).

➲ **Linzer Frauenbüro**
Altes Rathaus
Hauptplatz 1, 4041 Linz
Tel.: 0732-7070-1191
frauenbuero@mag.linz.at
www.linz.at/frauen

## Institucione të rëndësishme në Linz për shërbimin e grave

## Qendrat  Konsultimipër Migrantet

➲ **Maiz – autonomes Zentrum von und für Migrantinnen**
Shoqata "Maiz", angazhohet për avancimin ligjor dhe social të migranteve, përmes ofertave të shumta për këshillim dhe arsim.
Qëllimi kryesor është përmirësimi i situates jetësore dhe të punës për migrantet.

Maiz–drejtimi i arsimit: Hofgasse 11, 4020 Linz, Tel.: 0732-89 02 04-3
Maiz–drejtimi i këshillimit:Hofberg 9, 4020 Linz, Tel.: 0732-77 60 70
maiz@servus.at
www.maiz.at

➲ **Migrare – Zentrum für MigrantInnen Oberösterreich**
Spektri i ofertave përveç këshillimeve në shumë gjuhë përmban edhe projekte të shumta dhe oferta për arsimim të njerëzve me prejardhje migrante.

Migrare – Zentrum für MigrantInnen Oberösterreich
Humboldtstraße 49, 4020 Linz
Tel.: 0732-66 73 63
office@migration.at
www.migration.at

➲ **Volkshilfe Oberösterreich – Përkujdesja për migrantët dhe refugjatët (Flüchtlings-und MigrantInnenbetreuung), Frauenzentrum Olympe**
„FrauenzentrumOlympe" ofron masa për shkollim, organizime informative si dhe përkujdesje psikosociale për migrantet.

Volkshilfe Oberösterreich – Flüchtlings- und MigrantInnenbetreuung
Stockhofstraße 40, 4020 Linz
Tel.: 0732-60 30 99
office@volkshilfe-ooe.at
www.volkshilfe-ooe.at

## Lëmia e punës dhe kualifikimit

➲ **VFQ – Gesellschaft für Frauen und Qualifikation mbh**
Qëllimi i VFQ është përmirësimi i situates së grave dhe migranteve në tregun e punës, me këshilla dhe shkollime.

VFQ Gesellschaft für Frauen und Qualifikation mbh.
Fröbelstraße 16, 4020 Linz
Tel.: 0732-65 87 59
office@vfq.at
www.vfq.at

➲ **VSG Woman – Këshillimi për aplikim dhe kualifikim**
VSG Woman ofron këshillim pa pagesë për temat: puna, arsimi, sigurimi social dhe përkrahje individuale për përpunimin e planeve për arsim.

VSG Woman (Shoqata për prevencion social dhe punës në bashkësi)
Martin-Luther-Platz 3/4, 4020 Linz
Tel.: 0732-79 76 2-13
woman@vsg.or.at
www.vsg.or.at

## Shërbimet për mbrojtje nga dhuna

➲ **Gewaltschutzzentrum Oberösterreich**
Qendra për mbrojtjen nga dhuna në Austrinë e Epërme, ofron këshilla të besueshme dhe pa pagesë si dhe mbrojtje për femrat në situatë të dhunës në familje, në rrethin shoqëror si dhe këshillim në rast ndjekje nga një person .

Gewaltschutzzentrum Oberösterreich
Stockhofstraße 40, 4020 Linz
Tel.: 0732-60 77 60
ooe@gewaltschutzzentrum.at
www.gewaltschutzzentrum.at/ooe

- **Linja për ndihmë të grave kundër dhunës:**
  24 orë në ditë këshilla anonime dhe pa pagesë.
  0800/222555 (në gjithë Austrinë pa pagesë)

- **autonomes Frauenzentrum (aFZ)**
  Telefonata të urgjencës për femrat e dhunuara. Informata, këshilla dhe përcjellje në rastet e dhunës seksuale, për gratë dhe vajzat që janë ose kanë qenë të goditura nga dhuna seksuale (dhuna fizike dhe psiqike, ngacmimi seksual, sulmet, detyrimet, keqpërdorimet dhe dhunimi). aFZ ofron ndihmë të menjëhershme telefonike ose personale për femrat dhe nga femrat.

  **autonomes Frauenzentrum**
  Starhembergstraße 10, Ecke Mozartstraße, 2.Stock, 4020 Linz
  Telefon për emergjencë: 0732-60 22 00
  hallo@frauenzentrum.at
  www.frauenzentrum.at

- **Shtëpia e Grave të Linzit (Frauenhaus Linz)**
  Shtëpia për Grave tëLinzit, u ofron grave të keqpërdorura si dhe fëmijëve të tyre ndihmë të menjëhershme dhe joburokratike që përbëhet nga: mbrojtja, banimi, banimi i mbrojtur, ushqim dhe këshilla. Punonjëset në Shtëpinë e Grave i këshillojnë, i shoqërojnëdhe për-krahin në punët administrative, mirëmbajtje dhe të drejtën e kujdestarisë, ndarja si dhe në kërkim të punës dhe banesës.

  Frauenhaus Linz
  Postfach 1084, 4021 Linz
  Tel.: 0732-60 67 00
  office@frauenhaus-linz.at
  www.frauenhaus-linz.at

- **Verein Pia – Ndihmë për viktimat e keqpërdorimit seksual**
  Shoqata PIA ofron prevencion, këshilla dhe terapi për viktimat e keqpërdorimit seksual si dhe për njerzit në rrethin e tyre.

  Verein PIA
  Niederreithstraße 33, 4020 Linz
  Tel.: 0732-65 00 31
  office@pia-linz.at
  www.pia-linz.at

## Kurset e vetëmbrojtjes

Shumë institucione ofrojnëkurse për vetëmbrojtje për gratë dhe femrat. Zyra e Grave në Linz ndërmjetson, përsa i përket ofertave në lidhje me vetëmbrojtjen.

➲ **Frauenbüro der Stadt Linz**
Hauptplatz 1, Altes Rathaus, 4041 Linz
Tel.: 0732-7070-1190
frauenbuero@mag.linz.at
www.linz.at/frauen

## Qendrat e Konsultimit për femrat në prostitucion

Këshillim dhe përkrahje për njerëzit që punojnë ose kanë punuar në prostitucion, ofron Zyra për Këshillim LENA dhe shoqata Maiz – qendra autonome nga dhe për migrantet.

➲ **Beratungsstelle Lena – Caritas**
Steingasse 25, 4020 Linz
Tel.: 0732-77 55 08 - 0
lena@caritas-linz.at

➲ **MAIZ – Autonomes Zentrum von und für Migrantinnen**
Hofberg 9, 4020 Linz,
Tel.: 0732-77 60 70
maiz@servus.at
www.maiz.at

## Institucionet për nënat - fëmijë

Këto ofrojn vende të mbikëqyrura për banim për gratë e vetme shtatzëna si dhe nënat e vetme me femijë.

- **Mutter-Kind-Haus der Stadt Linz**
  Füchselstraße 21-23, 4020 Linz
  Tel.: 0732-60 04 41
  muki@mag.linz.at

- **Haus für Mutter und Kind der Caritas**
  Kapellenstraße 1, 4040 Linz
  Tel.: 0732-73 80 10
  haus.mutter.kind@caritas-linz.at

## Shëndetësia

- **Linzer Frauengesundheitszentrum**
  Këtu mund të merren këshilla, informata dhe ligjerata mbi temën shëndeti i grave si dhe trajtime.

  Linzer Frauengesundheitszentrum
  Kaplanhofstraße 1, 4020 Linz
  Tel.: 0732-77 44 60
  office@fgz-linz.at
  www.fgz-linz.at

# KULTURA NË LINZ



# 8 LINZI (KRYE-) QYTET I KULTURËS

Linzi ndër vite ka ndydhuar nga „Qytet i Çelikut“ në „Qytet të punës dhe të kulturës“. Oferta e kulturës është e shumëllojshme, e larmishme, interesante dhe është e hapur gjithmonë për shumë njerëz. Motoja „Kulturë për të gjithë“. Sinqeriteti dhe toleranca janë në plan të parë.

Në planin e ri, të zhvillimit kulturor për qytetin e Linzit janë formuluar katër udhëzimet politikbërëse për kulturën: **Rritje e mundësive të barabarta – Promovimin e potencialeve –Lehtësim për të rinjtë dhe qyteti të jetë i hapur.** Sinqeriteti dhe toleranca qëndrojnë në rend të parë, kjo nënkupton mundësinë e përfshirjes shumëkulturore, e cila nuk është vetëm mjet i shprehjes e kulturës tradicionale, por përfshin të gjitha fushat e mardhënieve ndërnjerzore. Ardhmëria e kulturës në Linz bazohet në shumëllojshmëri.

**„Kulturë për të gjithë“** ka për qëllim, që t´u ofrojë sa më shumë banorve të qytetit, në ofertën kulturore ti zbulojn dhe përseri ti gjejn interesat e tyre. Vetëdija kulutrore përmes dialogut dhe koperimit në mes kulturave të ndryshme në shoqërinë e qytetit duhet të jetë synim në rritje. Zhvillimi i mëtutjeshëm kualitativ i punës kulturore në pjesë të qytetit, në më tepër se njëzet vjet është në fokus të politikës kulturore të qytetit.

Në vitin 2009 Linzi ishte kryeqytet i kulturës. Në lidhje me këtë ngjarje të madhe, u ndërtuan dhe u rinovuan shumë institucione kulturore. Kështu, Muzeu i të Ardhmes, i njohur si Ars Electronica Center, u zgjerua, Salzamt që nga koha e Perandorisë adaptohet në ateje, shinat e treni për nëMalin e Pöstlingbergut zgjaten deri në sheshin kryesor (Hauptplatz) oseu ndërtua i ri trakti jugor i Muzeumit në Keshjellë (Schlossmuseum).
Në pranverë të 2013-ës u hap Teatri i Ri Muzikor në Volksgarten.

Në arenën botërore Linzi është i njohur përmes shfaqjeve nëBrucknerfest, Klangwolke ose festivali i Ars Electronica( Festival për Kultur, Teknologji dhe Zhvillim). Programe të tjera vjetore janë LINZFEST, Festvali Muzikor në Parkun e Danubit (Donaupark) ose Pflasterspektakel i Linzit, te i cili artistët nga krejt bota tregojnë aftësitë e tyre në qëndrën e qytetit dhe e shëndrrojnë në skenë spektakolare.

Ata ofrojnë një program të pasur kulturor pa pagesë dhe kontribuojnë për qasje në institucionet kulturore të Linzit. Edhe një numër i madh festivalesh dhe organizimesh tjera e pasurojnë jetën kulturore në Linz dhe rrethinat e tij. Linzi promovon „Kulturë për të gjithë“. Sipas mundësive, duhet e gjithë popullata të marë pjesë në ngjarjet kulturore.

**Faqet në vijim, japin një pasqyrë të detajizuar për jetën kulturore në Linz. Institucionet dhe iniciativate prezentuara këtu, janë një pasqyrë e një skene të gjallë arti dhe kulture.**

# Muzeumet

## ➲ Ars Electronica Center – Muzeum i të Ardhmes

Hauptstraße 2-4, 4040 Linz
www.aec.at

I hapur në vitin 1996, Ars Electronica Center, paraqet një prototip të Muzeumit të të Ardhmes. Me format e tij interaktive, realiteti virtual, rrjetit digjital dhe mediave moderne i drejtohet një publiku të gjërë. Formulimi i temave përmes artitmedial, teknologjive të reja dhe zhvillimeve shoqërore formojnë karakterin inovativ të ekspozimeve.

## ➲ Lentos – Muzeu i Artit në Linz

Ernst-Koref-Promenade 1, 4020 Linz
**www.lentos.at**

Si pasardhës i Galerisë së Re, i hapur në vitin 2003, Lentos me koleksionin ndërkombëtar, llogaritet ndër muzeumet më të rëndësishëm të artit modern në Austri. Fondi i muzeut, në lëmin e klasikës moderne, disponon piktura të rëndësishme nga Klimt, Kokoschka, Corinth deri në Pechstein. Përmbledhja përmban rreth 1.500 punime nga lëmia e pikturës skulpturës dhe nga arti i objektit, rreth 10.000 punime në letër dhe 1.200 fotografigrafi, dhe plotsohet vazhdimisht përmes ekspozitave të përkohëshme të pozicioneve aktuale artistike.

## ➲ Nordico – Muze i qytetit të Linzit

Dametzstraße 23, 4020 Linz
**www.nordico.at**

Përmbledhja, ruajtja dhe shqyrtimi i veprave artistike të Linzit llogaritet si detyra kryesore e Nordico. Në fokus të veçantë është përmbledhja e shumë vizatimeve me dorë dhe grafikat e shtypura. Si muze i qytetit, Nordico është një vend i rëndësishëm reprezentativ për artistët bashkëkohorë të Linzit. Ekspozitat në fotografigrafi dhe në arkeologji, janë programet kyçe.

## ➲ LinzGenesis

Altes Rathaus, Hauptplatz 1, 4041 Linz
**www.linzgenesis.at** » LinzGenesis

LinzGenesis, pjesë e Muzeut Nordico, në Bashkinë e vjetër (Altes Rathaus), prezanton historinë e qytetit ndërkohë. Pamja kryesore, e pregatitur me efekte visuale u mundëson vizitorëve një kalim të shpejt dhe informativ nëpër shekuj.

## ➲ Ateljea Salzamt (Zyra e Krypores)

Obere Donaulände 15, 4020 Linz
**www.salzamt-linz.at**

Ateljeja Salzamt, e hapur nga mesi i vitit 2009, është vendtakim i artistëve të rinj nga vendi dhe të huaj. 9 Atelje, pjesërisht edhe me mundësi banimi, janë në disponim. Në sallën e ekspozitave në katin përdhesë, organizohen rregullisht ekspozita ose shfaqje, poashtu edhe në kooperim me institucionet tëtjera kulturore të Linz-it.

## ➲ OK Pallati Publik i Austrisë së Epërme

Dametzstraße 30, 4020 Linz
**www.ok-centrum.at**

O.K. Pallati Publik i Austrisë së Epërme për art bashkëkohor, është një laborator eksperimental në lëmin e artit. Nënkuptohet si shtëpi ekspozitash dhe produkcioni për artin bashkëkohor dhe e percjell realizimin e një pune artistike, nga ideja e gjer te ekspozita. Një gjenerat kryesisht e re internacionale artistësh, ofrojn një platform publike dhe situat laboratoriumi.

## ➲ Landesgalerie Linze Muzeve të Landit të Austrisë së Epërme (OÖ Landesmuseen)

Museumsstraße 14, 4020 Linz
**www.landesgalerie.at**

Landesgalerie krijohet në mesin e shekullit 19, me nxitje nga Adelbert Stifter.Përmbledhja e tij përbëhet nga arti bashkëkohor modern, prej vitit 1900 gjer në ditët e sotshme me fokusim në grafik dhe fotografigrafi artistike. Përtej kufijve të Landit njihet Landesgalerie, përmes përmbledhjes më të madhe në botë të Kubinit. Rregullisht prezantohen ekspozita, të cilat përmbajnë spektrin nga piktura dhe skulptura klasike e deri te instalimet mediale të artistëve të rinj.

## ➲ Schlossmuseum Linz Muzeu i Krahinës së Austrisë së Epërme (OÖ Landesmuseen)

Tummelplatz 10, 4020 Linz
**www.schlossmuseum.at**

Schlossmuseum jep, në forme të gjërë dhe mbresëdhënëse një pasqyrë „universale“ në historinë e natyrës, kulturës dhe artit të Austrisë së Epërme. Me rindërtimin e aksit jugor, i cili u dogj në vitin 1800, të kalasë së Linzit formohet një ansambël i historisë dhe arkitekturës moderne mbi çatitë e qytetit, si muzeumi universal më i madh në Austri. Indarë në 3 kate, në traktin jugor, rregullisht mbahen ekspozita në temën „natyra“ dhe „teknika“.

## Qendra biologjisë (Biologiezentrum)

Johann-Wilhelm-Klein-Straße 73, 4040 Linz
**www.biologiezentrum.at**

Me përmbledhjet e veta të konsiderueshme internacionale, botanike, zoologjike dhe në shkencën e tokës dhe në projektet hulumtuese, Biologiezentrum ka bërë një emër si muze dhe arkiv „klasik, intenacional dhe inovativ" i natyrës.

## afo architekturforum oberösterreich

Prunerstraße 12, 4020 Linz
**www.afo.at**

Forumi i Arkitekëve në Austri të Epërme, me shijet popullore të reja dhe me ndërtesën për prodhim dhe organizim në Prunerstraße, ka një hapësirë rreth 450 metra katërorë, në qendër të Linzit. Forumi i Arkitektëve ofron një debat të gjërë publik për kulturën e ndërtimit dhe e nxit shkëmbimin e informatacioneve  në mes të gjithë atyre që janë të interesuar në lëmin e ndërtimit. Si platform komunikimi, ai ndikon në gjallërimin e rrethit të arkitektëve. Ateljet u ofrojn hapësira që të krijojnë projekte, të cilat u përshtaten situatave në terren dhe paraqesin qasjet eksperimentale për të ardhmen.

## forum metall

Linz Kultur, Pfarrgasse 7, 4041 Linz

Me një „bum artistik", në vitin 1977, Linzi dëgjohet jashtë kufijve të Austrisë. Forumi Metall prezantoi nëParkun e Danubit, në kohën e hapjes së "Brucknerfestës" së katërt, Metalin Plastik bashkëkohor, në një  format të madh nga artistë të njohur botëror. Një pjesë e madhe e plastikave, dominojnë pamjen e Parkut të Danubitndërmjet Muzeut Lentos dhe Urës së Metalt edhe sot e kësaj dite.

## voestalpine Stahlwelt–Përjetimi i Voest-alpines

voestalpine-Straße 4 , 4020 Linz
**www.voestalpine.com/stahlwelt**

Zhvillimet e materialit të çelikut në ditët e sotme tregojnëdomosdoshmërinë e përdorimit nga  njerëzit në gjithë botën. Ato mundësojnë vegla të reja, makina dhe ndërtesa të cilat e lehtësojnë jetën dhe lidhin kontinente, shtete dhe njerëz. Mirëpo mundësit dhe fushat ku mund të përdoren produkte me cilësi të lartë nga çeliku, ende nuk janë shterurar. Voestalpine Stahlwelt është vend i takimeve, në të cilin njerëzit njihenme materialin e çelikut dhe kompaninë voestalpine në mënyrë multimediale.

Informacione, detaje në lidhje me galeritë, muzeumet dhe ekspozitat i gjeni në adresën:
**www.linz.at/galerien.asp** ose **www.linz.at/kultur/2128.asp**

# Vallëzim dhe Teatër

## ➲ Teatri i Krahinës në Linz (Landestheater Linz–Schauspielhaus)

Promenade 39, 4020 Linz
**www.landestheater-linz.at**

Prej, gati 200 vjet, Landestheater në Linz e zbukuron jetën teatrore në Austrinë e Epërme. Në skenën e Sallëssë Madhe në Promenade dhe në Dhomën e Shfaqjeve (Kammerspiele) në Teatri i Austrisë së Epërme, ka një repertor të gjërë të teatrit folës.

## ➲ Theater Phönix

Wiener Straße 25, 4020 Linz
**www.theater-phoenix.at**

Kush preferon teatrin e qetë dhe jokonvencional, gjen në teatrin Phönix në Wiener Straße vepra klasike dhe tekste të guximshme bashkëkohore.

## ➲ Teatri në qendër të qytetit (TheaterinderInnenstadt)

Museumstraße 7a, 4020 Linz
**www.theater-innenstadt.at**

Me teatrin në qendër të qytetit, një shtëpi elarmishme që i ndryshon ngjyrat e veta me mjuzikel, artë të vogël, mbrëmje kocertore dhe variete (ka 100 karrike me tavolina).

## ➲ Kellertheater në Linz–Komedia në Sheshin kryesor (Hauptplatz)

Hauptplatz 21, 4020 Linz
**www.linzerkellertheater.at**

Fillimisht i themeluar si skenë për kolektivin e “Bashkësisë Austriake për Hekur dhe Çelik”, Kellertheater gjatë ekzistencës të tij 55 – vjeçare, ka realizuar përmbi 200 pjesë teatrale. Përveç kësaj çdo vit, ka sëpaku një shfaqje tregim, për publikun më të ri.

c Informacione më të hollësishme me temën “Vallëzim dhe Teatër” mund të gjeni në adresën: **www.linz.at/kultur/2120.asp**

# Muzika

## ➲ Brucknerhaus

Untere Donaulände 7, 4020 Linz
**www.brucknerhaus.at**

Brucknerhaus pranë Danubit – prej vitit 1974, është si shenjë kulturore dhe arkitekturore e Linzit – Është ndërtesa e koncerteve në Austri të Epërme. Ajo ofron koncerte të orkestrave të famshme, siç është edhe Brucknerorchester në Linz, me repertore, solistët dhe dirigjentë botëror, si dhe me program të vetin për fëmijë. Brucknerhaus perveç tradicionalitet që ruan përkujdeset edhe për muzikën e llojeve të ndryshme bashkëkohore. Programe të njohura çdo vit janë Linzer Klangwolke dhe Brucknerfest në Linz.

## ➲ Posthof – Kultura e kohës në Liman

Posthofstraße 43, 4020 Linz
**www.posthof.at**

Ndërtesa e Kulturës Posthof në Linz ofron në vit rreth 250 shfaqje vetëm në muzik, vallëzim, teatër, art të vogël dhe literatur. Posthofi është në të njëjtën masë pikë terheqëse për artistë të njohur internacional, sa edhe për prezantimin e skenës vendore për të rinjë. Në fillim ishte një fermë, pastaj areali i vendosur në afërsi të portit, në vitin 1984 dhe 1990 adaptohet, dhe sot është njeri nga vendet më virtale dhe me të mëdha për shfaqje të kulturës bashkëkohore në Austri. Festivalet vjetore në kalendarin e shfaqjeve janë: lojra vendore, ditë të vallëzimit, Festivali i Humorit të Zi, Festivali i Artit të Vogël.

## ➲ Shkolla e Muzikës në Qytetin e Linzit

Fabrikstraße 10, 4041 Linz
**www.linz.at/musikschule**

Shkolla e muzikës në Linz ofron mësim për muzik, për fëmijt nga mosha 2 – vjeçare. Përveç mësimit në 50 instrumente dhe drejtimetvokale, bëhet muzik në orkestrat dhe ansamblet e shumta.

**Projekti „Musikalischer Südwind“**
Qëllimi i këtij projekti është që të largojë barrierat për afimin në Shkollën e Muzikës dhe instrumentave, dhe për të vendosur impulse muzikore në Shkollat fillore në zonat e ndryshme të Qytetit Linz-Qendër dhe Linz-Jug. Gjithashtu përkrah dhe talentët, të cilët ndoshta nuk do ta shfrytzonin mundësin për të hyrë në Shkollën e Muzikës. Në afat mesatar duhet që, shkollat kryesisht instrumentale të jenë të shpërndara në të gjithë qytetin, që të mundësohet pjesmarrja e nxënësve, pa marrë parasysh nga cila pjesë e qytetit vijnë nxënësit (Linz- Veri ose Linz-jug), të jetë mesatarisht e njejtë.
Katër shtyllat mbështetëse të projektit „Musikalischer Südwind“ janë:

- Një kurs bazë në kuadër të mësimit në shkollën fillore në klasën e parë (Turnussystem)
- Pjesëmarrja në mësimin e leximittë notave dhe të ritmit të ofrohet nga Shkolla e Muzikës, si mësim plotësues në shkollën fillore nga klasa e dytë.

- Përfshirja në organizimin e „Musikschule goes Brucknerhaus“ në klasën e dytë në Brucknerhaus Linz
- Pjesëmarrja në grupin instrumental, si ofertë plotësuese të Shkollës së Muzikës në Linz, nga klasa e tretë në shkollën fillore me drejtim kryesor instrumental ose në një shkollë të afërt muzikore në atë zonë të qytetit

## ➲ Landestheater Linz – Teatri Muzikor nëVolksgarten

Am Volksgarten 1, 4020 Linz
**www.musiktheater-linz.at**

Teatri Muzikori Operas dhe i Baletit i cili ofron opereta e musikal, ka gjetur në vitin 2013-të në Musiktheater në Volksgartennjë vend modern europian. Ndërtesa kulturore ka katër salla për çfaqje si: Salla e madhe, FoyerBühne, BlackBox dhe BlackBox Lounge. Në BlackBox dhe në BlackBox Loungeçfaqjen edhe produksione muzikore artistike.

## ➲ Bruckner Orchester Linz

**www.bruckner-orchester.at**

Bruckner Orkester në Linz, është zhvilluar si një nga orkestrat kryesore në Europën Qendrore. Bruckner Orkester dëshmon debutimin e saj si orkestër operash në Landestheater Linz, në shumë koncerte në Austri, jashtë Austrisë si dhe gjatë festave të ndryshme. Shumë festa si ajo „Klangwolke“ në kuadër të Brucknerfest-ës, i ka përgatitur në aspektin muzikor Bruckner Orkester. Dirigjenti Dennis Russell Davies është një garant për zhvillimin e mëtejshëm artistik të orkestrës.

## ➲ Musica Sacra

**www.musicasacra.at**

Kjo orkestër mban koncerte në kishat e ndryshme, Alte dhe Neue Dom, në Minoritenkirche, Ursulinenkirche, Martinskirche, Stadt- pfarrkirche, Priesterseminarkirche dhe te Basilika në Pöstlingberg. Programet orientohen në karakteristikat e hapësirës dhe përmbajnë gjatë shekujve deri në ditët e sotme, muzikën europiane.

## ➲ TipsArena

Ziegeleistraße 76-78, 4020 Linz
**www.liva.at**

Në sallën e sportit dhe koncerteve afër stadionit në Froschberg mbahen rregullisht koncerte komerciale.

Informacione tjera për temën „muzika“ gjenden në adresë: **www.linz.at/kultur/2132.asp**.

# Festivalet / Shfaqjet

## ➲ Festivali Ars Electronica për art, teknologji dhe shoqëri

**www.aec.at**

Interdisciplinariteti dhe takimi i hapur i eksperteve në lëmin e artit dhe shkencës me një publik të gjërë dhe të interesuar, e karakterizojnë Festivalin Internacional Ars Electronica. Prej vitit 1979 ky festival i përkushtohet çdo vit simpoziumeve, ekspozitave, performancave dhe ngjarjeve më të debatuara për fenomenet e artit dhe shkencës, qëshkaktojnë ndryshimet teknologjike.

## ➲ Brucknerfest Linz

**www.brucknerhaus.at**

Me hapjen e Brucknerhaus në vitin 1974, formohet një Festival Muzikor, i cili ka kohë që nuk kufizohet vetëm me trashëgimin e Anton Bruckner-it. Koncerte orkestrale, mbrëmje koncertore, muzik kamerciale, teatër vallëzimi, koncert me organo, opera etj. Në Brucknerfest organizohet cdo vit në shtator/tetor dhe zgjatë tre javë. Në Linz vijnë mysafir nga bota muzikore internacionale. Brucknerfest në Linz tradicionalisht hapet dhe mbyllet me Linzer Klangwolken Klasike dhe me këte në mënyrë të shkëlqyer përfundon sezoni i Festivaleve në Austri.

## ➲ Linzer Klangwolken

**www.klangwolke.at**

Çdo vit mbahen 3 Klangwolke në Parkun e Danubit në Linz.Klangwolke visuale, e cila çdo vit me muzik, drita, laser dhe fishekzjarre ka një rimodelim të ri. Për vizitorët më të rinj inskenohet Klangwolkepër fëmij.Klangwolke klasike transmeton koncertin e hapjes së Brucknerfest në Donaupark (Parku pranë Danubit)

## ➲ Festivali i Artit të Rrugës në Linz – InternationalesStraßenkunstfestiva

**www.pflasterspektakel.at**

Si pikë e rëndësishme në verën kulturore të Linz-it, çdo vitnë korrik, organizohet Pflasterspektakel. Si festvali më i madh në Europë i Artit të Rrugës, ai prezentohet si organizim tradicional i një variacioni nga objekti dhe impro-teatri, muzika e të gjitha arteve, poezia, vallëzimi artistik, cirku akrobatik në litar dhe me zjarr, piktura, klounet dhe arti komediant në nivelin më të lart Ë.

## ➲ LINZFEST

**www.linzfest.at**

LINZFESTështë një FestivalOpenAir(në qiell të hapur) i qytetit, i cili nënkupton një inskenim të përbashkët për një temë e cila ndryshon çdo vit. Kjo temë u ofrohet vizitorëve, në hapsirat publike përmes koncerteve Live, teatrit, vallëzimit, komedisë, artit, kuzhinës, literaturës, Eventit dhe picknickut.

## ➲ Koncerti veror, Open-Air në Pavjonin e Muzikës në Donaupark

**www.linz.at/musikpavillon**

Popullaritin më të madh, me tifozët e Pop-it,Jazz-it dhe muzikës me instrumente frymore, ka pavijoni i muzikës në Donaupark. Sidomos talentët e rinj muzikor nga Linzi dhe Austria e Epërme në muajt e verës e kanë mundësinë që ta tregojnë veten në këto koncerte.

## ➲ Festivali 4020. Më shumë se muzik

**www.festival4020.at**

Festivali 4020, u prezantua per herë të parë në mars të2001. Pas pagëzimit, si një pasuri me kom-ponist të rinj, muzikant dhe ansamble nga një vende joeuropjane mbajnë çfaqje në hapsirat e shpërn-dara në të gjithë qytetin.Me kënaqësinë, virtualitetin, dhe angazhimin e tyre, muzikantët paraqesin një panoramë të larmishme të muzikës popullore, koncertale, bashkëkohore dhe të së kaluarës sic kanë dalë: a capella, koncerte ose muzikëelektronike të cilat të shtyjnë tu përkushtohesh. Festivali mbahet çdo dy vjet.

## ➲ Ahoi! Pop. Muzika bashkohore në Liman (Hafen)

**www.posthof.at**

Linzi në dekadat e fundit ka qenë gjithmonë një pikë e rëndësishme kristalizimi për drejtimet e reja në muzik. Muzika bashkëkohore si Rock, Hardcore, Indie-Pop, HipHop dhe Elektro janë kontrolluar, reflektuar dhe janë interpretuar në mënyrë të re dhe janë pranuar shumë mirë në Linz. Festivali muzikor duhet tu ofroj vizitorëve një fragment me artistëtëshumë zhanreve.

## ➲ Festivali i Filmit CROSSING EUROPE

**www.crossingEurope.at**

Festivali i filmit CROSSING EUROPE është një forum për diversitetin kinematografik Europian dhe ju ofron podiume, parasegjithash regjisorëve të rinj dhe inovativ. Pjesët bazë të festivalit janë kon-kurueset në nivel Europian në të cilin janë të lejuar filmat e parë dhe të dytë me metrazh të gjatë, si dhe panorama, autobiografi nga artist lokal dhe specialist.

## ➲ Brass Festival Linz

**www.brucknerhaus.at**

Ky festival mbahet në Linz nga ansamble të vogla me instrumente frymorë deri në bandat e mëdha, nga konkurimi në bass – band deri në instrumentalistët humoristë, si dhe një ekspozitë në Brucknerhaus. Gjatë 3 ditëve të festivalit në Linz gjithçka sillet rreth temës “Fletë Metalike”.

## ➲ Serenatat në Arkadenhof (Në Landahus)

**www.brucknerhaus.at**

Këto  serenata kanë traditën më të gjatë në programin veror të Brucknerhaus-it. Serenatat në oborret historike të Landhausit të Linz-it. Çdo të martë në mbrëmje, gjatë muajve korrik/gusht për 9 herë, vizitorët i pret  një program i zgjedhur nga ansamblet internacionale.

## ➲ Vera në Rosengarten

**www.brucknerhaus.at**

Vendimëi bukur i lojrave, mbi çatitë e Linzit dhe një ndër vendet më atraktive të lojrave veroreështë. Ambjentet me mbi 3000 m2, me skenë në „për kohën e kulturës“, nga qershori deri në gusht, ofrojnë një larmi nga teatri, muzika dhe programet me muzikë kabare.

## ➲ NEXTCOMIC

**www.nextcomic.org**

Në vitin 2009, në kuadër të  Linz09, u mundësua mbajtja e Festivalit. Jehona e mirë internacionale dhe zërat pozitiv të artistëve dhe vizitorëve i inkurajuan iniciatorët në krye me Gottfried Gusenbauer, që këte format ta zhvillonin mëtutje.Me NEXTCOMIC, Austria ka tanimë një platform për vizatime komike dhe të letërsisë me fotografigrafi. Festivali NEXTCOMIC është unik në Austri. Ai paraqet, lidhjen e vizatimeve komike me artin visual, karakterin e dizajnit, arkitekturën, filmin dhe filmin vizatimor.

## ➲ sicht:wechsel

**www.sicht-wechsel.at**

Metitullin sicht:wechsel, u mbajt, përherë të parë në Linz në vitin 2007. Një festival i madh kulturor internacional, i cili artin dhe estetikën e njerëzve me aftësi të kufizuara ua paraqet një publiku të gjërë. Kështu ata afrohen me  shoqërinë dhe e përjetojnë vëmendjen dhe respektin e tyre,i cili u takon, dhe të cilin ata e meritojnë. Skena zakonisht shihet rrallë, me teater, muzik dhe art, kështu ajo sillet në qendër të vëmendjes.

# Bibliotekat / Arkivet / Letërsia / Zgjerimi i njohurive

## ➲ Wissensturm

Kärntnerstraße 26, 4020 Linz
**www.wissensturm.at**

Me hapjen e Wissensturm në vitin 2007, në pjesën e qytetit – te stacioni hekurudhorë, u vendos në te biblioteka qëndrore e qytetit si dhe Volkshochschule. Përveç bibliotekës dhe zyrës për shërbim të qytetarëve (Bürgerservice) si dhe Volkshochschul-Seminare, këtu mbahen edhe shumë çfaqje kulturore.

## ➲ Biblioteka e qytetit në Linz

**www.linz.at/bildung/stadtbibliothek.asp**

Me një rrjetë të dendur të degëve, biblioteka e qytetit i nxit jovetëm me lexim të gjitha gjeneratat. Poashtu edhe CD-të, CD-ROM, videot, DVD presin huamarrësit e tyre. Perveç asaj qendrore në Wissensturm, janë edhe 10 biblioteka të tjera të shpërndara në të gjithë qytetin.
Adresat e bibliotekave tjera të qytetit mund ti gjeni në kapitullin „Linzi prezentohet“<< Bürgerservice und Verwaltung >> Bürgerservice im Stadteil

## ➲ Kepler Salon

Rathausgasse 5, 4020 Linz
**www.kepler-salon.at**

KeplerSalon,mbetet pas vitit 2009 kur Linzi ishte kryeqyteti i kulturës Evropiane, një vend i takimeve dhe infomracioneve. Përgjegjësit merren me temat nga spektri i përgjithshëm i hulumtimeve të ofrimit të njohurive bashkëkohore dhe e mundësojnë dialogun e ekspertëve.

## ➲ Biblioteka e Landit të Austrisë së Epërme

Schillerplatz 2, 4020 Linz
**www.landesbibliothek.at**

Biblioteka e Landit të Austrisë së Epërme është një bibliotekë shkencore universitare, e cila fuqishëm i përkushtohet përmbledhjes së literaturës, për dhe mbi Austrinë e Epërme. Ndërtesa e Biblotekës në Schillerplatz menaxhon momentalisht 375.000 libra dhe shfrytëzohet si bibliotekë huazimi dhe referimi.

## ➲ Universitätsbibliothek der Johannes Kepler Universität Linz

Altenbergerstraße 69, 4040 Linz
**www.ubl.jku.at**

Përmbledhja kyçe, e bibliotekës së formuar në vitin 1965 në Universitetin Kepler në Linz, është në drejtimet e studimeve në Universite dhe ate: shkencat shoqërore, ekonomike, drejtësia, shkencat natyrore dhe teknika.

## ➲ Arkivi i qytetit të Linzit

Neues Rathaus, Hauptstraße 1-5, 4041 Linz
**www.linz.at/archiv**

Arkivi i qytetit të Linzit përmban materiale të historisë së qytetit, përmbledhjes së kohës, si dhe literaturë të gjërë për kultur, shoqëri, ekonomi dhe histori të kohës. Këto mund të shihen në Sallën e leximit gjatë orarit të punës së Bashkisë.

## ➲ Arkivi i Landit të Austrisë së Epërme

Anzengruberstraße 19, 4020 Linz
**www.landesarchiv-ooe.at**

Si qendër e hulumtimit të historisë së Krahinës dhe arkivit qëndror të Krahinës ruan dhe kujdeset për, mbi 27.000 metër gjatësi të arkivave, kryesisht dokumente, dorëshkrime të lidhura dhe përmbledhje aktesh.

## ➲ StifterHaus

Adalbert-Stifter-Platz 1, 4020 Linz
**www.stifter-haus.at**

„StifterHaus“ në lokalet e shtëpisë së banimit të poetit Adalbert Stifter (1805 – 1868), që nga vitit 1950 Instituti Adalbert Stifter bashkon studimin për literaturë dhe shkencën për gjuhë, kurse prej vitit 1992 Shtëpi Letrare e Austrisë së Epërme si dhe vend i shfaqjeve.

## ➲ Facetten

**www.linz.at/kultur/facetten.asp**

Të gjithë autorët e Austrisë së Epërme çdo vit ftohen në një tender, që shkrimet e tyre ti dorëzojnë në qytetin e Linzit. Juria zgjedh nga ato shkrime rreth 25 tekste dhe nga këto bëhet një libër letërsie vjetore me rreth 200 faqe.

## ➲ Die Rampe

**www.ooe.gv.at**

Gazeta leterare e Austrisë së Epërme për promovimin e letërsisë bashkëkohore që formohet në vitin 1975. Zgjedhjen e teksteve e bëjnë grupet e pavarura të redaksionit.
Informacione të mëtejshme për bibliotekat, letërsin dhe arkivin e qytetit janë në adresën:
**www.linz.at/bildung/6552.asp** und **www.linz.at/kultur/2116.asp**

# Kultura e fëmijve dhe e të rinjve

## ➲ Qendra e Kulturës së Fëmijve, Kuddelmuddel

Langgasse 13, 4020 Linz
**www.kuddelmuddel.at / www.theater-des-kindes.at / www.puppentheater.at**

Kulturës së të rinjve dhe të fëmijëve në Linz i kushtohet kujdes i veçantë. Për këtë, në vitin 1990 hapet shtëpia e veçantë e kulturës. Në Langgasse, në Kolpingkinon e mëparshme, ekziston deri më sot Teatri i Kukullave të Linzit dhe Teatri i Fëmijve me një ofertë kulturore për publikun më të ri. Perveç kësaj Qendra e Kulturës për Fëmij kujdeset për punishten e muzikës (Musikwerkstatt) në Brucknerhaus dhe për Kinderklangwolke.

## ➲ Java e kulturës së fëmijëve në Linz

**www.kinderkulturwoche.linz.at**

Përmes një numri të madh të shfaqjeve, pjesëve teatrale, vizitave në muzeume, workshope dhe mundësit për pjesëmarrje, vizitorët i pret një program i shumllojshëm mbrenda një jave nëvjeshtë. Java kulturore e fëmijve në Linz, tregon se sa e shumëllojshme dhe e shumëngjyrëshme është oferta për publikun e ri.Startin e kanë ditët e librit për fëmijë dhe të rinj të Bibliotekës së Qytetit.

## ➲ Landestheater Linz – u\hof: Teatër për publikun e ri

Landstraße 31, 4020 Linz
**www.landestheater-linz.at**

u\hof: Teatër për të rinj në Kulturquartier OÖ
Për produksione të rregullta për fëmij dhe të rinj,kujdeset Landestheater për publikun e ri.

## ➲ SCHÄXPIR – Festivali internacional i teatrave në Austri të Epërme

**www.schaexpir.at**

SCHÄXPIR vendos impulse në peisazhin teatror, sidomos në kulturën për fëmijt dhe të rinjtë austriak. Prej premierave, shfaqjeve gjermane, premierave austriake dhe një programi të gjërë gjatë festivalit SCHÄXPIR, Linzi është në qendër të teatrit Europian për publikun e ri.

## ➲ Festival for Children´s Rights – Paradë për fëmij

**www.kidsparade.net**

„Festival for Children‘s Rights“ është një Forum për të Drejtat e Fëmijve dhe si platform e hapur, parasegjithash për fëmij dhe të rinj.Parada për fëmij e realizon këtë në mënyrë simbolike dhe shembullore si festë për fëmij, në të cilën fëmijët shfrytëzojnë të drejtën për mendim dhe tubim të lirë, përmes aktiviteteve artistike dhe kulturore si dhe organizimin e jetës që i përshtatet moshës së tyre.

### ➲ Qendrat (kulturore) për të rinj

**www.vjf.at**

Pika kontakti për më të „rriturit“ janë qendrat për të rinj të Shoqatës të Rinjtë dhe koha e lirë. Qendra Kulturore Hof ofron program kulturor, prezantim të grupeve të reja, lexime, ligjerata dhe ekspozita deri në kabare dhe shfaqje teatrore. Shtëpia në fund të Kapuzinerberg, e quajtur Kapu, është një pikë tjetër takimi për të rinjtë, dhe në fundin e viteve 1980 ka qenë një kala e skenës vendore dhe internacionale të muzikës rrok.

## Art i lirë-dhe skena kulturore

Një anëspecifike e Linzit, në krahasim me qytetet dhe krahinat e tjera, është shumëllojshmëria e theksuar dhe potenciali artistik e të ashtuquajturës skena e lirë.Këtu bëhet fjalë për pajisje, organizata, iniciativa, shoqeri dhe shoqata, bartës dhe pronar të të cilave nuk janë autoritetet – konfederata, landi ose qyteti - dhe janë të orjentuar si bamirës vullnetar së bashku me të gjithë artistët dhe punëtorët kulturor. Qyteti i Linziti pranon detyrimet si Qytet i Kulturës për të gjithë, në aspektin kulturopolitik në lëmin e barazisë së gjinive, shumllojshmëria, arti në hapsirën publike, internacionaliteti, si dhe përkrahja e artit të lirë dhe skenës kulturore. Pikërisht skena e lirë e fortë me iniciativa kulturore dhe me artist, sjell impulse të rëndësishme dhe inovacione për zhvillime të reja në kultur. Për shkak të dinamikës së zhvillimit, nuk është e mundur një listë e sakt.Gjithashtu duhet të theksohet se në Linz ekzistojnë shumë iniciativa në pjesët e qytetit, si dhe shoqata të kulturave popullore, të cilat e ndihmojnë dhe e ndikojnë jetën kulturore dhe interkulturore në pjesë të qytetit dhe në grupet e ndryshme etnike.

**DisaInternetadresa të Iniciativave kulturore dhe artistike:**

Backlab Collective, Linz // www.backlab.at
bb15 – Hapsira për art bashkëkohor // www.bb15.at
Die Fabrikanten // www.fabrikanten.at
Fruchtgenuss – Shoqata për çështje të vendevetë lira // www.fruchtgenuss.org
IFEK – Instituti përart të avancuar // www.ifek.at
Shoqat kulturore KAPU // www.kapu.or.at
Shoqat kulturore Peligro – Art & Music Culture // www.peligro.at
KunstRaum Goethestrasse xtd // www.kunstraum.at
KV One Culture // www.kvoneculture.wordpress.com
qujOchÖ // www.qujochoe.org
Social Impact Aktionsgemeinschaft // www.social-impact.at
Stadtwerkstatt // www.stadtwerkstatt.at
Time’s Up // www.timesup.org
Dorf TV – TV e krijuar nga përdoruesit për Austri të epërme // www.dorftv.at
junQ.at – Kultur- und Medienplattform // www.junQ.at
Radio FRO 105,0 MHz – Radio e lirë e Qytetit të linzit // www.fro.at
servus.at – virtual and physical access for artists and cultural producers // www.servus.at
aFz – Qendra autonome e grave // www.frauenzentrum.at
FIFTITU% – Zyrë ndërlidhse për femrat në art dhe kultur në Austri të epërme // www.fiftitu.at
KUPF – Platforma kulturore e Austrisë së epërme // www.kupf.at

**Iniciativat kulturore me temë kryesore, interkulturalitetin:**

Arcobaleno – Shoqata për takime // www.arcobaleno.info
ibuk – Shoqata për takime interkulturore dhe ndërmjetsim të kulturës // www.ibuk.at
maiz – Qendra Autonome nga&përMigrantet/ët // www.maiz.at
PANGEA – Punëtori mediale interkulturore // www.pangea.at

Informacione të hollësishme për temën „FreieSzene“ mund të gjeni në **www.linz.at/kultur/2112.asp**.

## Migracioni dhe Kultura

Me fillim të vitit 2013 Linzi numëronte 193.486 banor me vendbanim kryesor.Prej të cilëve ishin 32.930 **me prejardhje të huaj** nga gjithsejt 148 nacione, të paraqitur me vendbanim të përhershëm në Linz. Kjo do të thotë 17 përqind nga popullsia e përgjithshme. Sipas Statistik Austria, 25 përqind të popullsisë së përgjithshme kan prejardhje migrante.

Integrimi gjithmonë në rritje i numrit të njerëzve me prejardhje të huaj është njëra nga sfidat dhe dhe shansete mëdha për jetën në qytet. Qyteti i Linzit angazhohet sidomos për përkrahjen dhe mbulimin e nevojave kulturore të të gjithë njerëzve që jetojn në Linz.

Për këte plani i ri kulturor i qytetit të Linzit ka për qëllim përjetimin e interkulturalitetit. Një prej masave në këtë drejtim është intesifikimi i dialogut, partneritetit dhe koperimit në mes të organeve të qytetit dhe shoqatave, iniciativave dhe institucioneve interkulturore.

Këmbimi kulturor në mes të imigrantëve dhe vendasve është masë kryesore e punës integrative në Linz. Për këte Këshilli i qytetit në mbledhjen e mbajtur më 18 Tetor 2012 vendosi me shumicë votash për konceptin „Linzer Interkulturalität“. Ideja që qëndron pas kësaj është që aktivitetet kulturore në përgjithësi mos të jen vetëm për një publik të caktuar, por të jet shprehje e shumicës dhe pakicës në shoqëri. Vendimtare në këtë rast është që këmbimi të jetë reciprok, i cili përmban njohje reciproke dhe shpie në përbashkësi, por dhe ndryshimet kulturore që jan nga prejardhja të jen të dukshme.

### ➲ Wissensturm Linz – Vendtakim dhe Qendër integrimi

Volkshochschule, Stadtbibliothek
Kärntnerstraße 26, 4020 Linz
**www.wissensturm.at**

Shumë media, biblioteka e gjuhëve të huaja e bibliotekës së qytetit të Linzit, si dhe kurse, ligjerata dhe diskusione të Volkshochschule merren me temën „Integration“. Drejtimi profesional organizon kurse dhe provime të gjuhës Gjermane. Më tej Lernzentrum LeWis dhe Medienwekrstatt (Radio dhe TV të bëra vetë)japin oferta speciale dhe të përgjithshme në këtë temë.

### ➲ „Stadt der Kulturen“ – Qyteti i kulturave

Çmimet për përkrahjen e interkurtularietetit në qytetitn e Linzit
**www.stadtderkulturen.at**

Si përkrahje financiare për partneritetin, dialogun dhe koperimin interkulturor si dhe njohje të projekteve interkulturore dhe projekteve nga institucionet pedagogjike, jep qyteti i Linzit për çdo vjitçmimin „Stadt der Kulturen“.

### ➲ Çmimi për integrim i qytetit të Linzit (Integrationspreis der Stadt Linz)

**http://integration.linz.at**

Çmimi për integrim i qytetit të Linzit është njohje dhe vlerësim i angazhimit të personave, iniciativave dhe projekteve që u ndahen personave të cilët në jetën e përditëshme angazhohen për integrim dhe baraznëe qytetarëve dhe japin kontribut për bashkëjetesën në Linz, si dhe për njohje reciproke të kulturave dhe tregojn përparsitëe shumëllojshmërisë. Shembuj pozitiv të punës integrative duhet të theksohen dhe të jenë shembull për të tjerët.

### ➲ Etja për Art dhe Kultur

Kulturpasspër njerëzit me të hyra të ulta
**www.hungeraufkunstundkultur.at**

Pas Vienës, Salzburgut dhe Gracit, në vitin 2007 starton edhe në Austri të Epërme aksioni „Etja për Art dhe Kulturë“. Organizatat e Austrisë së Epërme përbehet nga mbi 60 iniciativa kulturore dhe mbi 90 institucione sociale.
Ky aksion duhet ti shërbej, parasegjithash atyre që deshirojn të marrin pjesë në jetën kulturore por nuk kanë mundësi, siç jane: njerzit që jetojn me ndihmë sociale ose me pension minimal, të papunët dhe refugjatët.

Informata më të hollësishmenë lidhje me temën „Migracioni dhe Kultura“ mund të gjeni në adresën:
**www.linz.at/kultur/44769.asp**

## Vendorganizime të tjera në Linz

### ➲ Pallatet e kulturës në Linz (Volkshäuser)

**www.linz.at/raum**

Pallatet e kulturës në Linz janë pika kristalizuese të kulturës në pjesë të qytetit. Me strukturën e tyre të shumllojshme, ato janë në disponim të banorëve të Linzit për festa, ligjerata, mbrëmje me koncerte, organizime kulturore dhe për ngjarje tjera të shumllojshme. Ato ofrojn hapësirë për shoqatat kulturore, pastaj edhe oferta për bibliotekat e qytetit, shkollën e muzikës dhe shkollën për të rritur (Volkshochschule) në Linz. **Pallatet e kulturës të qytetit të Linzit jan lokalitete shumë të kërkuara, për këte caktimi i një orari të nevojshëm është i domosdoshëm!**

## ➲ Qendra për arsim Jägermayrhof e Dhomës së punëtorve (Arbeiterkammer)

**www.arbeiterkammer.com**

Jägermayrhof është një qendër për arsim, mbledhje, konferenca dhe kulturë. Kjo ka për detyrë: zhvillimin, planifikimin, organizimin dhe zbatimin e ofertave të porositura në arsim dhe kulturë për të punësuarit dhe përfaqsuesit e tyre në Austri të Epërme. Në art dhe kulturë, gjurmohen ngjarjet dhe zhvillimet, dhe atyre u jepet shprehje artistike.

## ➲ Design Center Linz

**www.design-center.at**

Me Design Center, qyteti jep një shenjë të dukshme arkitektonike në Sheshin ie Europës (Europaplatz). Ndërtesa është vend i panaireve, ekspozitave, kongreseve, prezantimit të produkteve, mbledhjeve , seminareve për kulturë, ekonomi dhe shkencë.

## ➲ Sheshi kulturor – OÖ. Kulturquartier –

OK Platz 1, 4020 Linz

**www.ooekulturquartier.at**

Në zemrën e Linzit është formuar një shesh kulturor: Sheshi kulturor i Austrisë së Epërme është një urë lidhse në mes të Qëndrës kulturore (Landeskulturzentrum) Ursulinenhof dhe shtëpisë së kulturave(Offenes Kulturhaus). Është një hapësirë për të gjith të interesuarit për eksperimente të kulturës regionale dhe artit internacional si dhe pjesë më interesante të festivaleve. Vizitorëve u ofrohen hapësira të reja të përjetimit. Lokalet e shumëta të gastronomisë e plotësojn ofertën.

## ➲ Shtëpia e Kulturës Reiman

**www.reiman.at**

Kjo shtëpi e kulturës përmban një teatër, një podium për koncert, shumë dhoma mesimi, dhe një Cafe-Bar. Në vit mbahen rreth 100 organizime. Në fokus janë, parasegjithash, koncertet, sidomos në lëmin e instrumenteve me tela, teater, opera, vallëzim, art i vogël dhe skena për të rinj.

## ➲ Qendra e Kulturës Hof

**www.kulturzentrum-hof.at**

Qendra e kulturës Hof, e themeluar në vitin 1985, ofron një program kulturor që përkrahet dhe prezentohet nga të rinjt, përmes leximeve, ligjëratave dhe ekspozitave e deri te kabaret-i dhe shfaqjet teatrore. Kjo qendër e kulturës, shpesh fton në Workshop-e të muzikës, vallëzimit ose teatrit.

Informata të tjera në lidhje me „Vendorganizimet tjera në Linz“ gjenden në adresën:
**http://www.linz.at/kultur/63565.asp**.

# SPORTI DHE KOHA E LIRË NË LINZ



# 9 SPORTI DHE KOHA E LIRË NË LINZ

Në Linz gjejnë të gjitha gjeneratat mundësi atraktive të sportit dhe shfrytëzimit të kohës së lirë. Oferta është e mjaftueshme nga parqet moderne, pishinat e hapura dhe të mbyllura, objektet e saunave e deri te liqenet për frekuentim publik. Gjithashtu ekzistojnë mbi 500 objekte sportive dhe për kohën e lirë.

## LIVA – Partner i rëndësishëm për sport

Ziegeleistraße 76-78
Tel.: 0732-65 73 11-4002

Njëri ndër partnerët më të rëndësishëm sa i përket sportit është Linzer Veranstaltungs GmbH (LIVA). LIVA në axhendën e vet promovon sportit në Auwiesen, Lissfeld dhe Pichling, sallën e tenisit në Bockgasse si dhe stadiumin dhe TipsArena, të cilat janë më të preferuarat dhe më të rëndësishmet në qytetin e Linzit. Në fokus kryesor janë këto lloje të sportit: futbolli, tenisi, pingpongu dhe beach-volleyball. Për Skater dhe Boarder ekziston në Lissfeld dhe në Pichling sektori i veçantë i transportit.

### Parku i sportit Auwiesen

Auwiesenstraße 202
Tel.: 0732-30 37 89

E veçanta e këtij objekti multifunkcional është salla më e madhe dhe e përshtatshme për kampionat botërorë në ngjitjen shkëmbore (Klettern) në Austri.
Ofertat: Tenis (në sallë dhe jashtë), futboll (fusha natyrale dhe artificiale), salla për ngjitjeshkëmbore, beachvolleyball (jashtë), basketboll/volejboll (jashtë), streetball, restorant.

### Parku i sportit Lissfeldd

Hausleitnerweg 105
Tel.: 0732-34 42 51

Parku i ri i sportit Lissfeld është me 56 000 metra katror parku më i madh i sportit në Linz. Këtu ka kushte ideale përveç të tjerave për pingpong dhe sallë të sportit në trend si dhe beachvolleyball në sallë.
Oferta: Tenis (në sallë dhe jashtë), squash, futboll (në sallë dhe jashtë), faustball, basketboll, minigolf, miniaturgolf, Bowling, pingpong, gjimnastik, badminton, beachvolleyball (në sallë dhe jashtë), sport i modës, hendboll, volejboll, basketboll , streetball, beachsoccer, atletike, restorant.

### Parku i sportit Pichling

Weikerlseestraße 71-73
Tel.: 0732-32 06 70

Ky park modern i sportit shtrihet në afersi të solarCity në Pichling dhe kufizohet me vendin e pushimit Weikerlsee. Parasegjithash sportet që janë në trend mund të ushtrohen këtu në mënyrë optimale.

Oferta: Tenis (në sallë dhe jashtë), squash, futboll (fusha natyrale dhe artificiale), futboll në sallë, gjimnastikë, badminton, hendboll, volejboll, basketboll, atletik, nordic walking, beachvolleyball, streetball, sporte në trend, restorant.

## Ofertat dhe orari i parqeve të sportit:

**www.livasport.at** » LIVA locations » Sportparks

## Klubet e sportit

Në Linz ka mbi 330 klube sporti ku mund të shfrytezohet koha e lirë për sport së bashku me të tjerë me nivel të njejtë sportiv. Klubet gjenden në adresën www.linz.at/sportvereine-linz.asp.

## Sportdachverbände (Organizatat e sportit)

- **ASKÖ Oberösterreich**
  Hölderlinstraße 26, 4040 Linz
  Tel.: 0732-73 03 44
  www.askoe-ooe.at

- **UNION Oberösterreich**
  Wieningerstraße 11, 4020 Linz
  Tel.: 0732-77 78 54
  www.sportunionooe.at

- **ASVÖ Oberösterreich**
  Leharstraße 28, 4020 Linz
  Tel.: 0732-60 14 60
  www.asvo-sport.at

Organizatat e sportit gjenden në adresën **www.linz.at** » Bürgerservice » Service A – Z » Freizeit und Sport » Sportdachverbände.

## Objektet e shumëllojshme sportive

Në përgjithsi në Linz ka një ofertë të gjërë sportive. Më sumë se 150 lloje sportesh janë nëdisponim. Në lidhje me këte ekzistojn edhe objektet sportive. Informata të hollësishme për sallat e sportit, objektet për sport në kohën e lirë dhe objetktet speciale për sport nën adresën **www.linz.at/sportanlagen.asp**

## Ofertat për fëmijt dhe të rinjt

Në vendet publike për lojra të fëmijve dhe të rinjve gjenden gjithashtu shumë objekte për basketboll, skateboard, beachvolleyball si dhe fun-courts. Një listë e renditur sipas pjesëve të qytetit e objekteve dhe e ofertave është në internet nën adresën www.linz.at/soziales/spielplatz.asp.
Për informata më të hollësishme mund ta kontaktoni Kinder – und Jugend – Services Linz / Kinder – und Jugendbüro, Rudolfstraße 18, Tel.: 0732 7070 2831 ose 2862.

## Pishinat, liqenet për frekuentim publik, sport mbi akull

Argëtim dhe kompensim sportiv ofrojn pishinat e hapura dhe të mbuluara të Linzit, liqenet për frekuentim publik dhe objektet e sporteve mbi akull:

- **Parkbad**
  Pishinë e mbuluar, sauna, pishinë e hapur, objekt i hapur dhe i mbyllur për sport mbi akul
  Untere Donaulände 11, 4020 Linz
  Tel.: 0732-3400-6630

- **Hummelhofbad**
  Pishinë e mbuluar, sauna, zonë e madhe për wellness, pishinë e hapur
  Ramsauerstraße 12, 4020 Linz
  Tel.: 0732-3400-6660

- **Biesenfeldbad**
  Pishinë e mbuluar, sauna, vend i hapur për rrezitje
  Dornacher Straße 37, 4040 Linz
  Tel.: 0732-3400-6670

- **Schörgenhubbad**
  Pishinë e mbuluar, sauna, pishinë e hapur, objekt për sport mbi akull
  Schörgenhubstraße 16, 4030 Linz
  Tel.: 0732-3400-6680

- **Saunaoase Ebelsberg**
  Sauna, objekt për sport mbi
  Hartheimer Straße 1-3, 4030 Linz
  Tel.: 0732-3400-6690

Gjithashtu ka edhe shtatë pishina të hapura për fëmij.

Mësimi i notit në Parkbad, Biesenfeldbad, Hummelhofbad dhe Schörgenhubbad:
Mësimi i notit është i mundur për fëmijt mbas moshës 5 vjet. Instruktor të shkolluar për not ju mësojn, me kënaqsi, notin. Lajmrimet mund të behën te kasa e pishinës

### Liqenet për frekuentim publik:

- **Pleschinger See**
  Afër kufirit të qytetit të Linzit në Plesching/Steyregg

- **Pichlinger See**
  Në pjesën e qytetit Pichling në jug të Linzit

- **Kleiner Weikerlsee**
  Gjithashtu në pjesën e qytetit Pichling afër SolarCity

Informata të hollsishme: **www.linzag.at** » Produkte » Bäder

## Propozime për shfrytëzimin e kohës së lirë

### Argëtim pranë derës së shtëpisë

Për qytetarët e Linzit janë të preferuara parqet në qendrën e qytetit. Këtu parasegjithash janë Stadtpark, Volksgarten, Hessenplatz dhe Schillerpark që ofrojnë pushim dhe relaksim. Objektet tjera si Donaupark, Schlossberg dhe Freinberg shfrytëzohen mjaft për shëtitje dhe vrapim. Sidomos shumë hapësirë për furnizim me energji dhe përjetim të natyrës ofrojn vendpushime në qytet. Këtu bëjnë pjesë Zentralpark Urfahr, der Wasserwald, der Schiltenbergwald dhe Traun-Donau-Auen.

### Vrapimi dhe shëtitja

Vrapuesit e pasionuar të Linzit munden vrapimet e tyre sportive, perveç tjerash, mund ti bëjnë në 14 rrugë për jogging, me gjatësi deri më 21,1 km. Për shëtitje përmes pjesëve më të bukura të Linzit ekzistojn nëntë shëtitore të shënuara.
Detajet: **www.linz.at/sportanlagen.asp** » Laufstrecken, Wanderwege

### Aktivitet sportive

Linzi ofron shumë Aktivitet sportive të klasës së lartë. Si p.sh.: Generali Ladies -Tennisturnier (turneu i grave në tenis) në TipsArena, futboll edhe atletikë në stadiumin e Linzit dhe ndeshje në Eishockey (hokej mbi akull) në Linzer Eissporthalle (salla e sporteve mbi akull). Një argëtim emocionues për shikuesit ofron gjithashtu OMV Linz Marathon si dhe ngjarjet tjera të vrapimit.

| | |
|---|---|
| DetajeTipsArenadheStadioni: | **www.livasport.at** » LIVA locations |
| Borealis Linz Donau Marathon: | **www.linz-marathon.at** |
| Generali Ladies Linz: | **www.generali-ladies.at** |
| Eishockey – Black Wings Linz: | **www.ehcliwestlinz.at** |

Informata për ngjarjet tjera dhe kalendari i ngjarjeve në: **www.linz.at/tourismus/726.asp**

## Kopshti botanik (BotanischerGarten)

➲ **Botanischer Garten**
Roseggerstraße 20, 4020 Linz
Tel.: 0732-7070-1860
www.linz.at/botanischergarten

Një përjetim i veçantë i natyrës është kopshti botanik në Gugl. Në mbi 4 hektar mund të shifen rreth 10 000 bimë të ndryshme, ndër ta orchidee të ralla dhe koleksione tërralla e kaktusesh. Ekspozita, koncerte, lexime e zbukurojnë programin.

## Urfahraner Markt

Dy herë në vit – në pranverë dhe vjeshtë – mbahet Tregu Vjetor i Urfahr (Urfahraner Jahrmarkt). Në këtë festë më të madhe popullore në Austri, në bregun e majtë të Danubit zbaviten mbi një milion vizitor në vit. Perveç mallrave të të gjitha llojeve dhe një parku zbavitës ofrohet shumë ushqim i shijshëm dhe pije. Për çdo Urfahraner Markt organizohen dy hedhje fishekëzjarresh të mëdha.
Informata më të hollësishme në: www.urfahranermarkt.at

## Tezgat (Flohmarkt)

Çdotë shtunë, nga ora 7 deri në 14 në Hauptplatz organizohet një Flohmarkt me sende të vjetra. Në rastet kur ka shfaqje të ndrshyme dhe në muajt e dimrit, Flohmarkti mbahet tekBashkia e Re (Neue Rathaus)në Urfahr. Tezgat me mallrat e shumllojshem është i lajmëruar dhe i frekuntushëm. Mbi 5000 shitës dhe shitëse në vit shfrytëzojn këtë rast. Kush dëshiron që të këtë njëtezgë (vend për shitje) duhet tëkontaktojë në telefonin 0732 7070 ose në internet në adresën: www.linz.at/flohmarkt. oraret ndahen katër javë përpara.

## Këshilla dhe informata tjera për shfrytëzimin e kohës së lirë:

➲ **Tourist Information Linz**
Hauptplatz 1, 4020 Linz
Tel.: 0732-7070-2009
tourist.info@linz.at
www.linz.at/tourismus

# QARKULLIMI NË LINZ



# 10 QARKULLIMI NË LINZ

Qyteti i Linzit bën perpjekje të nxisë qarkullimin që e mbron mjedisin. Kështu me oferta atraktive mundësohet mos të qarkullohet me me automjet privatë, por të udhëtohet më tepër me tramvaj, autobuza dhe biçikleta.

## Transporti publik

Me tramvajet dhe autobuset e LINZ AG LINIEN është e lehtë dhe pa stres të arrihet në destinacionin e caktuar në qytet. Për këtë përkujdeset jo vetemqarkulliminеshpeshtë të linjave dhe distancave të-stacioneve, por edhe programi special për shpeshtësinë e linjave. Kështu tramvajet kanë gjithmonë dritën e gjelbërt (të semaforit). Korsi (Fahrspur) të veçanta për autobusa, në shumë pjesë garanton udhëtim pa bllokim të trafikut (staufrei).

Në orët e vona të natës ekzistojnë dy oferta plotësuese: Anruf – Sammel – Taxi (AST) që mund të shfrytëzohet nga ora 20:00 deri në orën 5:00 të mëngjesit, si dhe linjat e natës. Po ashtu linja e tramvajt N1 (Universität – Auwiesen) dhe tre linja të autobusit janë në qarkullim natën e të premteve, të shtunave dhe para festave.
Planet e qarkullimit, të linjave, orari i nisjeve nga stacionet si dhe çështjet tjera gjenden në internet në **www.linzag.at/efa**. Në adresën **www.linz.at/verkehr/3356.asp** gjenden po ashtu faqe për mjete të tjera të transportit publik në Linz.

### Biletat:

LINZ AG LINIEN kanë për çdo udhëtar ofertë të përshtatëshme. Përveç udhëtimit nëdistanzë të shkurtër, udhëtimit të gjatë dhe biletës ditore (Tageskarte), ekzistojne edhe bileta javore, mujore dhe vjetore. Nxënësit, studentët, të punësuarit, pleqët si dhe përdorëuesit e Aktivpasit kanë zbritje në çmime. (Detajet e përparësive të Aktivpasit gjenden në kapitullin „Soziales und Gesellschaft“)
Nga korriku 2013 për të gjithë ata që vendbanimin kryesor e kanë në Linz, vlen një ofertë e re atraktive: Ata mund tëblejnënjë biletë vjetore për 100 Euro më lirë, fjala është për të ashtuquajturën Umweltticket.

Biletat mund të blihen në automatet e biletave ose në vendet për blerje të parakohëshme, si p.sh.: në trafika dhe në LINZ AG Kundenzentrum. Disa bileta mund të blihen deri në 30 ditë përpara në internet në adresën **www.linzag.at/shop-linien**.

➲ **LINZ AG LINIEN-Ticketbüro**
Landstraße 119 – Ecke Blumauerstraße 1
(për rreth Teatrit muzikor), 4020 Linz
www.linzag.at/linien
E hënë – E enjte: ora 8-17
E premte: ora 8-13
Tel. 0732-3400-7000

## Qarkullimi me biçiklet në Linz

Ai që e preferon udhëtimin me biçiklet në Linz i ofrohen shumë mundësi. Në Internet ka një hartë për qarkullimin me biçikleta në adresën **www.ifahrrad.at** mund të informoheni me rrjetin e rrugëve per biçikleta në Linz. Përdoruesit e biçikletave kanë të drejt ta përdorin korsin e autobusve në qytet, në shumë rrugë njëkalimshe kanë korsi tëveçantëpër biçikletat në drejtim të kundërt. Korsitë e biçikleta në kryqëzim u mundësojn çiklistave të jenë para automjeteve për t`ju mundësuar kthimin më të sigurt në të majtë.

Qyteti i linzit jep biçikleta për ata që dëshirojnë të kryer blerje e perditëshme si dhe biçikleta me karocë për femij pa pagesë. Me prezentimin e një dokumenti me foto dhe nënshkrimin e një kontrate për marrjen e biçikletës të cilat mund të mbahen deri në një javë.
**Kontakt:** 0732/7070-3189

Qyteti i linzit ka dy stacione (Radservice-Stationen) fikse, pa pagesë. Njëri prej tyre është në Urfahraner Jahrmarktgelände, në murret e Marktamtsgebäude dhe punon 24 orë. E dyta është në pjesën e pasme të Bashkisë së vjetër në foyer dhe është e hapur në të njejtën kohë me Information e Turistëve në sheshin qëndror të Linzit.

Kasfortat me çels (Schließfächer) në Godinat e Bashkisë së vjetër dhe të re e mundësojn ruajtjen e sigurt të sendeve që duam ti depozitojmë përkohësisht. Kasafortat jan 30 cm të gjërë, 50 cm të lartë dhe 70 cm të thellë dhe jan me pagesë prej një Euro.

**Kontaktpersoni juaj në lidhje me çiklizmin:**

- **Radfahrbeauftragter (i autorizuari për çiklizëm) der Stadt Linz**
  DI Rainer Doppelmair
  Stadtplanung Linz
  Neues Rathaus
  Hauptstraße 1-5, 4041 Linz
  Tel.: 0732-7070-3191
  stpl@mag.linz.at

## Informacione të përgjithshme për automjetin

Për shkaqe të sigurisë në Austri vlen ligji për vëniene rrypave të sigurisë (Gurtenpflicht), vënia e rrypave të sigurisë për femijët dhe vënia e gomave të dimrit. Këto dhe rregulloret tjera, si p.sh.: obligimi i Vignettës në Autostrad(Autobahn) mund ti lexoni në detaje në adresën **www.help.gv.at** në faqen „Freizeit und Mobilität“. Për çështjet që i përket lejes së vozitjes në Linz është kompetent Bundespolizeidirektion:

- **Landespolizeidirektion Linz**
  Nietzschestraße 33, 4020 Linz
  Tel.: 059133 40
  LPD-O@polizei.gv.at

## Patenta e makinës (Führerschein)

Patenta e makinës të banorëve të shteteve të BE (EU) dhe ZEE (EWR) pranohen dhe nuk duhet patjetër të përkthehen, por mund të përkthehen vullnetarisht.

Nëse vendoset në Austri me vendbanim të përhershëm një person që nuk është nga shtetet e ZEE (EWR), duhet në afat prej gjashtë muajsh ta përkthej patentën e tij të makinës në patentë Austriake të makinës. Në princip munden vetëm patentat e vlefshme të makinës të përkthehen. Tejkalimet e afateve nga vendi që vjen, vlejnë edhe në Austri. Për përkthimin e patentës së makinës për qytetarët që nuk jan nga shtetet e BE (EU) dhe ZEE (EWR) duhet patjetër provimi i patentës. Për këtë provim duhet të keni një veturë që i përgjigjet klasës përkatëse për patentën e makinës. Pronarët e patentës së makinës nga Sërbia duhet patjetër ta japin provimin e patentës.

**Për përkthimin e patentës së makinës nga ato shtete që nuk jan anëtar të BE (EU) dhe ZEE (EWR) nuk ka nevojë të bëhet provimi i patentës:**

Për krejt klasat: Andorra, Guernsey, IshulliMan, Japonia, Jersey, Monaco, San Marino, Zvicra
Për klasën B: Australia, Bosna dhe Hercegovina, Hongkongu, Izraeli, Kanada, Republika Jugafrikane, Republika e Koresë Jugore (nëse leja është marrë pas 1. Janar 1997), SHBA (USA)

Pronari i patentës së makinës nga jashtë duhet patjetër ti ketë mbushur 18 vjet.

**Afatet:**
Patenta nga shtetet që nuk jan anëtar të BE (EU) dhe ZEE (EWR) duhet patjetër, që pas vendosjes me vendbanim në Austri, mbrenda gjasht muajve të përkthehet

## Leja e qarkullimit të automjeteve

Personat që e ka vendbanimin kryesor në Austri dhe automjetin e vet e sjell nga jashtë, mundet më së shumti, një muaj të vozisë me tabela të huaja. Pastaj duhet ta bej regjistrimin në Austri. Për ta bërë këtë duhet ti kontaktone këto organe:

- Zyra e Kolaudimit të automjeteve për Austrinë e Epërme (Landesprüfstelle für Oberösterreich) për dokumentet e nevojshme
- Zyra e Finanzës për sqarimin e taksave, që duhet të paguhen

Nëse plotësohen këto kushte atëherë mundet që zgjidhni sigurimi e ta regjistroni automjetin. Lista e sigurimeve me vendregjistrime është në internet në adresën: www.vvo.at. Sigurimi kryen edhe regjistrimin e automjetit. Kusht për ti marrë targat e Austrisë është parasegjithash, të bëhet sigurimi i automjetit.

➲ **Landesprüfstelle für Oberösterreich**
Goethestraße 86, 4021 Linz
Tel.: 0732-7720-13575
**www.ooe.gv.at**

➲ **Finanzamt Linz**
Bahnhofplatz 7, 4020 Linz
Tel.: 0732-6998-52 80 00

## Parkimi në qendër të qytetit

Qendra e qytetit është e ndarë në 5 zona për parkimin e banorëve. Të gjithë ata të cilët e kanë vendbanimin kryesor dhe nuk kanë vendparkim privat kanë të drejt të aplikojnë për Bewohnerparkkarte (kartë për parkim të banorëve). Kjo kushton 54,40 € për një vit ose 94,50 € për dy vite (Gjendja 2013) dhe mund të merret në qendrën e shërbimit të qytetarve (Bürgerservice Center) ose në njërën nga bibliotekat e qytetit, dhe me këtë kemi të drejt që të parkojm gratis dhe në kohë të pacaktuar në njërën prej këtyre zonave. Kjo kartë mund të porositet edhe me telefon në nr. 0732 7070 ose në internet **www.linz.at** në faqen Bürgerservice në Formulare/Online – Dienste. Me këtë merret edhe një plan i pjesës së qytetit, ku mundemi me këtë kartë pa pagesë të parkojm.

Parkimi në zonat me parkim të shkurtë (Kurzparkzone) në qendrën e qytetit, në gjithë sipërfaqen është me pagesë. Këto zona dallohen nga shënimi më ngjyrë të kaltërtë përgjatë trotuarit ose në rrugë. Shenjat në fillim dhe në fund të zonës së shkurtë të parkimit (Kurzparkzone) informjon për periudhën kohore në të cilën duhet të paguhet për parkim – kjo është E hënë deri E premte prej orës 8 deri në ora 18:30 dhe të shtunave prej orës 8 deri në ora 15. Gjithashtu shkruan kohëzgjatja e parkimit, kjo është ndërmjet 30 dhe 180 minuta. Parkimi kushton çdo gjysëmore 1 Euro. Pagesa bëhet në automatet e parkimit me monedha ose kartë me Quick – funksion. Në Linz është e mundur, pas lajmrimit paraprakë te njëri nga operatorët, edhe parkimi me celular. Detajet për këtë janë në internet në adresën: **www.mobil-parken.at**.

**Kujdes!** Vija e verdhë përgjat trotuarit ose rrugës tregon ndalesën e qëndrimit dhe parkimit.

Në qendër të qytetit përveç zonave të parkimit të shkurtë ka edhe shumë parkime nëntokësore dhe shtëpi parkimi. Një listë për këtë gjendet në internet në adresën **www.linz.at/verkehr/34298.asp**.

## Zonat e takimeve

Me nivelizimin e trotuarave si p.sh.: në Herrenstraße dhe Klosterstraße arrihet që me rregullat e komunikacionit të formohen zonat e takimeve ose shared space (sipërfaqe të përbashktëta për qarkullimin e të gjith formave të lëvizjes). Në të ardhmen duhet që pjesmarrësit më të dobët në komunikacion siç jan këmbësorët dhe përdoruesit e biçikletave të shihen si partner të barabartë në rrugët e Linzit.

## Këshillimi për qarkullim në Linz

Këshillimi për qarkullim në Linz është një shërbim pa pagesë i qytetit të linzit i cili, me iniciativën e sektorit për  mjedis dhe komunikacion të qytetit të linzit, u aprovua në vitin 2000. Këshilli është në dispozicion të firmave, shkollave, insitucioneve dhe personave privat për këshillime për komunikacionin në qytet. Në mes të tjerave kordinon aksionin vjetor për përdoruesit e biçikletave „Linz fährt Rad“, për punëtorët në firmat dhe institucionet shëndetsore të linzit.
**www.linz.at/verkehr/3340.asp**

# INTEGRIMI NË LINZ



# 11 INTEGRIMI NË LINZ

## Puna e integrimit në qytetin e linzit

Linzi ka shumë atrakcione – një qytet në të cilin jetojn njerëz nga 148 nacione.Gjithsejt 32.930 persona me 1. Janar 2013 nuk e kan nënshtetësinë e austrisë, që d.m.th. 17 përqind të 193.486 banorëve të Linzit me vendbanim të përhershëm. Rreth 25 përqind të të gjith qytetarëve kan prejardhje migrante.

Kryeqyteti i landit Austria e Epërme, para disa dekadave ka reaguar në këtë ndryshim të shoqërisë dhe ka traditë në lëmin e kompetencave të diversitetit etnik: Zyra për integrim ekziston që nga viti 1991, Këshilli për migrim dhe integrim që nga viti 1996. Me formimin e sektorit të veçant, në qeverinë e qytetit, në vitin 2009 kjo tematikë merr hov në zhvillim dhe fiton në vlerë. Paketa masave për integracionin nga viti 2010 dhe programi social i ri i Linzit nga viti 2011 janë dy themeletbazë tëpolitikës integruese të Linzit.

## Dy themelet bazë e politikës integruese në Linz

Paketa e masave për integrim dhe tema e integrimit në programin social të vitit 2011 jan pikënisje e përpjekjeve për një jetë më të mirë të përbashkët në Linz.

Pika kryesore qëndron në të ashtuquajturën formimi gjyhesur  në kopshtet e fëmijve të qytetit, i cili ofrohet prej vjeshtës së vitit 2011, nga  (Kinder- und Jugendservices) sektori për fëmij dhe të rinjnëzyrat Bashkiake: Në këtë model unik për të gjithë Austrinë djemt dhe vajzat që kanë mungesa në njohjen e gjuhës (me ose pa prejardhje migrante), nga dita e parë në kopshtin e fëmijve kanë përkrahje për mësimin e gjuhës gjermane. Një fëmije, nëse ka nevojë i ofrohen gjat tre vjetëve në kopshtin e fëmijve deri në 540 orë mësim plotësues të përshtatur për moshën e tij për mësimin e gjuhës.

Dy herë në vit vlerësohet përparimi në mësimin e gjuhës të vajzave dhe djemve. Efektiviteti i masave përkrahse të qytetit të linzit është vlerësuar dhe vërtetuar nga Universiteti i Hamburgut. Masat qendrore për integrim të qytetit të linzit përcillen nga një numër i madhë i projekteve speciale për gjuhë dhe mësimin, sidomos për fëmijët që nuk e kanë gjermanishten gjuhën e nënës marrin mësim dhe në gjuhën amtare.

Një pasqyrë të projekteve për integrim të qytetit të linzit do të gjeni në materialin që vijon te paketa e masave për intgerim dheprogrami i ri social i Linzit.

## Paketa e masave për integrim

Me 22. Prill 2010 këshilli i qytetit ia dha dritën e gjelbërt paketës së masave për integrim që përbëhet nga 23 pika. Projektet konkrete ndahen në gjithsejt në ntë tema.

Paketa e masave për integrim në detaje:

| Tema nga fushat | Projektet |
|---|---|
| Për një përkahje intensive për mësimin e gjuhës | 1. Zgjerimi i përkrahjes për mësimin e gjuhës në kopshtin e fëmijve (Sprachförderung NEU)<br>2. Zgjerimi i „Rucksack-Modell“<br>3. Projekti„MamalerntDeutsch“<br>4. Projekti„Lese-Tandem“<br>5. Më shumë literaturë në gjuhët e huaja në Wissensturm(VHS) |
| Për një përkrahje në mësim | 6. Përkrahja në mësim në kujdestarit mbasshkollore të qytetit<br>7. Përkrahja në mësim në koperim me të tretët |
| Për një partneritet më të mirë në arsim | 8. Arsimimi i prindëve përmes shoqatave të prindëve<br>9. Integrimi më i mirë i prindëve në kopshtet e fëmijve |
| Për një fqinjësi më të mirë | 10. Puna në pjesë të qytetit<br>11. Përgjegjës për integrim në bashkësinë e banesave GWG<br>12. Shkollimet për nënpunësit e GWG<br>13. Mediator për konflikte |
| Për njohje më të mirë të kulturës së migrantëve | 14. Konzepti„LinzerMigrantInnen-Kultur“<br>15. „HausderKulturen“ |
| Për oferta plotësuese në sport | 16. Rrtija e ofertave të klubeve të sportit për migrantët<br>17. Projekti „Midnight Sports And Music“ |
| Për heqjen e pengesave në lëmin e shëndetësisë | 18. Fletushka„Shëndeti në Linz“<br>19. Informimi në shoqatat e migrantëve |
| Për ofertat e qarta orientuese për të rinjtë | 20. Klubi i takimeve<br>21. Puna mediale në Medienwerkstatt |
| Hapja interkulturore në administrat | 22. Shkollimi i mëtejshëm interkulturor i nënpunësëve<br>23. Fletushka„Mirë se vini në Linz“ |

## Programi social i Linzit

Programi social i linzit „LebensstadtLinz–SozialeSicherheitundGerechtigkeit“vazdhon me projektet që rrjedhin nga paketa e masave për integrim të vitit 2010 dhe i zhvillon ato mëtutje. Nën titullin „Lebens-Vielfalt“ merret një artikull në lëmin e integrimit, i cili përmban pesë synime me gjithsejt 17 masa konkrete ose projekte. Këshilli i qytetit e votoj porgramin social me 24 Nëntor 2011 me shumicë votash.

Programi social i Linzit „Lebens-Vielfalt“në detaje

| Synimi | Masat dhe Projektet |
|---|---|
| Përforcimi i kualifikimit në profesion të mi-grantëven | 1. Të krijohen module dhe masa për arsim të mëtejshëm<br>2. Të krijohen mundësi për arsimim profesional në drejtimin social dhe të shëndetsisë |
| Zgjerimiinterkulturor në hapjen e administratës | 3. Rritja e numrit të punëtorve me prejardhje migrante në grupin e kompanive të qytetit të Linzit (UGL) duke u bazu në ligjin për objektivizim të Austrisë së Epërme<br>4. Hapja interkulturore e ofertave të qytetit<br>5. Synimi i shkollimit të mëtejshëm www.ris.rka.gv.at interkulturor të punëtorve të UGL |
| Zgjërimi i kanaleve për informim të migrantëve | 6. Rritja e numrit të shoqatave të prindëve të orientuara etnikisht<br>7. Zgjërimi i mbrëmjeve informative në kopshtet e fëmijve të qytetit në gjuhën amëtare<br>8. Kampanjë informimi në shoqatat e migrantëve<br>9. Zgjërimi i punës në arsimim |
| Intensifikimi i përkrahjes në mësimin e gjiuhes | 10. Zgjërimi i„Rucksack-Modell“<br>11. Zgjërimi sipas nevojës të projektit„MamalerntDeutsch“<br>12. Zgjërimi i bibliotekës së gjuhëve të huaja në Wissensturm<br>13. Përkrahja e gjuhës amëtare për të arritur te shumëgjuhësia |
| Arritja e mundësive për takimet kulturore | 14. Etablimi i shtëpisë kulturore në Linz<br>15. Përpunimi dhe realizimi i konceptit „Linzer-MigrantInnen-Kultur“<br>16. Vazdhimi i punës mediale në Medienwerkstatt të Wissensturm<br>17. Dhënja e çmimit të qytetit të linzit për nxitjen e punës në integrim |

## Tre shtyllat e politikës së integrimit në Linz

Dikasteri i integrimit, zyra për integrim dhe këshilli për emigracionin dhe integrim jan tre shtyllat e punës për integrim në Linz, të cilat zbatohen në praktikë dhe bartin pikat e paketës së integrimit dhe programit social.




### Dikasteri i integrimit

Zyra i integrimit u formua në qeverinë e qytetit pas zgjedhjeve të këshillit të qytetit në vitin 2009. Në krye të tij është nënkryetari i Bashkisë Zoti Klaus Luger i cili mbulon edhe dikasterin e çështjeve sociale dhe të komunikacionit. Zyra i integrimit është nismëtare për ndërrmarjen e masave konkrete në ato fusha në të cilat ka ndarje të kompetencave dhe përgjegjësive nga lartë ndërmjet konfederatës, landeve dhe komunave. Çështja kryesore qëndron në paketën e masave për integrim si dhe të programit të ri social të Linzit, siç u theksua më parë SprachförderungNEU.

### Këshilli për migrim dhe integrim(MIB)

Këshilli përfaqëson interesat politike të të gjith qytetarëve me prejardhje migrante në Linz. Ai përbëhet nga 16 anëtar të caktuar dhe pa pagesë. Mëtutje çdo parti që përfaqësohet në Senatin e qytetit (SPÖ, ÖVP, Grüne, FPÖ) dërgon në MIB nga një anëtar të këshillit të qytetit me të drejtë keshillimi. Qëllimet e këshillit, përveç tjerash janë përfshirja e interesave të migrantëve në nivel komunal, promovimi i mirëkuptimit në mes të grupeve etnike me prejardhje nga vende të ndryshme ose përkrahja e projekteve konkrete për integrim. Prej 1 Mars 2012 kreytare e këshillit është Arzu Büyükkal me prejardhje nga Turqia..

## Zyra për integrim

Zyra për integrim është në shërbim dhe e hapur për të gjithë qytetarët e Linzit dhe jep informacione për temën e emigracionit, bën projekte dhe kordinimin e tyre. Përveç kësaj organizon edhe diskutime dhe simpoziume me tema shkencore, ose mbrëmje rinore, gjithashtu detyrë e zyrës për integrim është edhe rrjetëzimi i NGO-ve, organizatave jo qeveritare, puna shkencore bazike, hapja interkulturore e administratës së qytetit si dhe puna publike. Nga viti 2007 zyrën për integrim e udhëheq Mag. Belmir Zec si përgjegjës për integrim në Linz.

# Shoqatat e migrantëve në Linz

A deshironi ju që të keni kontakt me njerëzit nga vendlindja e juaj?
Ne Linz ka shumë shoqata të migrantëve (etnike dhe interkulturore) që janë të organizuara nga njerzit e vendeve të ndryshme: për sport dhe kulturë, për përkrahjen dhe këshillimin e njëri-tjetrit. Informata në lidhje me këtë mund të merrni te zyra për shoqata (Vereinsbehörde).

Zyra për shoqata (Vereinsbehörde) në Linz është Drejtoria qendrore e policise në Linz,e cila është kompetente edhe për formimin e shoqatës.

➲ **Landespolizeidirektion Oberösterreich**
Gruberstraße 35, 4021 Linz
Tel.: 059-133 40-0
LPD-O@polizei.gv.at

Poashtu informata në lidhje me këtë mund të merni në zyrën për integrim të qytetit të Linzit

➲ **Integrationsbüro der Stadt Linz**
Hauptplatz 1, 4020 Linz
Tel.: 0732-7070-1150
integration@linz.at
www.linz.at/soziales/integration.asp

**Ministria e punëve të mbrendshme** përmes formimit të regjistrit qendror për shoqata, ofron mundësi që nëinternet dhe pa pagesë të bëhen pyetje për shoqatë të caktuar në adresën:
**http://zvr.bmi.gv.at**

# 12 INFORMATAT PËR TË HUAJT

## Emigrimi në Linz

**Shërbimet e Departamentit për të huajnë Bashkinë e Kryeqytetit të Landit- Linz. Informata dhe këshilla individuale për mundësit dhe parakushtet për emigrim**

- Dokumentacioni për Lejeqëndrimin për qytetarët e Zonës Ekonomike Europiane (EWR), dhe të Zvicrës.
- Lëshimi i lejeve për qëndrim dhe vendosje sipas ligjit për qëndrimin dhe vendosjen e të huajve, që nuk jan shtetas të shteteve të EWR (Zones Ekonomike Europiane).
- Arsyetimi juridik përmes vendbanimit kryesor në Linz

### ME RËNDËSI!

Kërkesa ose formulari (Kërkesa e parë ose Kërkesa për vazhdim), për lëshimin e lejes së qëndrimit mund të merren në Bashkinë e qytetit të Linzit.

➲ **Zyra civile dhe për regjistrimin e banorëve (Einwohner-undStandesamt)**
Departamenti i ligjit për të huaj (Abteilung: Fremdenrecht)
Hauptstraße 1-5, Neues Rathaus
Eingang Fiedlerstraße, 4041 Linz
Tel.: 0732-7070
fremdenrecht@mag.linz.at

Orari: E hënë dhe E enjte: ora 7-12.30 dhe ora 13.30-18
E martë dhe E mërkurë: ora 7-13.30
E premte: ora 7-14

Biseda në zyrë: E hënë dhe E enjte: ora 7-11 dhe ora 13.30-16
E martë, E mërkurë dhe E premte: ora 7-12

**Caktimi i orarit është i nevojshëm!**

Informata të rëndësishme për temën e imigrimit gjenden në adresën: **www.linz.at** » Bürgerservice »Service A – Z » Zuwanderung

## Informacion i përgjithshëm për lejeqëndrimin e shtetasve të vendeve të treta

**Nënshtetasit e vendeve të treta (Drittstaatsangehörige),** pra nënshtetasit e shteteve, që nuk i takojn Zonës Ekonomike Europiane (EWR) dhe as EU, të cilët dëshirojn që në Austri të qëndrojn **më shumë se gjasht muaj,** ju duhetlejeqëndrimi (Lejevendosjeje ose qëndrimi). Kërkesat e para të qytetarëve që vijnë nga shtetet e treta, duhet patjetër të dorëzohen jashtë shtetit në përfaqësitë përgjegjëse të shtetit Austriak.

**Nënshtetasit e Shteteve të EWR ose të Zvicrës** nuk kanë nevoj për **lejeqëndrimi.** Ata duhet që brenda katër muajve nga ardhja ne Austri, në organet përkatse ta marrin **Çertifikatën e regjistrimit** (Dokumentacionin e Lejes së qëndrimit).

**Kujdes:** Qytetarët e Shteteve të reja BE-/EWR kan gjithashtu kufizime për punësim në tregun Austriak të punës. Këtu do të mund të informoheni për vendet e reja si dhe të vjetra të BE-së, datën e antarsimit, numri i banorëve, sipërfaqja, valuta etj. Janë të përfshirë edhe kandidatët e tjer për anëtarsim: **www.europa.eu**

## Qëndrimi deri në gjasht muaj në Austri:

Gjat një **qëndrimi deri në gjasht muaj** duhet të zbatohen rregullat e ligjit policor për të huaj (FPG). Në faqen e internetit **www.ris.bka.gv.at** mund të lexoni për ligjin policor për të huaj:
**Për ftesa të familjarve, të njohurve ndihmon policia për qytetarët e huaj në aplikimen e kërkesës.**

## Qëndrimi në Austri më gjat se gjasht muaj:

Nëse zgjatë qëndrimi më gjatë se 6 muaj, duhet të zbatohet ligji për vendosje dhe qëndrim (NAG). Në linkun si vijon mund të lexoni për ligjin e vendosjes dhe të qëndrimit: **www.ris.bka.gv.at**

# Llojet e lejeqëndrimit

**Ekzistojnë këto lloje të lejeve të qëndrimit:**

- Leje qëndrimit (Niederlassungsbewilligung) – qëndrim i përkohshëm
- Anëtaret e familjes (qëndrim i përkohshëm)
- Qëndrim i përhershëm – EG (unbefristete Niederlassung)
- Qëndrim i përhershëm – anëtarët e familjes (unbefristete Niederlassung)
- Leje qëndrimi (Aufenthaltsbewilligung) – qëndrim i përkohshëm dhe i kufizuar

Lejet e qëndrimit jepen gjithnjë **për një qëllim të caktuar** (p.sh.: nuk lejohet punësimi). I huaji ose e huaja ka mundësi që gjatë qëndrimit në Austri ta ndërojë qëllimin e qëndrimit, nëse për këtë plotësohen parakushtet dhe ekziston një vend në kontigjentin e percaktuar (Quotenplatz).

**Shënim:** Lejet e qëndrimit jepen në **formë karte të bankës** (Scheckkartenformat).
**Kujdes:** Nuk është e lejuar të dorëzohet një kërkesë me disa arsye qëndrimi, ose disa kërkesa njëkohësisht.

**Karta Rot-Weiß-Rot**
Në vitin 2011 në Austri formohet një sistem i emigrimit i bazuar në emigrim të kualifikuar dhe me kritere, i cili bazohet në kritere të përcaktuara me një sistem pikësh. Karta Rot-Weiß-Rot bazohet parasegjithash në punëtor me kualifkim të lartë në profesione ku mungojn fuqia punëtore, profesionalist të tjer, absolvent në studime dhe profesionalist të pavarur. Karta jepet kryesisht për një vit, mirëpo nëse plotësohen kritere të caktuara, dhe pasi i kalon afati mund të kalohet në një formë tjetër të lejes së qëndrimit.

Informacione më tëdetajuara për kartën Rot-Weiß-Rot mund të gjeni ne faqen **www.help.gv.at** »Leben in Österreich » Aufenthalt und Visum » Aufenthaltstitel » Aufenthaltstitel - befristete Niederlassung » „Rot-Weiß-Rot – Karte“

## Kohëzgjatja e lejeve të qëndrimit

### Lejet e kufizuara të qëndrimit

Lejet e kufizaura të qëndrimit jepen kryesisht në kohëzgjatje prej **12 muajsh.**
Por ka edhe përjashtime, si vijon:

- Nëse e merrni lejen e qëndrimit për herën e tretë kjo mund të jetë me afat 36 mujor (nuk është përjashtim por rregull)
- **Hulumtuesit mund të marrin leje deri në 24 muaj**
- Karta e kaltërt BE (Blaue Karte EU) jepet gjithashtu deri në 24 muaj

### Lejet e përhershme të qëndrimit (Unbefristete Aufenthaltstitel)

Nëse posedoni një **lejeqëndrimi “Daueraufenthalt – EG” ose “Daueraufenthalt – Familienangehörige” atëherë leja juaj e qëndrimit është e përhershme;** ikohëzgjatja e kartës është 5 vjet. Te lejet e përhershme kartat duhet që pas **5 vjetve** të ndërohet, që fotografia dhe shënimet të aktualizohen.
Leja e përhershme e qëndrimit “Daueraufenthalts – EG” u jepet personave si vijon:

- pas një lejeqëndrimi 5 vjeçare, të pandërprer në Austri,
- nëse plotësohen parakushtet e përgjithshme (shife më posht nën “përmbushja e parakushteve për dorëzimin e lejes së qëndrimit), si dhe
- përmbushja e Integrationsvereinbarung (marrëveshja për integrim), nëse për atë keni qenë të obliguar.

**Çmimet:** lejeqëndrimi i kufizuar: 120 Euro; i përhershëm 170 Euro.

**Nga çmimi i përgjithshëm gjatë hedjes së kërkesës paguhen 100 Euro për të ritur ose 70 Euro për të mitur. Fëmijët deri në 2 vjet janë të liruar nga pagesa.**

**Kohëzgjatja** e lejes së qëndrimit fillon me datën e lëshimit. Nëse kërkesa për vazhdimin e lejeqëndrimit dorëzohet dhe merret me kohë, atëherë personi ka një qëndrim të pandërprer ligjor në Austri.

Në adresën e internetit **www.help.gv.at** » Leben in Österreich » Aufenthalt und Visum, mund të lexohen të gjitha rregullat në lidhje me lejeqëndrimin në Austri. Nëse keni pytje ose propozime mund të ju drejtoheni HELP – Team: **info@help.gv.at**

# Kërkesat parapprake për dhënjen e lejeqëndrimit

## Sigurimi i shpenzimeve për jetesë

Autoriteti zyrtar mund të jap lejeqëndrim vetëm nëse i huaji ose e huaja ka të ardhura të mjaftueshme gjatë qëndrimit, kështu që mos të ketë ngarkesa financiare për organet shtetrore, të landit ose të komunës. Shuma e shpenzimeve për jetesë llogaritet se është e mjaftueshme nëse shuma e parave është së paku në lartësin pensionit minimal **„Ausgleichszulagenrichtsatzes“** Shume e pensionit minimal Ausgleichszulegenrichtsatz mund ta lexoni në faqen e internetit **www.help.gv.at** » Leben in Österreich » Finanzen » Pension » Zulagen und Beihilfen » Ausgleichszulage

## Sigurimi shëndetsor (Krankenversicherung)

Gjat qëndrimit në Austri i/e huaja duhet patjetër të posedoj një sigurim shëndetsor, i cili i mbulon “të gjitha rreziqet” dhe është i obliguar të paguaj për shërbimet shëndetsore në Austri.I/e huaja e zgjedh vet sigurimin shëndetsor.

## Vendbanimi

I/e huaja, gjatë paraqitjes së kërkesës për leje qëndrimi, duhet të ketë të drejtëpër banim (si p.sh. në bazë të kontratës për qira-mietvertrag), e cila i përshtatet **kushteve vendore** dhe numrit të anëtarve të familjes.
**Shënim:** Mundësia e banimit pa pagesë, e cila mund të ndërpritet në çdo kohë, nuk e plotëson këtë kusht, për shkak se i/e huaja me këtë nuk e ka të drejtën e strehimit. Kjo form e strehimit (unterkunft) mundet si p.sh. në çdo kohë të ndërpritet,  pasi nuk ka afat për prishjen e marrëveshjes.

## Rrespektimi i Ligjit dhe Rendit Publik

Lejeqëndrimipër një qytetar të huaj, nuk jepet nëse:

- për atë ekziston një vendim në bazë të §52ligjit të policisë për qytetarët e huaj (FPG), për kthim në vendin e origjinës për shkak të qëndrimit jolegal në Austri ose nëse ka vendim të plotëfuqishëm për ritkthim në bazë të §54FPG, ose të § 67 FPG (për të gjithë rreziqet e rendit publik dhe të sigurisë);
- ekziston një vendim për kthim nga një shtet i ZEE (EWR) ose Zvicrës;
- kundër tij ekziston vendim mbi dëbimin;
- ka një qëndrim fiktiv, një partneritet për qëndrim ose një adoptim fiktiv për qëndrim;
- tejkalohet afati i qëndrimit i lejuar pa obligim për vizë ose pas tejkalimit të afatit me vizë ose
- ai ose ajo në 12 muajt e fundit ka hyrë në zonën e shtetit në mënyrë jolegale dhe për këtë është i dënuar.

Informacione tjera për temën “Kushtet e përgjithshme për dhënjen e lejeqëndrimit” gjenden në adresë **www.help.gv.at** » Leben in Österreich » Aufenthalt und Visum » Aufenthalt Drittstaatsangehörige » Allgemeines zum Aufenthalt von Drittstaatsangehörigen.

## Zgjatja i lejeqëndrimit

Për zgjatjen e lejeqëndrimit i/e huaja, duhet që përveç kushteve të përgjithshme për dhënjen e leje-qëndrimit të plotësoj edhe kushtet tjera, të cilat janë:

- Përmbushja e marrëveshjes për integrim:Marrëveshja për integrim shërben për integrimin ligjor të një qytetari tëhuaji në Austri dhe ka për qëllim thellimin e njohurisë të gjuhës gjermane. Njohurit elementare të gjuhës gjermane jan kusht për vizën e parë për hyrje në Austri
- Lloji i qëndrimit deri në momentin e kërkesës për leje qëndrimi në Austri

Sekritariati shtetror për integrim në faqet e veta të internetit ofron informacione për marrëveshjen për integrim **www.integration.at**

Informacione më të hollësishme për këtë temë mund të merni në adresën e mëposhtme:

➲ **Österreichischer Integrationsfonds**
**Integrationszentrum Oberösterreich**
Weingartshofstraße 25, 4020 Linz
Tel.: 0732-78 70 43-11
oberoesterreich@integrationsfonds.at
www.integrationsfonds.at

### ME RËNDËSI!

**Kërkesa për vazhdimin e lejeqendrimit duhet të bëhet para se ti kaloj afati, por jo më herët se tre muaj para se të kalon afati i lejeqëndrimit. Pas kësaj kërkesat llogariten si aplikim fillestar.** Dorëzimi me vonesë i kërkesës mund të ketë si pasoj, që qëndrimi juaj në Austri të jetë i padrejt nga aspekti ligjor, sidhe kërkesën duhet përsëri ta bëni vetë jashtë Austrisë.

### Kujdes!

- Kërkesat, të cilat dorëzohen pas kalimit të afatit të lejeqëndrimit, llogariten si kërkesa për vazhdim të lejeqëndrimit vetëm atëherë nëse i/e huaja mund të bej të besueshme se e ka pas të pamundur nga një ngjarje e papritur që të bëj dorëzimin me kohë të kërkesës për vazhdim të lejeqëndrimit, dhe në këtë ngjarje atij nuk i takon faji, ose i takon një pjesë e vogël e fajit, dhe
- Kërkesa plotësuese dorëzohet mbrenda dy javësh nga dita e kësaj pengese.

Informacione tjera në lidhje me temën “Vazhdimi i lejeqëndrimit” mund ti gjeni në adresën **www.help.gv.at** » Leben in Österreich » Aufenthalt und Visum » Aufenthalt Drittstaatsangehörige » Erteilung von Aufenthaltstiteln - Verlängerungsauftrag.

## Bashkimi i familjes

(Anëtarët e familjes llogariten nënshtetas të shteteve të treta)

Në kuptimin klasik bashkimi familjar i nënshtetasit të shteteve të treta (që nuk janë nënshtetas të EWR) kufizohet në familjen e ngushtë. Si famillje e ngushtë llogariten bashkëshortët ose partnerët e regjistruar si dhe fëmijët e mitur të pamartuar (fëmijët e adoptuar dhe fëmijt e partnerit) e atij që e bën kërkesën. Bashkshortët ose partnerët e regjistruar duhet ta kenë mbushur moshën 21 vjeç. Për të mitur, ligji austriak parashikon moshen 18-vjeçare. Bashkimi me familjen, sipas nga ligji mund të jetë me ose pa kuotë. Lloji i lejeqëndrimit ose arsyeja si dhe afati i lejes së parë të qëndrimit mvaret nga leja e qëndrimit të atij që e sjell familjen. Pas kalimit të 12 muajve me lejeqëndrim, bashkës-hortët ose partnerët e regjistruar kanë të drejt të punojnë, nëse i plotësojne parakushtet e caktuara.

Bashkëshortëve, partnerëve të regjistruar si dhe fëmijve të mitur të nënshtetasve të shteteve të treta u jepet “lejeqëndrimi – i kufizuar”, nëse ekziston një vend në kuot dhe plotësohen parakushtet siç jan:

- Vërtetim mbi strehimin e zakonshëm në nivel të vendit
- Vërtetimin për mjete të mjaftushme për jetesë (ASVG – Richtsätze)
- Vërtetimi mbi sigurimin shëndetësor që i mbulon të gjitha reziqet
- Të mos ketë pengesa për dhënjen e lejeqëndrimit
- Dëshmia për dhënien me sukses të provimit integrues për gjuhën – A1

Punësimi është i mundur vetëm me një leje pune (Beschäftigungsbewilligung).

**Për anëtarët e familjes të nënshtetasve të Austrisë, nënshtetasve të ZEE (EWR) dhe nënshtetasve të zvicrës vlejn rregulla tjera.**

Anëtarët e familjes janë të obliguar ta plotësojnë marrëveshjen për integrim (Integrationsvereinbarung). **www.help.gv.at** » Leben in Österreich » Aufenthalt und Visum » Aufenthalt Drittstaatsangehörige » Integrationsvereinbarung

Informacione tjera për temën e bashkimit familjar mund të gjeni në adresën **www.help.gv.at** » Leben in Österreich » Aufenthalt und Visum » Aufenthaltstitel » Aufenthaltstitel – Familienangehöriger.

## Nënshtetsia

Për dhënjen e nënshtetësisë duhet të plotësohen kushtet e përgjithshme për nënshtetësi(mjetet e siguruara për jetesë, të mos ketë dënime gjyqsore me burgim, dënime të rënda administrative, ta dorëzoi nënshtetësin e përparshme, njohja e gjuhës gjermane njohuripër Landin etj.).
Prej 1 Gusht 2013 ligji i ri për nënshtetsi ka hyrë në fuqi. Për personat që jan të integruar mirë është e mundur ta marrin nënshtetësin pas gjasht vjetëve, e jo si më parë, pas 10 vjetëve. Përveç kushteve të përgjithshme për ndarjen e nënshtetësis, personat që e parashtrojn kërkesen duhet ta dëshmojn njohurin e gjuhës në nivelin B2. Kushtet tjera për dhënjen e nënshtetësis mvaren nga ajo se ka pre-tendim ligjor ose jepet në bazë të vendimit të lirë të autoritetit ligjor (Behörde).

# 12 INFORMATAT PËR TË HUAJT

Informata më të hollsishme për këte jep enti përkatës i qeverisë së Landit të Austrisë së Epërme (Amt der Oberösterreichischen Landesregierung), ku edhe duhet të dorëzohen kërkesat për nënshtetësi. Autoriteti ligjor për dhënjen e nënshtetësis është qeveria e Landit të Austrisë së Epërme.

➲ **Amt der Oberösterreichischen Landesregierung**
Bahnhofplatz 1, 4020 Linz (Bau C, 4. Stock)
Tel.: 0732-7720
www.land-oberoesterreich.gv.at

Informata tjera më të hollsishme për temën e nënshtetësisë gjenden në adresën **www.help.gv.at** » Leben in Österreich » Staatsbürgerschaft.

## Arratisje / Azil

Nocionet:

**Azilkërkues:**Person ii cili e dorëzon kërkesën për njohjen e statusit të refugjatit i cili momentalisht gjendet në procedur testimi.

**Mbrojtja ndihmëse e justifikuar e personave:** Mbrojtja ndihmëse e justifikuar vlen për personat që u është refuzuar kërkesa për azil, por në vendin e origjinës u rrezikohet jeta ose shëndeti. Ato nuk jan as azilkërkues as azilant legjitim (Refugjatëve në bazë të Konventës së gjenevës ju duhet mbrojtje nga dëbimi për këto shkaqe: torturës, dënime respektivisht trajtim jonjerzor ose nënçmues, dënimit me vdekje)

**Refugjat ose refugjat i njohur me konvent:** është personi i cili nga shteti Austriak e merr azilin sipas konventës së Gjenevës. Azil fitojnë refugjatët të cilët sipas Konventës së gjenevës për refugjat janë të ikur nga vendlindja e tyre për këto shkaqe::

- Përndjekja politike si p.sh.: njerëzit të cilët e përkrahin njërën parti, deklaratave politike ose për mendimin e tyre politik janë të rezikuar
- Përndjekja religjoze
- Përndjekja në baza “racore”, etniteti ose nacionaliteti
- Për shkak përkatësisë së ndonjë grupe sociale: p.sh.: Përndjekja për shak homoseksualitetit, përkatësia në ndonjë profesion të caktuar ose përndjekje specifike për femrat (Gjymtimi seksual, shkeljet ndaj konventave patriarkale shoqërore, kërcënimi për sulme për shkak të vendosjes së “nderit familjar”)

Nga 1.1.2006 në Austri vlen ligji mbi azilin 2005 (AsylG)
Ligji mbi azilin 2005 mund të lexohet në këtë adresë:
**www.ris.bka.gv.at/Bundesrecht** » Suchwort » Asylgesetz » Suche starten

- **Bundesasylamt, Außenstelle Linz**
  (ab. 01.01.2014 Bundesamt für Fremdenwesen und Asyl, kurz BFA)
  Derfflingerstraße 1, 4020 Linz
  Tel.: 059-133-93 64 44

Informacione tjera për temën “arratisje dhe azil” gjenden në adresën **www.help.gv.at** » Soziales und Notfälle » Armut » Weiterführende Links » Beratung und Betreuung für AsylwerberInnen, anerkannte Flüchtlinge sowie MigrantInnen abrufbar.

## Organizatat tjera për këshilla dhe përkujdesje të migrantëve dhe/ose të refugjatëve në çështjet e ligjit për të huaj ose çështjeve sociale

Institucionet e poshtëshënuara i këshillojnë migrantët dhe/ose refugjatët në çështjet e ligjit për të huaj ose çështjet sociale, i mbështesin përmes shërbimeve të ndryshme dhe angazhohen për përmirsimin e situatës së grupit që ato e përkrahin.

- **Caritas – Flüchtlingshilfe** (Vetëm për azilkërkuesit)
  Hafnerstraße 28, 4020 Linz
  Tel. 0732-7610-2361
  fluechtlingshilfe@caritas-linz.at
  www.caritas-linz.at
  E hënë, E martë, E enjte ora 8–11 pas orarit të përcaktuar

- **Caritas - LENA** (special për njerzit që jan ose kan qen në prostitucion)
  Steingasse 25, 4020 Linz
  Tel. 0732-775508-0
  lena@caritas-linz.at
  Mo 14-16 Uhr und Di - Do 10-12 Uhr

- **MAIZ – Autonomes Zentrum von & für Migrantinnen**
  Hofgasse 11, 4020 Linz
  Tel.: 0732-77 60 70
  maiz@servus.at
  www.maiz.at

- **Österreichischer Gewerkschaftsbund (ÖGB)**
  Weingartshofstraße 2, 4020 Linz
  Tel.: 0732-66 53 91 0
  oberoesterreich@oegb.at
  www.oegb.at

- **Österreichische HochschülerInnenschaft an der Johannes Kepler Universität Linz**
  Altenberger Straße 69, 4040 Linz
  Tel.: 0732-2468-1122
  remi@oeh.jku.at
  www.oeh.jku.at

- **Psychosoziale Beratungsstelle Linz**
  Scharitzerstraße 16, 4020 Linz
  Tel.: 0 732-66 82 38
  psb.linz@promenteooe.at

- **SOS Menschenrechte**
  Tummelplatz 5, 4020 Linz
  Tel.: 0732-77 74 04
  office@sos.at
  www.sos.at

- **Verein Begegnung Arcobaleno**
  Friedhofstraße 6, 4020 Linz
  Tel.: 0732-60 58 97
  office@arcobaleno.info
  www.arcobaleno.info

- **Volkshilfe Oberösterreich – Flüchtlings- und MigrantInnenbetreuung**
  Stockhofstraße 40, 4020 Linz
  Tel.: 0732-60 30 99
  office@volkshilfe-ooe.at
  www.volkshilfe-ooe.at

- **migrare – Zentrum für MigrantInnen Oberösterreich**
  Humboldtstraße 49, 4020 Linz
  Tel.: 0732-66 73 63
  office@migration.at
  www.migrare.at

## Konsullatat / Ambasadat

- **Përfaqësit e shteteve të huaja në Austri**
  www.bmeia.gv.at/aussenministerium/buergerservice/auslaendische-vertretungen-in-oesterreich.html

- **Lista e përfaqësive konsullare në Austri:**
  www.bmeia.gv.at/fileadmin/user_upload/oracle/konsulliste_de.pdf

- **Përfaqësitë austriake jasht shtetitit**
  www.bmeia.gv.at/aussenministerium/buergerservice/oesterreichische-vertretungen.html

- **Lista e përfaqësive austriake jasht shtetit:**
  www.bmeia.gv.at/fileadmin/user_upload/oracle/oe_vertretungen_de.pdf

*Migrations- und Integrationsbeirat Linz*